Janar 2021
Numri: 154
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro




QËNDRO I PATUNDUR në UDHËN e drejtë

revistaetika progresibotime

PROGRESI
BOTIME

TË RINJ



E çfarë mund të jetë tjetër qëndrimi indiferent, pandjenja dhe injorant përballë mrekullive të pafundme madhështore, që prej grimcës më të vogël, e deri tek trupi më i madh, prej botës mikro, e deri në atë makro, të cilat ndriçojnë më së miri mendjen dhe zemrën, përveçse një çoroditje dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

"Ditën e Kiametit asnjë rob nuk do të bëjë qoftë edhe një hap pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën e tij, se çfarë ka bërë me dijen e tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar pasurinë e tij dhe se ku e ka konsumuar trupin e tij." (Tirmidhi, Kiamet, 1/2417)

"Allahu i Madhëruar e do të riun e pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që është drejtuar kah e mira dhe ka braktisur dëshirat e kënaqësitë (e ulëta të egos)." (Ahmed, IV, 151.)

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 340 6182 | e-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 44 566 577
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

Në suren Hud urdhërohet:

"Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju. Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t'ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni. Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat. Dhe duro! Se Allahu, me të vërtetë, nuk e humb shpërblimin për punëmirët." (Hud, 112-115.)

Këto ajete të bekuara, na kujtojnë disa prej parimeve kryesore që përbëjnë besimin tonë. Këto janë; të mos ndahesh nga e drejta, të mos e teprosh, bërja e një jete me vetëdijen se Allahu sheh dhe di gjithçka, të mos anosh nga të padrejtët, të ruhesh nga dënimi hyjnor dhe të mos e harrosh asnjëherë se Allahu është miku i besimtarëve. Nëse nuk jetojmë me këtë vetëdije, duhet ta dimë se nuk do të ndihmohemi nga Ai. Falja e namazeve me sinqeritet, përkushtim, përpikëri, në kohën e vet dhe mundësisht me xhemat. Këtu dëshirojmë të tërheqim vëmendjen edhe në fjalën e Allahut, që në sajë të faljes së namazit, do të na fshihen gabimet dhe gjynahet që i bëjmë për shkak të dobësive njerëzore.

Po, ajetet që përbëjnë temën tonë, ia kujtojnë këto, atyre që duan të marrin këshilla dhe i këshillon të bëjnë durim për të pasur sukses. Po ashtu, aty jepet sihariqi se atyre që bëjnë vepra të mira nuk do t'u humbet shpërblimi. Mirëpo, këtu do të ndalemi vetëm tek një fjali.

Kur lexohen këto ajete, unë emocionohem, sikur "Kurani është duke u zbritur tani në zemrat e besimtarëve". "Kur arrijmë të ulemi të qetë; një ajet, apo edhe një fjali në të, hap para nesh horizonte të gjera." Ajo që më bën të mendoj kështu, është fjalia, ***"veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija"***. Dhe nuk ma mban shpirti pa thënë, "o Zot! Sa këshillë gjithëpërfshirëse është kjo! Sa shprehje motivuese është kjo, që në jetët tona të mbizotërojnë të mirat!" Mendoni; nëse arrini t'i zbatoni këto që përmenden në këto ajete, automatikisht do të zhvilloni një pengesë ndaj të këqijave, që janë e kundërta e tyre.

Fakti që sihariqi, ***"veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija"***, vjen menjëherë pas urdhrit të namazit, është shumë i rëndësishëm, sepse namazi është në krye të parimeve që e mbajnë në këmbë besimin tonë. Namazi është shenja dalluese e atyre që, pasi hyjnë në Islam me Dëshminë Islame dhe gëzojnë pjekurinë dhe shëndetin mendor, janë të ngarkuar me kryerjen e tij përgjatë gjithë jetës.

Siç theksohet në Tefsir, çdo namaz është një mirësi. Kështu, një besimtari që fal namaz në pesë kohët e ditës, i fshihen gjynahet dhe gabimet që ai bën si pasojë e dobësive njerëzore. Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë se: "*Pesë namazet, xhumaja deri në xhumanë tjetër dhe ramazani deri në ramazanin tjetër, janë pastrues të gjynaheve që bëhen në mes tyre, nëse ruheni prej gjynaheve të mëdha.*" (Muslim, Taharet, 16.)

Në një hadith tjetër fisnik, thuhet: "Kur robi bën një gjynah dhe menjëherë pas tij ngrihet, merr abdes dhe fal namaz duke kërkuar falje për gjynahun e vet, Allahu e ka për detyrë ta falë atë." Ndërsa në një ajet fisnik, urdhërohet: ***"Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni."*** (Ankebut, 45.)

Revista ETIKA

Janar 2021
VITI: XV
NUMRI: 154

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 340 6182

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

WEBSITE
www.progresibotime.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur
se materialet e sjella në redaksi
pavarësisht nëse botohen apo jo
nuk i kthehen autorit. Koha e botimit
të një materiali përcaktohet
nga redaksia. Honoraret e shkrimeve
autoriale ose përkthimeve duhet të
vini t'i tërhiqni pranë
Shtëpisë Botuese "Progresi"
ose pranë zyrave të përfaqësimit
në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja













5 **Distanca me norma mes nesh**
Ahmet Tashgetiren
10 **Mëshira është sakrificë**
Prof. dr. Sulejman Derin
12 **Vetëdija ndaj përgjegjësisë**
Ali Riza Temel
18 **Përgjegjësia jonë për të ruajtur lumturinë e besimit**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
20 **Sahabët dhe Urtësia**
Shemseddin Kërësh
23 **Përsosmëria e veprave është në lidhje me nijetin**
M. Sami Ramazanollu
26 **Rreth moralit të fjalës në shekullin e dixhitalizimit**
Mustafa Asim Kyçykashçë



Njeriu dhe bota tjetër 29
Duran Ekizer
Propozime interesante 30
Adem Saraç
Një Ajet - Një Hadith 32

Si dielli 41
Nuredin Jëlldëz
Konkurrenca 44
Ahmet Zijlan
Ebu Seleme Mahzumi (r.a.) 48
Mustafa Erish
Veshja dhe devotshmëria 50
Nurten Selma Çevikollu
Punët e nevojshme dhe të panevojshme 53
Xhemal Nar







DISTANCA ME NORMA MES NESH

Ahmet Tashgetiren

"Gjembi që ka shpuar gishtin e dikujt diku nga Turkistani në Sham, ka shpuar gishtin tim..." (Ebu'l-Hasan Harakani)

"Nëse në këtë botë ka dikush që ndjen të ftohtë, ti nuk ke të drejtë të ngrohesh!.." (Mevlana)

Në krye të këtij shkrimi, vendosa dy thënie që; cila prej tyre të jetohet, atëherë në këtë botë nuk do të mbetet asnjë vuajtje dhe dhimbje. Por, vetëm nëse jetohet...

Miqtë e Allahut, të cilët kanë thënë këto fjalë, i kanë bërë zemrat e tyre strehë për njerëzit; pra, këto janë fjalë të vërtetuara me jetët e tyre, jo vetëm këshilla.

Për shkak se kanë ekzistuar këta njerëz që i kanë bërë zemrat e tyre strehë, ne sot po i paraqesim si shembuj të njeriut të mëshirës që do të ndërtojë Islami.

Ajo që duam të themi, është se cilësia "mëshirë për botët" nuk mbeti e kufizuar vetëm me Profetin tonë të dashur (a.s.).

Ajo që duam të themi, është se premtimi i Islamit për ndërtimin e një atmosfere mëshire botëpërfshirëse, nuk mbeti i shkruar vetëm në parimet themelore të ajeteve në Kuran.

Njerëzit e mirë, të cilët morën parimet nga Kurani dhe shembullin nga Profeti (a.s.), dhe i bënë ato udhëzues të jetës së tyre, u bënë myslimanë. Padyshim se prej Resulullahut (a.s.), e këtej, marrëdhëniet e njerëzve me Islamin, nuk ka vazhduar në mënyrë të njëjtë. Pra, nuk mund të bëjmë fjalë për një shumicë të madhe njerëzish që i janë dedikuar Kuranit dhe janë përpjekur papushim për t'i ngjasuar Profetit (a.s.), duke e rindërtuar personalitetin e tyre dhe duke jetuar një Islam të pastër, pa pësuar fire dhe pa e përzierë me asgjë.

Me kalimin e kohës, vende vende janë shfaqur



kalbje, tjetërsime, erozione, ndryshime, humbje dendësie dhe situata të atilla, saqë mund të pyetet; “me cilën pjesë të Islamit përshtaten këto, apo, çfarë ka mbetur prej Islamit tek këta njerëz?”...

Ndërkohë, Islami është kërkuar gjithmonë dhe përherë është pyetur, “ku po shkojmë?”.

Mëshira dhe myslimani.

Cilësia me të cilën duhet të pajiset myslimani në marrëdhëniet me jashtë...

Një pjekuri personaliteti që përmban dhembshurinë, dashurinë, keqardhjen, sakrificën dhe altruizmin...

Në këtë kuadër;

- Ajo që përmban kufizimin e fuqisë... që mban gjallë vetëdijen “Allahu është më i madh se ty!”..

- Që përmban mposhtjen e zemërimit..

- Që përmban ndarjen e pasurisë...

- Që përmban frenimin e lakmisë...

- Që përmban kapërcimin e smirës-xhelozisë...

- Që përmban mos humbjen e vetëdijes se çdo që zotërohet, është plotësisht vepër e caktimit hyjnor...

- Që përmban pajisjen me vetëdijen se njeriu është nën kujdesin e njeriut...

Është një tërësi normash që Allahu i Madhëruar, Rrahmani, Rrahimi, ka dërguar për të ndërtuar një njeri me cilësinë e “ahseni takuim / krijesës më të mirë”.

Resulullahu (a.s.), është një prijës, që është vënë në ballë njerëzimit duke u pajisur me cilësitë e një lideri, me mëshirë në shkallë universale dhe i një edukim hyjnor.

Mirëpo, të bëhesh mysliman, nuk është si të përfitosh një ngjyrë të veçantë pasi të jesh zhytur e nxjerrë nga një enë me bojë!

Të bëhesh mysliman, është çështje vetëdijeje... Një personalitet, një karakter i arritur me punë... Mbi të gjitha, është një pjekuri që mund të arrihet duke shpëtuar prej shtigjeve të ngushta të egos dhe shejtanit dhe duke e bërë zemrën mburojë ndaj joshjeve të tyre.

Ja pra, rrëzimet në tokë gjatë asaj ecjeje, janë përherë të mundura. Veçanërisht në masa të mëdha njerëzish... Kur ç’të shohësh, dhjetëra mijëra myslimanë, të cilët kanë vrarë dhjetëra mijëra myslimanë të tjerë... Disa i prenë kokën nipit të Profetit (a.s.) dhe ia vendosën në majë të heshtës. Disa të tjerë gurëzuan Qaben. E disa i prenë kokën sahabiut përballë Qabes.

Ka padrejtësi.

Ka mizori.

Ka pamëshirshmëri.

Që myslimani ia ka bërë myslimanit...

Të vijmë në kohën tonë!..

Si është gjendja jonë, kur themi “mëshira dhe myslimani”?

Çfarë kemi bërë në Siri?

Si e katandisëm Jemenin?

Çfarë po bëjmë në Egjipt?

Çfarë prezantimi i bëhet Islamit nga disa organizata që presin koka përballë kamerave?

Çfarë i ndodh cilësisë sonë “Hadimu’l Haramejni’sh-Sherifejn / Shërbyesi ti dy vendeve të shenjta”, kur në institucionet tona diplomatike masakrojmë njerëz.



Çfarë provimi po jep karakteri i qeverisjes sonë shtetërore në lidhje me të drejtat njerëzore?

A i përdorim pasuritë tona të nëntokës dhe mbitokës për të bërë frone floriri, apo i përdorim për të ndaluar varfërinë dhe vdekjen për shkak të urisë në vendet Islame?

Bota Islame... Nëse kjo është bota jonë, çfarë bote është kjo?

Botë imperialiste... Botë mizore. Botë armike ndaj Islamit dhe myslimanëve... Është e mundur të ndërtosh një botë të tillë jashtë Islamit, që ka humbur normat e veta!

Po bota Islame? A kemi arritur ne të bartim atmosferën e mëshirës së Islamit në hapësirat brenda botës Islame, që përpiqemi t'i japim botës së jashtme mësime humanizmi?..

Kujt dhe çfarë i thonë ajetet e Kuranit sot?

A ndriçohemi dhe a udhëzohemi sot nga personalitetit i bekuar i Profetit tonë (a.s.)?

Vallë, veshët tanë dëgjojnë më shumë Kuranin dhe Profetin (a.s.), apo egon brenda nesh që është bashkëpunëtor i shejtanit?

A mund ta kapërdijmë zemërimin tonë?

Kur arrijmë të shtiem në dorë fuqi dhe pushtet, a na tundon, a na nxit të sillemi si një lloj zoti?

....

Normat ndalen aty.

Shembuj tepër të bukur, i përhapin rrezet e tyre nga brenda historisë.

Por çdo njeri, çdo brez ka sprovën e vet.

Jetojmë në një kohë kur pamëshirshmëria merr kurbanë në masë të madhe.

Mund të ndash pamëshirshmëri, mund të ndash edhe kurban...

Po ashtu është edhe misioni për t'i sjellë përsëri dinjitetin njerëzimit siç veproi Profeti ynë (a.s.), në periudhën e injorancës... Islami e shpëtoi njeriun nga kalbësira njerëzore që i varroste të gjalla vajzat... Resulullahu (a.s.), e barti njeriun drejt Rrahmanit.

E shpëtoi njeriun nga gjakosja e duarve me gjakun e fëmijës së vet...

E veshi skllavin me rrobën njerëzore.

Ndërsa tani, mëshira Islame duhet me patjetër për t'i dhënë fund vrasjeve që bëhen në barkun e nënës. Duhet për të shpëtuar njerëzimin nga robëria e mendësisë që e ka normalizuar derdhjen e gjakut të miliona njerëzve me bombardime.

Sa mëshirë të paarritshme shpreh një fjali e tillë si, "Gjembi që ka shpuar gishtin e dikujt diku nga Turkistani në Sham...", apo "Nëse në këtë botë ka dikush që ndjen të ftohtë..."!? Pamjet e kufomave të fëmijëve që dalin brigjeve të deteve, nga një anë tregojnë se në ç'pikë të mizorisë së njeriut ndaj njeriut kemi arritur dhe nga ana tjetër, se sa nevojë urgjente kemi sot për cilësinë e mëshirës botëpërfshirëse të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Le ta thërrasim Resulullahun (a.s.), të kurojë plagët e njerëzimit!..

Le ta thërrasim atë myslimanin që ecën në gjurmët e tij (a.s.), që zemra e brumosur nën edukimin profetik e besimtarëve të bëhet melhem për plagët e kësaj kohe.

Jemi në kohën e mbylljes së distancave mes nesh, normave dhe prijësve. Përndryshe, rënia e njerëzimit do të jetë e frikshme!..



Si mund t'i pakësojmë TË KËQIJAT

Xhafer Durmush

Në suren Hud urdhërohet:

"Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju. Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t'ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni. Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat. Dhe duro! Se Allahu, me të vërtetë, nuk e humb shpërblimin për punëmirët." (Hud, 112-115.)

Këto ajete të bekuara, na kujtojnë disa prej parimeve kryesore që përbëjnë besimin tonë. Këto janë; të mos ndahesh nga e drejta, të mos e teprosh, bërja e një jete me vetëdijen se Allahu sheh dhe di gjithçka, të mos anosh nga të padrejtët, të ruhesh nga dënimi hyjnor dhe të mos e harrosh asnjëherë se Allahu është miku i besimtarëve. Nëse nuk jetojmë me këtë vetëdije, duhet ta dimë se nuk do të ndihmohemi nga Ai. Falja e namazeve me sinqeritet, përkushtim, përpikëri, në kohën e vet dhe mundësisht me xhemat. Këtu dëshirojmë të tërheqim vëmendjen edhe në fjalën e Allahut, që në sajë të faljes së namazit, do të na fshihen gabimet dhe gjynahet që i bëjmë për shkak të dobësive njerëzore.

Po, ajetet që përbëjnë temën tonë, ia kujtojnë këto, atyre që duan të marrin këshilla dhe i këshillon të bëjnë durim për të pasur sukses. Po ashtu, aty jepet sihariqi se atyre që bëjnë vepra të mira nuk do t'u humbet shpërblimi. Mirëpo, këtu do të ndalemi vetëm tek një fjali.

Kur lexohen këto ajete, unë emocionohem, sikur "Kurani është duke u zbritur tani në zemrat e besimtarëve". "Kur arrijmë të ulemi të qetë; një ajet, apo edhe një fjali në të, hap para nesh horizonte të gjera." Ajo që më bën të mendoj kështu, është fjalia, ***"veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija"***. Dhe nuk ma mban shpirti pa thënë, "o Zot! Sa këshillë gjithëpërfshirëse është kjo! Sa shprehje motivuese

është kjo, që në jetët tona të mbizotërojnë të mirat!" Mendoni; nëse arrini t'i zbatoni këto që përmenden në këto ajete, automatikisht do të zhvilloni një pengesë ndaj të këqijave, që janë e kundërta e tyre.

Fakti që sihariqi, ***"veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija"***, vjen menjëherë pas urdhrit të namazit, është shumë i rëndësishëm, sepse namazi është në krye të parimeve që e mbajnë në këmbë besimin tonë. Namazi është shenja dalluese e atyre që, pasi hyjnë në Islam me Dëshminë Islame dhe gëzojnë pjekurinë dhe shëndetin mendor, janë të ngarkuar me kryerjen e tij përgjatë gjithë jetës.

Siç theksohet në Tefsir, çdo namaz është një mirësi. Kështu, një besimtari që fal namaz në pesë kohët e ditës, i fshihen gjynahet dhe gabimet që ai bën si pasojë e dobësive njerëzore. Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë se: "*Pesë namazet, xhumaja deri në xhumanë tjetër dhe ramazani deri në ramazanin tjetër, janë pastrues të gjynaheve që bëhen në mes tyre, nëse ruheni prej gjynaheve të mëdha."* (Muslim, Taharet, 16.)

Në një hadith tjetër fisnik, thuhet: "Kur robi bën një gjynah dhe menjëherë pas tij ngrihet, merr abdes dhe fal namaz duke kërkuar falje për gjynahun e vet, Allahu e ka për detyrë ta falë atë." Ndërsa në një ajet fisnik, urdhërohet: ***"Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni."*** (Ankebut, 45.)

Siç shprehet edhe ajeti, namazi i falur siç duhet, e ngre njeriun shpirtërisht dhe e ruan atë nga të këqijat. Por, nëse namazi që falet nuk të orienton drejt së mirës dhe nuk të ndalon nga të këqijat, atëherë ai namaz mund të kthehet në një gjynah i bartur në shpinë.

Siç theksohet edhe në Tefsir, "fshirja e të këqijave nga veprat e mira, nuk është diçka e veçantë vetëm për namazin. Në fakt, në këto ajete, namazi është dhënë si shembull, sepse e njëjta gjë ndodh edhe me adhurimet e tjera. Çdo mirësi e bërë me besimin tek Allahu, e largon njeriun nga veprat e këqija dhe bëhet shkak i faljes dhe fshirjes së gjynaheve."[1]

Ndërsa në tefsirin "Ruhu'l-Bejan", thuhet se; "Vepra më e mirë, është njohja e Allahut ashtu siç i takon Atij. Dhe, mënyra e kësaj, është kapja fort pas monoteizmit dhe kundërshtimi me forcë i dëshirave të egos."[2]

Po ashtu, kur sahabët e pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.): "O Resulullah! A bën pjesë tek veprat e mira thënia La ilahe il-llah?", ai u përgjigj duke thënë: *"Ajo është më e mira e të mirave!"*[3]

Jeta kalon në formën e luftës mes së mirës dhe së keqes. Dhe të gjitha të mirat, janë e kundërta e të këqijave, e mbase edhe armiqtë e tyre. Në ajetet që po analizojmë, është aluduar në faktin se e para e këtyre të kundërtave, mund të shtohet edhe më shumë. Për shembull, nëse në një enë ndodhet një masë e përbërë nga më shumë se një përzierje, sa më shumë të shtosh masën e njërës prej përzierjeve, në mënyrë të natyrshme do të pakësohet edhe masa e përzierjeve të tjera në krahasim me të parën. Pak nga pak, ngjyra, aroma dhe natyra e përzierjes së shtuar, do të bëhet mbizotëruese, ndërkohë që të tjerat do të jenë më të zbehta dhe më pak ndikuese.

Nga këto ajete fisnike, të cilat na tregojnë mënyrën më të sigurt për të shpëtuar nga presioni i dëshirave që çojnë në gjynahe dhe atë të lartësimit shpirtëror, kuptojmë se kjo është e mundur me anë të përkujtimit të Allahut, gjë që gjendet në leximin e Kuranit dhe në namaze. Për ata që e lexojnë Kuranin duke menduar në kuptimet e tij, hapen dyer të kuptimit të urtësive dhe mësimeve që nuk janë vërejtur më parë dhe e ngre nivelin e ndjenjave dhe mendimeve. Fakti që leximi i Kuranit është porositur dhe në shumë hadithe fisnike, vërteton pikërisht këtë që po themi.[4] Po ashtu, në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm edhe rrënjosja e namazit në personalitetin e besimtarit bashkë me fisnikërinë dhe dashurinë e tij. Është e paimagjinueshme që një namazli i vetëdijshëm, të bëjë vepra të këqija dhe të këmbëngulë në to.

Për rrjedhojë, ne mendojmë se duke filluar prej atyre që përmenden në ajetet e mësipërme, duhet menduar një për një në lidhje me cilësitë që duhet të gjenden tek një mysliman në kuptimin e vërtetë të fjalës. Për shembull, në lidhje me drejtësinë, me mos animin nga të padrejtët, të jetuarit me vetëdijen e kontrollit hyjnor, etj., duhet bërë një vetllogari e sinqertë dhe serioze, duke pasur për qëllim përcaktimin e situatës personale, pra, "ku ndodhem në këtë çështje dhe ku duhet të jem?..

Si përfundim, mund të themi pa ngurrim, se mënyra e pakësimit të të këqijave, është padyshim shtimi i të mirave.[5] Nisur nga kjo, shtimi i përgjigjeve pozitive që do të jepen gjatë llogarisë së vetvetes, ka një rëndësi jetike.

1. Hakk'ın Dâveti Kur'ân-ı Kerîm Meâli ve Tefsîri, Prof. Dr. Ömer Çelik, Erkam Yayınları, 2013, c. 2, s, 590.

2. Ruhu'l-Bejan, V.8, fq. 556.

3. shih. Mundhir, Tergib, III/75.

4. shih. Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21; Buhari, Teuhid, 52; Buhari, Ilm, 55; Muslim, Musafirin, 152 ve 253; Ebu Davud, Vitr, 20.

5. shih. Nahl, 125.



Mëshira është sakrificë

Prof. dr. Sulejman Derin

Allahu i Madhëruar, kur na përshkruan Profetin (a.s.) dhe sahabët, si cilësinë e tyre të parë, përmend ashpërsinë që kishin ndaj mohuesve dhe mëshirën e jashtëzakonshme ndaj njëri-tjetrit. Madje, Allahu e ka përmendur mëshirën mes besimtarëve edhe para adhurimeve më të çmuara të fesë, si namazi dhe sexhdeja. Po ashtu, edhe Imam Rabbani na ka tërhequr vëmendjen tek kjo cilësi e Profetit (a.s.) dhe shokëve të tij, duke u shprehur:

"Allahu i Madhëruar, në ajetin; «***Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre...***" (Fet'h, 29), e ka lavdëruar Profetin tonë (a.s.) dhe shokët e tij për shkak të mëshirës që kanë ata ndaj njëri-tjetrit. Fjala «rahim», që është edhe njëjësi i fjalës «ruhama», për shkak se shpreh teprimin në mëshirë dhe është "sifat mushebbehe", ajo nënkupton përhershmëri në mëshirë.

Dashuria mes tyre dhe mëshira që treguan myslimanët e parë ndaj njëri-tjetrit, vazhdoi i njëjtë si kur ishte Profeti gjallë, ashtu edhe pas vdekjes së tij. Kjo, sepse prej tyre është larguar përfundimisht çdo qëndrim i pahijshëm që bie ndesh me këtë mëshirë dhe dashuri që kanë ata ndaj njëri-tjetrit. Sjelljet e ulëta si urrejtja, mëria, smira dhe armiqësia ndaj njëri-tjetrit, është larguar përfundimisht prej tyre, sepse fjala «ue'l-ledhijne» që përdoret në ajet, ka cilësi gjithëpërfshirëse dhe të përgjithshme. Pra, ashtu siç e kërkon edhe kjo fjalë, të gjithë sahabët kanë pasur cilësitë e bukura që përmenden në ajet..." (shih. V. III, Letra 24.)

Kështu, siç e ka shprehur edhe Imam Rabani, mëshira ka qenë cilësia e përbashkët e sahabëve, gjë për të cilën dëshmon edhe historia. Kur myslimanët e Mekës emigruan në Medinë, myslimanët e Medinës, ensarët, treguan një mëshirë dhe solidaritet të paparë në të gjithë historinë njerëzore, duke mikpritur në shtëpitë e tyre me qindra familje muhaxhirësh dhe për më tepër, duke ndarë me ta gjithçka që kishin, që prej gjërave më të vogla, e deri tek shtëpitë dhe bahçet e hurmave. Falë kësaj mëshire të pashoqe, askush nuk mbeti i uritur dhe pastrehë.

Një tjetër detaj interesant që ndodhet në këtë ajet, është edhe fakti se Allahu i Madhëruar, shokët e të Dërguarit të Vet (a.s.), i ka prezantuar me shprehjen *"ata që ndodhen pranë tij"*. E në fakt, në mënyrë metaforike, edhe ne kemi mundësi të jemi pranë Profetit tonë (a.s.), sepse të gjithë ata që e pranojnë fenë e tij dhe jetojnë si ai, kanë nderin të jenë afër tij. Kurse ata që veprojnë të kundërtën, janë larg Profetit (a.s.), si në mendim, ashtu edhe në mënyrë jetese.

Një besimtar që ndodhet afër Profetit të vet, në

të njëjtën kohë, është i ashpër me armiqtë e fesë dhe i mëshirshëm ndaj besimtarëve të tjerë. Ndërsa ai që largohet nga Profeti (a.s.), tregohet i butë me njerëzit e këqij dhe i ashpër ndaj besimtarëve. Për rrjedhojë, besimtarët e devotshëm, janë ata që kanë arritur ta përcjellin më së miri deri në ditët tona mëshirën e Profetit (a.s.) dhe njerëzve që ishin pranë tij.

Bazuar në parimin e **"madhërimit të urdhrave të Allahut dhe mëshirë për krijesat e Tij"**, sahabët ata nuk kanë treguar mëshirë vetëm për njerëzit, por edhe për të gjitha krijesat e tjera të Allahut. Iamam Rabbani shprehet:

"Këto cilësi ishin shfaqur në mënyrë më të përkryer tek të gjithë sahabët, por veçanërisht tek Ebu Bekri (r.a.), për të cilin i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *«Më i mëshirshmi për umetin tim ndër të gjithë, është Ebu Bekri.»* (Tirmidhi, hadithi nr: 3790)"

Në këtë aspekt, ka shumë njerëz të devotshëm që e kanë marrë shembull Ebu Bekrin (r.a.), për mëshirën dhe butësinë e tij. Një nga këta është edhe Ebu'l Hasan Harakani i cili thotë: *"Gjembi që ka shpuar gishtin e dikujt diku nga Turkistani në Sham, ka shpuar gishtin tim; një gur që ka vrarë këmbën e dikujt, ka vrarë këmbën time; nëse në një zemër ka trishtim, ajo zemër është e imja."*

Ndërsa Ali Ramitani ka thënë: *"Ka shumë që shërbejnë duke të kujtuar mirësinë që bëjnë, por ka pak prej atyre që shërbejnë duke e konsideruar si mirësi mundësinë për të shërbyer."* Pra, me këto fjalë, ai ka dashur që ne ta konsiderojmë mirësi edhe mundësinë që kemi për të shërbyer në rrugë të Allahut.

Po ashtu, edhe një nga të mëdhenjtë e rrugës shpirtërore, Bahauddin Nakshibendi, ka thënë se pjekuria që kishte arritur në atë rrugë shpirtërore, ishte falë shërbimit dhe mëshirës ndaj njerëzve dhe kafshëve. Me pak fjalë, udhëtarët e kësaj rruge shpirtërore, nuk janë bërë të njohur vetëm për adhurimin dhe madhërimin e Allahut, por edhe për mëshirën e pashoqe që kanë treguar ndaj të gjitha krijesave.

Falënderimi i takon Allahut, që edhe sot ka shumë besimtarë që e ndjekin rrugën e bekuar të mëshirës së besimtarëve të parë. Në sajë të ndihmës dhe solidaritetit të besimtarëve anembanë botës, shumë fondacione dhe shoqata bamirëse kanë zgjatur dorën e ndihmës materiale dhe shpirtërore për nevojtarët dhe të vuajturit në Afrikë, Palestinë, Jemen, Siri, etj., duke treguar në mënyrë të hapur se, edhe sot ka shumë besimtarë që janë pranë të Dërguarit të Allahut dhe ndjekin hapat e tij të bekuar. Prandaj, ankimi dhe keqardhja vetëm me fjalë, duke shpërndarë mesazhe të mbushura me hidhërim, nuk i bëjnë dobi askujt. Ja si e përshkruan Mevlana gjendjen e atyre që veprojnë kështu:

"Një beduin kishte një qen që e donte shumë. Një ditë, qeni sëmuret dhe ishte duke dhënë shpirt. Kur e kuptoi se qeni po ngordhte, beduini filloi të qajë me dënesë. Atypari po kalonte një lypës, i cili u bë kureshtar dhe pyeti:

- Pse po qani kështu? Çfarë ka ndodhur?

- Kam një qen shumë të mirë dhe të zgjuar, por po më ngordh këtu në mes të rrugës. Prandaj po qaj. – Tha beduini i hidhëruar. Lypësi kujtoi se beduini ishte shumë i varfër dhe i tha:

- Për këtë duhet bërë durim, sepse Allahu i shpërblen durimtarët. – Më pas e pyeti:

- Si e kishte hallin qeni, pse po ngordh?

- Qeni im po vdes nga uria!.. -i përgjigjet beduini. Lypsari sheh përqark dhe e pyet përsëri:

- Çfarë ka në atë trastë të varur në mur?

- Bukë, ushqimi im që ka mbetur nga mbrëmja e kaluar. – tha beduini. Lypësi, i habitur jashtë mase, i tha:

- Po atëherë, përse nuk i dhe një copë bukë qenit të gjorë, por rri duke qarë këtu!? – Përgjigja e beduini ishte edhe më interesante:

- Bukën askush nuk ta jep pa para!.. Por siç e sheh, lotët janë falas... Prandaj më lër të qaj sa të ngopem!

Lypësi i shkretë u shashtis fare nga këto fjalë dhe i tha:

- O njeri kokëbosh! Domethënë, për ty, buka është më e shtrenjtë se lotët!? Por në fakt, loti është gjak. Halli e ka shndërruar atë në ujë. A derdhet gjaku kot për bukën që vjen nga toka? – dhe ashtu vazhdoi rrugën i nxehur." (Mevlana, Mesnevi, V. 5: 477-488.)

Sot, bota Islame po digjet në çdo anë; lufta, uria, varfëria, sëmundjet dhe problemet e pafundme nuk po i ndahen asnjëherë myslimanëve. Zjarri është i madh, armiku i fuqishëm dhe mundësitë të dobëta. Për këtë arsye, çdonjëri prej nesh është i detyruar t'i zgjasë dorën e mëshirës vëllezërve tanë, njësoj siç veproi Profeti ynë (a.s.) dhe sahabët e nderuar. Nëse e kanë bërë ata, mund ta bëjmë edhe ne, sepse një zemër e pjekur shpirtërisht, nuk mund t'i shohë ndryshe myslimanët dhe krijesat e tjera të Allahut. Të mos harrojmë se, çdo shërbim ndaj robërve të Allahut, është si një lloj borxhi që i jepet Zotit, që nesër, në botën tjetër do të na dalë para si shpërblim i shumëfishtë.

Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur të jetojmë me këtë vetëdije dhe të pasojmë me përpikëri mëshirën dhe butësinë e Profetit tonë (a.s.) dhe shokëve të tij të nderuar.

Amin!..

VETËDIJA NDAJ PËRGJEGJËSISË


Ali Riza Temel

Njeriu përkufizohet si qenie që mendon, gjallesë së flet. Mirëpo, përkufizimi i tij si një qenie që bart përgjegjësi, është më gjithëpërfshirës.

Detyra e vështirë e njeriut si mëkëmbësit të Allahut në tokë, në të njëjtën kohë, i ngarkon atij edhe një përgjegjësi të madhe, sepse ai ka marrë mbi supe amanetin të cilin nuk kanë guxuar ta marrin as qiejt, as toka dhe as malet.

Allahu i Madhëruar, ka vënë në shërbim të njeriut çdo gjë në qiell dhe në tokë dhe e ka pajisur atë me aftësinë dhe forcën për të menaxhuar mbi to. Kjo aftësi, forcë dhe mundësi që i është dhënë atij, padyshim se sjell me vete edhe një përgjegjësi të madhe.

Njeriu nuk është një gjallesë e rëndomtë. Ai është krijesa më e nderuar e Zotit. Kafshët nuk pyeten për ato që veprojnë, sepse nuk zotërojnë mendje dhe vullnet. Megjithatë, falë instinktit që ka vendosur Allahu në natyrën e tyre, ato ndjejnë përgjegjësinë e ushqyerjes, rritjes dhe mbrojtjes së të vegjëlve të tyre, për të cilët vënë në rrezik edhe jetën e vet. Kështu, ndërkohë që edhe kafshët ndjejnë një lloj përgjegjësie në bazë të instinktit që u është dhënë, është e pamendueshme që njeriu, të cilit i është dhënë gjithçka në përdorim, të jetë papërgjegjësi.





Lidhur me këtë përgjegjësi të njeriut, flitet edhe në Kuran, edhe në hadithet autentike:

"A menduat se Ne u krijuam kot dhe se nuk do ktheheni ju te Ne *(për të dhënë llogari)**?"*** (Mu'minun, 115.)

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë *(e kësaj bote)**!"*** (et-Tekathur, 8.)

"Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë" (Zelzele, 6-8.)

Ndërsa Profeti (a.s.), ka thënë:

"Në ditën e kijametit (gjykimit), asnjë rob nuk do të lëvizë prej vendit pa u pyetur për katër gjëra: Ku e ka shpenzuar jetën, çfarë ka punuar me dituritë (që ka fituar), ku e ka fituar dhe ku e ka harxhuar pasurinë dhe ku e ka vjetërsuar trupin e tij."[1]

NJERIU QË IA KA KUSHTUAR VETEN RUAJTJES SË DIÇKAJE, I MBAN SYTË HAPUR DHE QËNDRON VIGJILENT, ME QËLLIM QË TË MOS E PËRJETOJË HIDHËRIMIN E MOSKRYERJES SË DETYRËS. NJERIU QË ZOTËRON NDJENJËN E PËRGJEGJËSISË, E SHEH VETEN PËRGJEGJËS PËR GJITHÇKA DHE NUK E NEGLIZHON DETYRËN E VET PËR ASGJË NË BOTË.

Pra, në këtë botë nuk ka askush, që zotëron mendje të shëndoshë dhe vetëdije, e që të jetë pa përgjegjësi. Sa të jetojnë këtë botë, të gjithë luajnë një rol, ose qeverisës, ose të qeverisur. Ata që qeverisin apo drejtojnë, janë përgjegjës për ata që kanë nën drejtim, ndërsa të qeverisurit, janë përgjegjës për punët që u janë ngarkuar. Këtë përgjegjësi, Profeti ynë (a.s.), e shpjegon kështu në mënyrë gjithëpërfshirëse:

"Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete).

- Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij.

- Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij.

- Gruaja është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj.

- Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet." (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20.)

Ndjenja e përgjegjësisë, është një udhëzues që i jep drejtim jetës së njeriut dhe e shpëton atë nga të jetuarit kot dhe pa synim. Prandaj, kjo ndjenjë nuk duhet të verbohet asnjëherë, por duhet mbajtur gjithmonë e gjallë. Nëse kjo ndjenjë dobësohet, njeriu largohet nga njerëzorja dhe në këtë mënyrë, ai bëhet problem edhe për veten, edhe për shoqërinë ku jeton.

Me qëllim që njeriu të bëjë një jetë vërtetë dinjitoze dhe të kryejë me sukses detyrën e tij si mëkëmbësi i Allahut në tokë, Allahu ia ka bërë të ditur të gjitha detyrat e tij në mënyrë të detajuar, duke i dërguar profetë dhe libra. Ndërsa njeriu, do të jetë i lumtur ose jo në këtë botë dhe në botën tjetër, në bazë të kryerjes ose jo të këtyre detyrave. Pra, siç shprehet edhe Allahu i Madhëruar në Kuran: ***"Çdo njeri është peng i veprave të veta"*** (Muddeththir, 38.)

Përgjegjësia e njeriut, është në përputhje me mundësinë e tij, sepse Allahu i Madhëruar nuk e ka ngarkuar askënd me përgjegjësi përtej mundësive të tij.

Përgjegjësia e parë dhe më e rëndësishme e njeriut, është ajo ndaj Zotit të vet. Besimi i Zotit pa i shoqëruar Atij asnjë zot apo idhull tjetër dhe kryerja e të gjitha detyrave ndaj Tij brenda mundësive, është domosdoshmëri e kësaj përgjegjësie. Nuk ka dobi prej atij që nuk e njeh Krijuesin e vet dhe nuk e falënderon Atë për mirësitë e panumërta që i ka falur. Të jetosh me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj Allahut, është e mundur vetëm nëse robi e kupton se ka ardhur



1. -Tirmidhi, Kijamet, 1.



prej Allahut, i takon Atij dhe se do të kthehet përsëri tek Ai.

Ai që beson se gjithçka i përket Allahut, tregon mëshirë dhe dashuri ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Si fillim, ai i jep të drejtën trupit të vet, duke u kujdesur për të dhe duke i kryer të gjitha detyrat e devotshmërisë në mënyrën e duhur. Krahas kësaj, ai e zhvillon atë si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror, me qëllim që ta bëjë më rezistentë ndaj sëmundjeve fizike dhe shpirtërore. E në fakt, pa qenë i shëndetshëm fizikisht dhe shpirtërisht është e pamundur të çosh në vend përgjegjësitë që të takojnë.

Njeriu që arrin të plotësojë detyrat ndaj vetes, është i gatshëm të marrë përsipër edhe përgjegjësi të tjera. Ai aktivizohet për të kryer edhe detyrat që ka ndaj familjes së vet, sepse familja e shëndetshme, është një nga domosdoshmëritë e paqes individuale dhe shoqërore. Allahu i Madhëruar urdhëron: ***"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin melekët"*** (Tahrim, 6.)

Furnizimi i familjes me ushqime dhe veshje hallall, është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të edukimit të tyre brenda normave njerëzore dhe morale. Duke filluar prej prindërve, të afërmit, fqinjët, e deri tek kolegët e punës dhe nevojtarët, të gjithë njerëzit, pa dallim feje, ngjyre, gjuhe dhe statusi social, janë në fushën tonë të përgjegjësisë. Të bëhesh ortak në hallet dhe gëzimet e tyre dhe ilaç për plagët e tyre, është nga treguesit se jemi myslimanë të mirë.

Sa bukur e ka thënë Tolstoi: "Nëse njeriu ndjen dhimbje, është gjallesë. Por, nëse ndjen dhimbjen e tjetrin, është njeri." Ky është edhe kushti për të qenë mysliman i mirë: *"Ai që nuk dëshiron për vëllain e tij të fesë atë që dëshiron për veten e tij, nuk mund të jetë besimtar i vërtetë."* (Buhari, Iman, 7.)

Gjithashtu, siç kemi përgjegjësi ndaj njerëzve, kemi përgjegjësi edhe ndaj bimëve, kafshëve dhe ambientit që na rrethon. Prerja e pemëve pa kriter, ndotja e ambientit dhe torturimi i kafshëve, janë shembuj të papërgjegjësisë, e cila është e dënueshme në Islam. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"T'i bësh mirë çdo gjallese që merr frymë, është sadaka!"* (Buhari, hadithi nr: 2363)

Myslimani është përgjegjës për çdo që ndodh në botë. Këtë përgjegjësi, ia ka dhënë Vet Allahu: ***"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin:*** *(sepse)* ***ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun..."*** (Ali-Imran, 110.) E, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja duhet të kryhet patjetër me çdo mundësi. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Kush sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Por nëse edhe për këtë nuk ka mundësi, le ta urrejë me zemër. Mirëpo, kjo është shkalla më e ulët e besimit."* (Muslim, Iman, 78.)

Përpjekja dhe lufta e të gjithë profetëve, duke vënë në rrezik edhe jetën e tyre, është shprehje e qartë e kësaj përgjegjësie që ka njeriu. Për këtë shkoi edhe Profeti ynë (a.s.), në Taif, dhe për këtë i duroi të gjitha të këqijat që i bënë. Për këtë arsye emigruan edhe myslimanët e parë në Etiopi e në Medinë, duke lënë pas vendlindjen, shtëpitë dhe pasuritë e tyre.

Ai që ndjen përgjegjësi, përballon çdo vështirësi për të kryer detyrën e tij. Kjo ndjenjë e bëri edhe Omerin (r.a.), të thoshte: "Nëse një dele bie dhe mbytet në ujin buzë lumit Tigër, Allahu do t'i kërkojë llogari Omerit."

Për rrjedhojë, një njeri që ia ka kushtuar veten ruajtjes së diçkaje, i mban sytë hapur dhe qëndron vigjilent, me qëllim që të mos e përjetojë hidhërimin e moskryerjes së detyrës. Njeriu që zotëron ndjenjën e përgjegjësisë, e sheh veten përgjegjës për gjithçka dhe nuk e neglizhon detyrën e vet për asgjë në botë.



MARRËDHËNIET NDËRNJERËZORE TEK TË DASHURIT E ALLAHUT

Dr. Adem Ergyl

Cilësia e njeriut, matet me cilësinë e marrëdhënieve të tij me njerëzit e tjerë. Siç shprehen edhe specialistët e komunikimit, *"njeriu, është një qenie që ripërkufizohet vazhdimisht brenda marrëdhënieve ndërnjerëzore"*.

Çdo marrëdhënie, ju shton, ose ju pakëson një vlerë. Një prej qëllimeve të dërgimit të të gjithë librave hyjnorë dhe profetëve, e mbase edhe më kryesori, mund të thuhet se është vendosja e marrëdhënieve njerëzore në një truall të shëndoshë. Në fakt, këtu bëhet fjalë për një gamë të gjerë marrëdhëniesh të njeriut, siç është ajo me Allahun, me veten e tij, me njerëzit e tjerë dhe të gjitha krijesat në gjithësi.

Por ne, këtu do të trajtojmë në mënyrë të veçantë marrëdhënien e njeriut me njerëzit e tjerë. Kjo, për faktin se këtë fushë e konsiderojmë shumë të rëndësishme, sepse këto janë marrëdhëniet që e pasqyrojnë në botën e jashtme moralin tonë. Dhe, niveli i moralit tonë, është i lidhur ngushtë me besimin tonë, devotshmërinë, cilësinë e jetës, paqen, me këtë botë, me botën tjetër dhe vlerën tonë tek Allahu i Madhëruar.

Profeti ynë (a.s.), moralin e të cilit e ka lavdëruar Vet Allahu i Madhëruar, ka thënë:

"Unë jam dërguar vetëm për të plotësuar moralin e bukur" (Muvatta, Husnu'l-Hulk, 8.)


"Më i miri prej besimtarëve nga aspekti i besimit është ai që ka moralin më të lartë." (Ahmed, II, 250.)

"Gjëja që do të peshojë më rëndë në Mizan/Peshore ditën e kijametit, është morali i bukur!" (Ebu Daud, Edeb, 7/4799; Tirmidhi, Birr, 62/2002.)

"Më i afërti ndaj meje në ditën e kiametit do të jetë ai më i miri në shprehi dhe moral!" (Tirmidhi, Birr, 71.)



“Imagjinoja sikur mes meje dhe çdo njeriu tjetër rreth meje, kishte një litar. Kur litari tendosej shumë, aq sa gati nuk këputej, unë e lëshoja pak. Por, kur mendoja se e kisha liruar shumë, atëherë e tendosja menjëherë. Në këtë mënyrë u përpoqa t’i mbajë në ekuilibër dhe baraspeshë marrëdhëniet me të gjithë njerëzit.”



Në një shoqëri të përbërë nga individë të dobët e të sëmurë, është e pamendueshme të ketë paqe dhe përparim në aspektin e cilësisë së marrëdhënies. Populli i bekuar, është ai që përbëhet nga individë që kanë arritur një nivel të caktuar në cilësinë e marrëdhënieve brenda tyre. Në familjet, në rrethin shoqëror dhe në institucionet shtetërore ku zhvillohen marrëdhënie me nivel të ulët, nuk mund të arrihet asnjëherë lumturia dhe suksesi i dëshiruar. Një nga shkaqet më të mëdha të vështirësive që po përjetojmë sot në vendet me popullsi myslimane, padyshim që është dobësia dhe sëmundja në marrëdhëniet tona të brendshme dhe të jashtme.

Prandaj, ne kemi përgjegjësinë të rishikojmë edhe njëherë çështjen e marrëdhënieve tona, me qëllim që të ndërtojmë një individ dhe shoqëri në paqe. Një orientim i tillë drejt përmirësimit dhe mirësisë, është një detyrim edhe për një jetë të shëndetshme në aspektin e devotshmërisë ndaj Allahut. Fjalët profetike që përmendëm më sipër, janë edhe paralajmëruesit, edhe përgëzuesit më të mëdhenj të kësaj të vërtete.

Udhëzuesi ynë në këtë udhëtim, padyshim se do të jenë vlerat e qytetërimit tonë. Ndërsa burimi i këtyre vlerave, është Kurani Fisnik, Profeti ynë (a.s.) dhe profetët e tjerë që ka zgjedhur e na ka dërguar Ai dhe trashëgimtarët e profetëve, që janë dijetarët e vërtetë të cilët kanë ndjekur gjurmët e tyre. Padyshim se, edhe përvojat njerëzore që nuk bien ndesh me këto vlera, janë shumë të rëndësishme për ne, sepse zëri i ndërgjegjes dhe natyrës së pastër njerëzore, është edhe zëri i së vërtetës.

Ibn Ataullah el-Iskenderi, ka thënë:

“Nëse Allahu i Madhëruar do të të linte vetëm për vetëm me veten tënde, të këqijat dhe paturpësitë e tua nuk do të kishin fund. Por, nëse Allahu shfaq mbi ty mirësitë e Veta, atëherë virtytet e tua të lavdërueshme nuk do të kishin të numëruara.”

Sa më shumë që robi përpiqet t’i afrohet Allahut, aq më shumë i shtohet bukuria dhe përsosmëria. Pastrimi shpirtëror, që është edhe synimi i edukimit shpirtëror, është një edukim, ndikimi i të cilit shihet, si në organet e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtmet dhe në shqisat e njeriut. Nisur nga kjo, nëse njeriu vazhdon në rrugën e përkryerjes, ai duhet të plotësohet edhe në aspektin butësisë dhe delikatesës në moral dhe në sjellje. Nëse nuk ndodh një përmirësim i tillë, do të thotë se nuk po ecet drejt së vërtetës dhe nuk po bëhet përparim.

Edukimi Islam, në marrëdhëniet mes individëve -përveç armiqve të njohur të Allahut dhe të vërtetës- ka për bazë paqen, qetësinë, dashamirësinë, dashurinë, butësinë, delikatesën dhe mirësjelljen.

Njeriu është një qenie me aftësinë e familjarizimit. Dhe për shfaqjen e këtyre cilësive, është i nevojshëm pastrimi/edukimi. Pastrimi, shpreh edhe largimin e cilësive dhe veseve të këqija, por edhe pajisjen me virtyte dhe pjekuri.

Me çdo njeri, të cilit nuk i janë shkatërruar aftësitë njerëzore dhe nuk e ka kyçur veten me urrejtje, smirë, intrigë dhe armiqësi, në njëfarë më mënyre mund të krijohen marrëdhënie. Në këtë kuptim, mund të themi se është e mundur të arrish një nivel familjariteti falë të cilit mund të kalohet mirë me të gjithë.

Amr ibn As (r.a), i cili ka kryer me sukses detyrën e tij si Guvernatori i Egjiptit, u pyet se si e kishte arritur këtë sukses. Ai u përgjigj:

"Imagjinoja sikur mes meje dhe çdo njeriu tjetër rreth meje, kishte një litar. Kur litari tendosej shumë, aq sa gati nuk këputej, unë e lëshoja pak. Por, kur mendoja se e kisha liruar shumë, atëherë e tendosja menjëherë. Në këtë mënyrë u përpoqa t'i mbajë në ekuilibër dhe baraspeshë marrëdhëniet me të gjithë njerëzit."

Çdo njeri i përjashtuar, do të thotë se është shtyrë në pozitën e kundërshtarit apo në radhët e atyre që mbështesin armikun. Prandaj, në vend që të veprohet kështu, mbajtja e të gjithëve brenda një rrethi, kërkon një prijësi të zgjuar, të urtë dhe të vullnetshme. Që të ekuilibrosh atë që e tepron, të shtysh përpara atë që mbetet pas, të afrosh atë që është larg dhe të edukosh pa e llastuar atë që ke afër, kërkon me të vërtetë një metodë menaxhimi të zgjuar dhe të urtë. Drejtësi, nuk do të thotë t'i trajtosh të gjithë në mënyrë të barabartë, por t'i japësh të gjithëve atë që meritojnë dhe kanë nevojë.


Të dashurit e Allahut, janë njerëz të suksesshëm në komunikim, sepse në sajë të morali të bukur që kanë zotëruar, kanë ditur t'i mbajnë bashkë edhe ata që kanë pasur karaktere të kundërt me njëri-tjetrin. Sekretet që qëndrojnë pas suksesit të tyre, do t'i trajtojmë në shkrimet e ardhshme, aq sa të na japë mundësi Allahu i Madhëruar. Mirëpo, mund të them që tani se, në qendër të komunikimit të tyre, ishte zemra. Këtu përfshihet edhe pastërtia e zemrës së tyre, dorëzimi tek Allahu, përgjërimi me përulje, botëkuptimi i gjerë dhe dëshira e mirë për çdokënd; por edhe fakti se ata i trajtonin me respekt zemrat e njerëzve me të cilët komunikonin. Po ashtu, falë pastërtisë së zemrës, që u ka dhënë shpëtimi nga egoizmi, ata marrin dhe japin mirësi. Në gjerësinë dhe thellësinë që u fal qetësia shpirtërore, ata frymojnë paqe dhe përhapin aromë paqeje përreth. Duan dhe duhen...

Mes marrëdhënieve njerëzore dhe gjerësisë apo ngushtësisë shpirtërore, ka një lidhje të ngushtë. Për shkak se zemrat e miqve të Allahut janë të gjera falë vullnetit për ta jetuar besimin, Islamin dhe mirësinë në nivelin e përkryerjes, ata kanë zhvilluar një marrëdhënie të bazuar në dashuri dhe dashamirësi me të gjitha krijesat.

Sigurisht që është e pamundur që në marrëdhëniet njerëzore të realizosh një nivel të njëjtë me të gjithë, por megjithatë, duhet që të përpiqesh të mbash drejtësi në çdo marrëdhënie. Siç dihet, drejtësi, nuk do të thotë barazi, por t'i japësh çdokujt atë që meriton, në mënyrën që e meriton. Dhe kjo, kërkon dije, kulturë, urtësi dhe zgjuarsi. Ja pra, edhe miqtë e Allahut, janë njerëz fatlumë që e kanë arritur në masë të madhe këtë virtyt -edhe pse mes tyre mund të ketë dallime në grada-. Për këtë arsye, ndërkohë që do të trajtojmë temën e marrëdhënieve njerëzore, do të japim më tepër shembuj prej kritereve dhe modelit të sjelljes së tyre.

Tani, pa e zgjatur shumë, dëshirojmë që këtë shkrim në formë hyrjeje, ta mbyllim me fjalët e Sahibu'l-Vefa, Musa Efendisë në lidhje me këtë çështje:

"Në mirësjellje nuk ka kufi, por ajo ndryshon sipas njerëzve. Një njeri i mirësjellshëm, duket si i paedukatë para një njeriu edhe më të mirësjellshëm. Duhet edhe mirësjellja, por duhet të thuhet edhe e vërteta. Disa njerëz tregohen shumë të butë. Madje, këtë e kanë bërë zakon dhe thonë; unë do të shkoj mirë me të gjithë pa përjashtim, besimtar a jobesimtar qoftë. Mirëpo, predikuesit dhe thirrësit në fe, nuk ia mbyllin sytë gjithçkaje. Dikujt i thurin lavde, dikujt i vrenjtin fytyrën, e dikujt tjetër nuk i japin as mundësinë për të folur. Në mirësjellje, e drejta dhe drejtësia duhet të ecën së bashku. Ka njerëz që janë të sjellshëm dhe shkojnë mirë me të gjithë. Ata tundin kokën gjithmonë, e thonë "po zotëri!". Dikush bën thashetheme e përgojon; e edhe atyre u tundin kokën, duke u bërë bashkëpunëtorë të tyre edhe në gënjeshtra. Punët e drejta dhe me kriter janë mirësi e Allahut. Por gjithsesi, intriga, smira dhe dashuria për post, duhet të dalin nga zemra."



PËRGJEGJËSIA JONË PËR TË RUAJTUR LUMTURINË E BESIMIT

Prof. dr. Ismail Lufti Çakan

Parimet e mbrojtjes së besimit në aspektin e të shprehurit.

Si fillim, është me dobi të përcaktojmë drejtimin e parimit të kësaj çështjeje, duke thënë se duhet bërë kujdes në momentet e zemërimit dhe acarimit. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron: ***"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit."*** (Al-i Imran, 133-134.)

Siç kuptohet edhe nga ky ajet fisnik, "kapërdimi i zemërimit", është cilësi e njerëzve të devotshëm, të mbushur me respekt ndaj Allahut dhe të vetëdijshëm ndaj detyrave dhe përgjegjësive, që e ruajnë dhe bëjnë kujdes për veten. Në përgjithësi, kur njeriu nxehet, nuk i dëgjon fjalët që i dalin nga goja, ofendon dhe mund të hyjë edhe në kufr (mohim). Këto janë momentet më të rrezikshme për njeriun. Kur një person kërkoi këshillë nga Profeti (a.s.), ai i tha tre herë: *"Mos u nxeh!"*[1] Ndërsa për të ulur tensionin dhe zemërimin, Profeti (a.s.), ka këshilluar: *"Kur dikush prej jush të zemërohet, të ulet, nëse është në këmbë! Nëse i kalon zemërimi, s'ka më mirë, e nëse jo, atëherë le të shtrihet!"* (Ebu Daud, Edeb, 3/4782; Ahmed, V, 152.)

Nga ana tjetër, në Kuranin Fisnik, fjala *"dhulumat"*, që do të thotë "errësira, devijime, padrejtësi", është përdorur gjithmonë në shumës. Ndërsa fjala *"nur"*, që do të thotë "dritë", përdoret gjithmonë në njëjës. Kjo, tregon se rrugët e këqija janë të shumta, ndërsa rruga e drejtë është vetëm një. Për rrjedhojë, duhet bërë shumë kujdes ndaj fjalëve që themi. Përndryshe, -Allahu na ruajt- mund ta dëmtojmë besimin tonë, ose edhe mund ta humbasim pa qenë të vetëdijshëm. Atëherë, ajo që duhet bërë, është të mundim zemërimin dhe të bëjmë kujdes në ato që nxjerrim nga goja. Kjo është shumë e rëndësishme

1. shih. Buhari, Edeb 76; Tirmidhi, Birr 73; Muvatta', Husnu'l-Hulk 11; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 175,262.





në aspektin e ruajtjes së besimit, sepse i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka lajmëruar se, shkaku që do t'i hedhë njerëzit me fytyrë në Xhehenem, është ajo që nxjerrin nga gjuhët e tyre.[2]

Fjalët që bëhen shkak i futjes në kufr të një besimtari, quhen "shprehje kufri". Dhe, nëse ata që kanë arritur moshën e pjekurisë dhe flasin fjalë që të çojnë në kufër (mohim), me dashje dhe me qëllim, pa qenë të dehur, të përgjumur apo nën presion, pranohen si të dalë nga besimi. Ndërsa rrugëzgjidhja e kësaj, është pendimi/teubeja dhe rinovimi i besimit.

Fjalët që përmbajnë kuptime të kufrit/mohimit, janë:

Çdolloj ofendimi, përçmimi dhe tallje ndaj vlerave që konsiderohen të shenjta, siç janë Allahu, profetët, melekët, librat e shenjtë, feja, besimi, sahabët, ezani dhe shumë simbole të tjera Islame. Mohimi i ndonjërës prej cilësive të veçanta vetëm për Allahun, përngjasimi i Tij me krijesat, mospëlqimi dhe refuzimi i ndonjërit prej urdhrave të Allahut, pretendimi se profetët nuk janë të dërguarit e Zotit, ose nuk e kanë kryer siç duhet detyrën që u ka ngarkuar Ai dhe konsiderimi i dikujt dhe mendimit të tij, më të mirë se Profeti (a.s.) dhe mësimet e tij. Të thuash, "të mos e marrim për bazë Profetin", të pretendosh se Kurani Fisnik nuk është fjala e Allahut, të refuzosh njërin apo një pjesë të ajeteve të Kuranit; për shembull, të pranosh ajetet e Mekës dhe të refuzosh ato të Medinës, të pranosh Islamin dhe të refuzosh sheriatin, të tallesh me Kuranin duke thënë "janë ligje shkretëtire", të përçmosh dhe të tallesh me dijet fetare, me dijetarët, institucionet dhe shoqatat që shërbejnë me sinqeritet në fushën e fesë, të thuash fjalë që në njëfarë mënyre i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut, të akuzosh një mysliman për herezi pa pasur asnjë provë, pra

2. shih. Tirmidhi, Iman 8; Ibn Maxhe, Fiten 12; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 231,236,237.

"KAPËRDIMI I ZEMËRIMIT", ËSHTË CILËSI E NJERËZVE TË DEVOTSHËM, TË MBUSHUR ME RESPEKT NDAJ ALLAHUT DHE TË VETËDIJSHËM NDAJ DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE, QË E RUAJNË DHE BËJNË KUJDES PËR VETEN. NË PËRGJITHËSI, KUR NJERIU NXEHET, NUK I DËGJON FJALËT QË I DALIN NGA GOJA, OFENDON DHE MUND TË HYJË EDHE NË KUFR (MOHIM). KËTO JANË MOMENTET MË TË RREZIKSHME PËR NJERIUN.

t'i thuash atij "qafir" dhe të akuzosh ndonjë prej sahabëve për tradhti në fe, etj.

Siç dihet, akuza e tekfirit, nuk është një gjykim dhe një fjalë që mund të thuhet ashtu menjëherë. Sipas një hadithi fisnik, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: *"Nëse dikush i thotë vëllait të vet të fesë, "jobesimtar", kjo akuzë patjetër prek njërin nga të dy. Nëse vëllai është me të vërtetë ashtu, prek atë, nëse jo, akuza i kthehet akuzuesit."* (Buhari, Edeb 73; Muslim, Iman 111; Tirmidhi, Iman 16.)

Madje, sipas transmetimeve, Profeti (a.s.), e ka ndaluar ofendimin e sahabëve, të vdekurve, kohës, këndesit, erës, etj. Prandaj, lidhur me këto gjëra, duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Po ashtu, besimtari duhet të ruhet edhe nga ofendimi dhe sharja e gjyshërve, fisit, sojit, etj. Sot, vërejmë me keqardhje se shumë prej besimtarëve të rregullt, përdorin pa kriter, me dashje dhe padashje, fjalë të ndyta, sharje dhe ofendime të ndryshme. Nisur nga kjo, kuptohet qartë se besimtarët kanë nevojë për një edukim të mirë në lidhje me disiplinën e të shprehurit dhe mbizotërimin e gjuhës.

"Kur dikush prej jush të zemërohet, të ulet, nëse është në këmbë! Nëse i kalon zemërimi, s'ka më mirë, e nëse jo, atëherë le të shtrihet!"

(Ebu Daud, Edeb, 3/4782; Ahmed, V, 152.)





Sahabët dhe Urtësia

Shemseddin Kërësh

Të kuptosh yjet që ishin nxënësit e Profetit tonë të dashur (a.s.) dhe t'i duash ata, i ngjan një udhëtimi. Gjatë këtij udhëtimi, do të njohësh personalitete të atilla, të cilët ndriçojnë edhe ditët tona me kulturën, njohurinë dhe urtësinë që bartin.

Profeti ynë (a.s.), gjithmonë bënte shumë kujdes ndaj traditave dhe zakoneve të shoqërisë ku jetonte. Për shembull, kur i vinin vizitorë nga vende të ndryshme, më parë i pyeste, *"prej kujt jeni?"*. Kështu, edhe ata prezantoheshin me emrin e plotë të fisit të tyre. Pasi i dëgjonte me vëmendje, Profeti (a.s.), u thoshte, *"merhaban bilkaum!"*, që nënkupton; *"Mirë se vini! Rrini si në shtëpinë tuaj. Këtu jeni të qetë dhe të sigurt."*

Krahas kësaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), i theksonte në mënyrë të veçantë lëvdatat ndaj disa fiseve. Një nga këto fise që e meritojnë të përmenden për lëvdatat e veçanta që merrnin nga Profeti (a.s.), është edhe fisi i Esh'arive prej Jemenit, lidhur me të cilët, është thënë:

"Esh'aritë, kur u mbaronin furnizimet në luftë, ose kur i pakësoheshin ushqimet në familje, me-



njëherë e mblidhnin brenda një pëlhure aq ushqim sa kishin pranë dhe më pas e ndanin mes vete në mënyrë të barabartë. Esh'aritë janë prej meje dhe unë jam prej Esh'arive."

Esh'aritë nuk ishin shembull i bukur vetëm në ndjenjën e ndarjes me të tjerët, por kishin edhe cilësinë e dashurisë dhe sinqeritetit shembullor mes tyre. Krahas leximit të bukur të Kuranit dhe trimërisë në luftë, ata kanë kryesuar edhe në preferimin e mirësive të botës tjetër ndaj pasurive të kësaj bote. Kështu, cilësitë e lavdërueshme të Esh'arive nuk kanë të numëruara. Madje, edhe ardhja e tyre në Medinë, ishte një fenomen më vete. Për këtë, vet i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Nesër do të vijë një popull i atillë, zemrat e të cilëve janë më të nënshtruara se tuajat ndaj Islamit."*

Kur Esh'aritë po i afroheshin Medinës, recitonin poezi të tilla si; "gaden nelka'l-ehibbeh Muhammeden ue hizbeh / nesër do të takohemi me miqtë, me Muhamedin dhe shokët e tij."

Për rrjedhojë, të kuptosh një prej personaliteteve të larta të Esh'arive, siç ishte Ebu Musa el-Esh'ariu (r.a.) dhe transmetimet e tij, do t'i kujtojë shumë gjëra njeriut të sotëm. Historia e tij, na tregon se gjëja që njeriu duhet t'i japë më tepër rëndësi në këtë jetë, është feja, dhe se zotërimi e mbrojtja e saj, kërkon të marrësh parasysh çdo rrezik, përfshi edhe vdekjen.

Fakti që Ebu Musa (r.a.), ishte një prej "sahabëve të anijes", është shumë i rëndësishëm. Ai ishte një person dhe lider aq i suksesshëm, saqë mblodhi 53 veta në një anije dhe bashkë me dy vëllezërit e vet, organizoi programin e udhëtimit për tek Profeti (a.s.). Mirëpo, si pasojë e një furtune të papritur, anija e tyre zbarkoi në Etiopi, ku gjetën Xhafer bin Ebu Talibin (r.a.). Aty qëndruan për një farë kohe dhe, tre ditë pas triumfit të Hajberit, ata arritën së bashku me Xhaferrin (r.a.), në Medinë. Lidhur me ta, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"o shokët e anijes, ju keni arritur shpërblimin e hixhretit!"*. Kjo ndodhi e gëzoi aq shumë Profetin tonë (a.s.), sa edhe u shpreh: *"S'di cilës t'i gëzohem më parë; fitores së Hajberit, apo ardhjes së Xhaferrit me shokët e tij!?"*

Si është e mundur që 53 njerëz erdhën prej qindra kilometrave larg me një anije!? E në fakt, atyre nuk u kishte ardhur as ndonjë lajmëtar apo korrier që t'u kishte treguar për Profetin (a.s.). Si ishte e mundur diçka e tillë? Mirëpo, Ebu Musa (r.a.), thotë se, "ne e dinim që Muhamedi (a.s.), ishte dërguar si profet dhe se kishte emigruar në Medinë". Në fakt, vet ai ishte edhe njohës i kulturës së "ehli kitabit / jahudive dhe të krishterëve". Kjo, sepse Jemeni, si djep i civilizimeve, ishte një nga vendet ku njiheshin më mirë traditat, zakonet dhe letërsia e ehli kitabit. Njerëzit që mund "të kuptonin" ato që do të tregonte Profetit (a.s.), nuk ishin të pakët.

Kur Ebu Musa erdhi në Medinë, Abdullah bin Selami, i cili para se të bëhej mysliman, kishte qenë një prej dijetarëve jahudi, e priti në shtëpinë e vet dhe e gostiti me ushqim dhe hurma. Ndërsa pas fitores së Hajberit, ai nuk u nda asnjëherë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Po ashtu, për shkak se ishte njeri i ditur, atij iu dhanë edhe detyra administrative.

Ai gëzoi lutjet e Profetit (a.s.) dhe i lindën shumë fëmijë. Kur i lindi njëri prej fëmijëve, ai e dërgoi tek i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili i vuri emrin Ibrahim. Përveç këtij djali, atij i lindën edhe shumë djem e vajza të tjera. Madje, fakti që ai i këshilloi vajzat e tij që kurbanin ta thernin me dorën e tyre, tregon se sa edukim të mirë u ka dhënë ai fëmijëve të vet. E në fakt, a ka ndonjë vështirësi që nuk mund ta zgjidhë një grua që e pret kurbanin me dorën e vet!? Po ashtu, prej sojit të tij është edhe një prej dijetarëve më të shquar të Kelamit, Ebu'l Hasan el-Esh'ariu.

Një nga cilësitë e tij më të spikatura, është edhe ndjenja e turpit që zotëronte ai. Për shkak se i vinte turp prej Allahut, ai lahej në errësirë i mbledhur si grusht. Ebu Musa (r.a.), nuk largohej asnjëherë nga Profeti (a.s.). Madje njëherë, kur po qëndronte



si roje tek dera e kopshtit Eris për të Dërguarin e Allahut (a.s.), pati nderin të ishte sihariqtari me Xhenet i tre sahabëve të zgjedhur të Profetit (a.s.). I Dërguari i Allahut (a.s.), kishte varur këmbët në anë të pusit që ndodhej në mes të kopshti, me qëllim që të freskohej. Pas njëfarë kohe, Ebu Bekri, Omeri dhe Osmani (r.anhum), kërkuan leje për t'u takuar me Profetin (a.s.), në intervale kohe të caktuara. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëroi që të treve t'u jepet sihariqi se janë të përgëzuar me Xhenet. Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma), u ulën në anë të pusit dhe zgjatën këmbët. Kurse Osmani (r.a.), qëndroi veç. Në fakt, Profeti (a.s.), kishte thënë, "përgëzoje atë (Osmanin) me Xhenet bashkë me fatkeqësitë që do t'i ndodhin". Po ashtu, edhe varret e këtyre tre njerëzve të bekuar, që kishin zgjatur këmbët në pus, u vunë pranë e pranë. Kështu, miqësia e tyre kur ishin gjallë, vazhdoi edhe pas vdekjes, gjë të cilën e dëshmojmë saherë që shkojmë për të vizituar varrin e Profetit tonë (a.s.), në Medinë.

Ata që e shohin jetën e bekuar të Ebu Musa el-Esh'ariut (r.a.), vetëm në aspektin e "ndodhisë së arbitrimit", nuk e kanë njohur aspak atë. Në fakt, "ndodhia e arbitrimit" ishte caktim hyjnor. E madje, nuk është as ashtu siç e tregojnë disa libra të historisë. Mirëpo, kjo çështje duhet diskutuar në ndonjë shkrim tjetër.

Dijen, urtësinë dhe thellësinë e mendimit që zotëronte ai, mund ta kuptojmë nga transmetimet që na ka sjellë. Për shembull, ai i ka transmetuar hadithet: *"Ndryshimi ndërmjet atij që bën dhikër (përkujton Allahun) dhe atij që nuk bën dhikër, është si ndryshimi i të gjallit me të vdekurin."* (Buhari, Deavat, 66.), *"Në dhomë kisha lënë një sasi ari (ose argjendi që do të ndahej) si sadaka. Prandaj nuk mu duk e përshtatshme që ajo të qëndronte natën në shtëpi."* (hadith ky që porosit për nxitimin në mirësi) (Buhari, Zekat, 20.), *"Lehtësoni dhe mos vështirësoni! Përgëzoni dhe mos ngjallni urrejtje!"* (Muslim, Xhihad, 6.), etj. Ky hadith i Profetit (a.s.), i ka ardhur Ebu Musait dhe Muadhit (r.a.), kur janë dërguar për në Jemen. Administruesi lehtësues, meriton lavdërimin dhe lutjen e Profetit (a.s.).

Po ashtu, ky hadith i transmetuar nga Ebu Musa (r.a.), përmban mësime shumë të rëndësishme për njerëzit e ditëve tona: *"«E mira» dhe «e keqja» do të qëndrojnë para njerëzve ditën e kiametit. «E mira» (që ka bërë në dynja) do t'i përgëzojë ata të anës së vet dhe do t'u premtoj mirësi. Kurse «e keqja», rri e thotë «do t'ju vijë, do t'ju vijë». Kështu, njerëzit mundohen t'i ikin «së keqes», por nuk munden."* (Musned, IV, 391.)


Në mediat e ditëve tona, u jepet vend i gjerë lajmeve për dhunë, vrasje, vjedhje dhe shumë fenomene të tjera negative. Në këtë mënyrë, ata arrijnë të vendosin në vetëdijen dhe nënvetëdijen e njerëzve mesazhin, *"edhe juve do t'ju godasin këto të këqija"*. Kurse shumë fenomene të tjera pozitive, ose nuk publikohen asnjëherë, ose ceken shumë rrallë. Si përfundim, njerëzit kanë filluar t'i besojnë më pak njëri-tjetrit dhe, shumica e tyre, nuk jetojnë dot të qetë pa menduar se, *"një ditë, edhe neve do të na godasin këto të këqija"*. Për këtë arsye, ky hadith, duket sikur përshkruan kohën në të cilën jetojmë.

Ebu Musa (r.a.), ishte një sahab i ditur me botë të thellë mendimi. Vlerën e tij, e kuptojnë më mirë ata që janë dijetarë. Njëherë, dikush e pyeti në lidhje me farzet. Pasi u dha një përgjigje të shkurtër, u tha, *"pyeteni njëherë edhe Abdullah b. Mes'udin"*. Kur shkuan dhe e pyetën, ata morën një përgjigje më të bukur dhe më domethënëse. Më pas, ia treguan përgjigjen që u dha Ibn Mes'udi, me ç'rast Ebu Musa (r.a.), u tha: *"Për sa kohë që ky dijetar i thellë të jetë mes jush, mos më pyesni më mua!"*

Rrymat e mendimit që i orientojnë njerëzit në kahe të ndryshme, kanë ekzistuar në çdo periudhë. Për rrjedhojë, ata që sot thonë "përse Allahu nuk vë dorë tek të këqijat", kanë ekzistuar edhe në periudhën kur zbriti shpallja hyjnore. Prandaj, ky transmetim i Ebu Musa el-Esh'ariut, duhet menduar edhe njëherë sot, kur janë bërë të shumta debatet lidhur me "problemin e së keqes": *"Nuk ka më durimtar se Allahu i Lartë përballë padrejtësive që dëgjon! Politeistët i atribuojnë Atij fëmijë, kurse Ai përsëri vazhdon t'u japë rizk dhe shëndet!"* (Buhari, Edeb, 71.)

Allahu është durimtar dhe ndërhyrja e Tij në gjithësi bëhet me urtësi. Ai nuk anashkalon, nuk harron, por jep afat. Në fakt, shumë probleme lindin për shkak të mosnjohjes siç duhet të Allahut të Madhëruar. Ky transmetim i Ebu Musait (r.a.), e përshkruan shumë bukur Allahun e Madhëruar: *"Me vërtetë Allahu nuk fle, e as që i duhet gjumi; Ai e zbret drejtësinë (furnizimin) dhe e merr atë; te Ai ngrihen veprat e natës para ditës dhe veprat e ditës para natës! Perdja e Tij është dritë; sikur ta largojë atë, shikimi i dritës madhështore të Fytyrës së Tij do të digjte të gjitha krijesat tek të cilat arrin."* (Muslim, Iman, 293.)

Allahu i Madhëruar na e bëftë të gjithëve të mundur ta njohim siç duhet Atë dhe t'i kthejmë dijet tona në vepra! Amin!..



PËRSOSMËRIA E VEPRAVE ËSHTË NË LIDHJE ME NIJETIN

M. Sami Ramazanollu

"Vlefshmëria apo përsosmëria e veprave është në raport me nijetin. Të gjithë do të kenë (si shpërblim) vetëm atë për të cilën kanë bërë nijet. Andaj, kush bën hixhret për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij), hixhreti i tij (në të vërtetë) është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kush bën hixhret për këtë botë apo për ndonjë grua të cilën dëshiron ta martojë, me të vërtetë se hixhreti i tij është për atë gjë që ka bërë hixhret." (Buhari, Muslimi)

"Kush lufton në rrugë të Allahut duke mos e bërë nijet për gjë tjetër përveç sigurimit të ndonjë interesi të pjesshëm qoftë ky edhe sa lidhësja e këmbëve të devesë, domethënë duke menduar për ndonjë lloj përfitimi material, ajo që do t'i jepet atij është vetëm ajo gjë të cilën ka synuar. Ai nuk mund të marrë asnjë sevap nga Allahu." (Ahmed ibn Hanbel)

"Luftëtarët do të ringjallen vetëm sipas nijetit të tyre." (Ibn Asakir)

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'ariu (r.a.), se një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Ka prej atyre që luftojnë për pasuri. Ka prej atyre që luftojnë për famë. Ka prej atyre që luftojnë për shtirje. Cili prej këtyre është në rrugë të Allahut?" Resulullahu (a.s.), i tha: "Ai që lufton vetëm për ta lartësuar atë që ka thënë Allahu është në rrugë të Allahut." (Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi.)

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), duke thënë: "Njerëzit e parë për të cilët do të gjykohet kundër tyre në ditën e gjykimit janë:

1. Personi që ka rënë dëshmor. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'i flasë për mirësitë që ia ka pas dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do t'i thotë: 'Atëherë çfarë ke bërë kundrejt këtyre?' Ai do të përgjigjet: 'Kam rënë dëshmor në rrugën Tënde.' Allahu (xh.xh.), do t'i thotë: 'Gënjeve. Ti ke luftuar vetëm që të thuhej se je "trim dhe guximtar". Në të vërtetë u tha ashtu.' Pastaj jepet urdhër për atë dhe zvarritet me fytyrë përtokë derisa të hidhet në xhehenem.

2. Ai që mëson dije, ua mëson edhe të tjerëve dhe që lexon Kuran. Ai do të sillet në audiencën (hyjnore). Allahu do t'i flasë për mirësitë që ia ka pas dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu do t'i thotë: 'Çfarë ke bërë kundrejt këtyre?' Ai do të përgjigjet: 'Kam marrë dije. Atë ua kam mësuar edhe të tjerëve. Për hir Tëndin kam lexuar edhe Kuran.' Allahu do t'i thotë: 'Gënjeve. Ti more dije, në mënyrë që të thuhej se je "dijetar". Ti ke lexuar Kuran, në mënyrë që të thuhej se je lexues i Kuranit. Në të vërtetë ashtu u tha.' Pastaj jepet urdhër për atë dhe ai zvarritet me fytyrë përtokë derisa të hidhet në zjarr, domethënë në xhehenem.

3. Ky është personi të cilit Allahu Teala i ka dhënë nga çdo lloj i pasurisë. Ai do të sillet në audiencën hyjnore. Allahu do t'i flasë për mirësitë që ia ka pas dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu (xh.xh.), do t'i thotë: "Çfarë ke bërë kundrejt këtyre? Ai do të përgjigjet: "Nuk kam lënë asnjë mënyrë pa dhënë për të cilat ke urdhëruar që të japim. Të gjithë pasurinë time e kam harxhuar në rrugën Tënde. Allahu Teala do t'i thotë: 'Gënjeve. Ti i ke bërë këto vetëm që të thuhej se je bujar. Me të vërtetë ashtu u tha.' Pastaj jepet urdhër për atë dhe ai zvarritet me fytyrë përtokë derisa të hidhet në xhehenem." (Buhari, Muslim, Imaret, 152.)

"Njerëzit do të ringjallen vetëm sipas nijeve të tyre, domethënë do të ngrihen nga varret (vetëm sipas nijeve të tyre)." (Ibn Maxhe)



SHPREHIA DHE IBADETI

Doç. dr. Harun Ëmysh

Tragjeditë natyrore si tërmetet, erozionet, rrëketë etj. është e gabuar t'i vlerësosh si ndëshkime hyjnore përderisa nuk ka ndonjë cilësim fetar me argument të prerë siç gjenden në historitë e pejgamberëve. Por, edhe të mendosh se ngjarjet që ndodhin në këtë botë nuk kanë asnjë lidhje me Allahun Teala, nuk është një veprim prej besimi. Për besimtarin, qoftë edhe ngjarja më e vogël, ka lidhje me Allahun Teala të paktën nga aspekti i realizimit të saj me lejen e Atij. Nisur nga kjo, fatkeqësitë natyrore që ndodhin në shoqëritë që s'kanë pejgamber, për besimtarin mbartin mesazhe qortimi, paralajmërimi, mësimi etj. Kështu, gjithmonë kur ndodh ndonjë tërmet i madh, pothuajse të gjithë prej nesh nxjerrim mesazhe të tilla. Madje disa prej nesh e kalojnë cakun, edhe pse nuk kanë argument të prerë dhe të mbështetur në shpallje, duke gjykuar se fatkeqësitë natyrore janë ndëshkime hyjnore.

Përsëri, shumë prej nesh që jemi njerëz fetarë, na kaplon shpresa se atëherë, njerëzit që nuk janë të interesuar për fenë, do të bëhen fetarë qoftë edhe pjesërisht. Edhe vetë personalisht nuk mund të them se nuk kaplohem aspak nga një shpresë e tillë kur përjetoj fatkeqësi natyrore të tilla. Por sa herë më shfaqet nga brenda ndjenja e një shprese të tillë, e qortoj veten dhe i them:

"Mos vallë je bërë më fetar pasi e përjetove këtë fatkeqësi? Për shembull, më parë ke pas falur vetëm namazet farz dhe ke pas dhënë vetëm zekatin. Mos vallë pas kësaj ngjarjeje ke falur edhe nafilet, je ngritur për namaz nate dhe ke shpenzuar më shumë për bamirësi, që pret të fillojnë namazin ata që nuk falin namaz dhe ta lënë kamatën ata që punojnë me kamatë? Shumica dërmuese e njerëzve janë robër të shprehisë. Ti ke falur pesë kohët e namazit edhe para fatkeqësisë natyrore dhe e ke pas ushtruar veten me këtë. Për këtë arsye, edhe pas fatkeqësisë e vazhdove me lehtësi të njëjtën shprehi. Çfarë ndryshoi me ndikimin e fatkeqësisë përveçse e ndjeve më fuqishëm fuqinë hyjnore? Një njeri që nuk fal namaz dhe që punon me kamatë, i ka pranuar këto si sjellje normale para fatkeqësisë. Kështu që, edhe pasi të kalojë ndikimi i ngjarjes, do të fillojë përsëri t'i pranojë si normale..."

Po, e kam bërë me veten një llogari të tillë. Këtë e pranoj edhe sot. Madje, mendoj se sjelljet tona më shumë i caktojnë motivet sociale dhe kulturore se

sa feja. Domethënë, nëse disa prej nesh e marrim veten në llogari sinqerisht, do të shohim se disa prej sjelljeve negative nuk i bëjmë jo ngaqë i ka ndaluar Allahu, por ngaqë dënohen dhe nënçmohen nga ana e shoqërisë. Në të vërtetë, largimi që bëjmë prej këtyre sjelljeve negative për shkak të faktorëve që s'kanë lidhje me fenë, shyqyr që nga aspekti fetar nuk konsiderohet shtirje apo shirk i fshehtë. Madje, nëse e shtjellojmë me kujdes hadithin në të cilin thuhet:

"Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash!", mund të themi se feja i ka pranuar, nga një aspekt, si rregulla të sheriatit edhe ndjenjat e turpit prej njerëzve dhe të hezitimit nga thashethemet e shoqërisë. Por, meqë ra fjala, rezistimi që bën vetëm për hir të Allahut dikush që është kapluar nga ndjenja për të bërë imoralitet dhe rezistimi që dikush tjetër shfaq ndaj kësaj vepre të ndyrë në mënyrë që të mos e shohin njerëzit, sigurisht se nuk janë njëlloj te Allahu i Madhëruar. Ky shembull që dhamë, tregon edhe mirësinë e madhe në të cilën gjenden njerëzit që jetojnë në mjedise fetare, edhe obligimin për ta falënderuar sa më shumë Allahun Teala, sepse, po të rriten në një mjedis larg Allahut dhe fesë së Tij, ndoshta do të bënin një jetë me shpresë të thyer për t'i zbatuar urdhrat dhe ndalesat e Islamit.

Mendimet të cilat i kemi dhënë që nga fillimi e deri këtu, nuk duhet të keqkuptohen në formën:

"Njerëzit janë robër të shprehive dhe zakoneve të tyre. Nisur nga kjo, përpjekjet e tyre për të ndryshuar në drejtim pozitiv siç e urdhëron feja janë përpjekje boshe."

Sigurisht që ne duhet të përpiqemi vazhdimisht dhe pa reshtur për ta ndryshuar dhe zhvilluar veten në drejtim pozitiv, por para së gjithash, ne duhet të njohim veten tonë, në mënyrë që këto përpjekje të japin rezultate produktive. Ndërsa kur kthehemi dhe i hedhim një shikim vetes sonë, vëmë re se jemi bërë robër të gjendjes që e shprehëm më sipër, domethënë, jemi bërë robër të shprehive dhe zakoneve tona. Të kuptuarit e kësaj është hapi i parë i vendosjes për të ndryshuar dhe i rezistimit në këtë vendosmëri. Ndërsa të mos kuptuarit e kësaj, siç mund të bëhet shkak që ta pengojë realizimin e ndryshimit tonë të mundshëm që mund ta shfaqim në drejtim pozitiv, mund të bëhet shkak që të kaplohemi edhe nga pëlqimi i vetes, madje, mund të bëhet shkak që të biem në mendjemadhësi duke i përçmuar të tjerët. Ndërkohë këto nuk janë qëndrime të përputhshme me moralin. Gjithmonë thuhet: "Njeriu duhet të shikojë gjithmonë ata që janë më lart nga aspekti fetar dhe gjithmonë ata që janë në gjendje më të vështirë nga aspekti material."

Tani le t'i konkretizojmë me një shembull çështjet për të cilat folëm deri këtu:

Me rënien e komunizmit dhe ardhjes së demokracisë, në vendin tonë rehatia ka ardhur duke u shtuar. Zoti na ruajt, por shumë prej nesh kanë filluar të jetojnë në komfor dhe të largohen nga ndihma ndaj të varfërve dhe nevojtarëve. Madje, një pjesë prej nesh ka filluar të llastohet me rehatinë që ka arritur dhe të bëjë israf / shpërdorim të pasurisë. Sigurisht që është e lehtë të ngushëllohesh duke u krenuar: "Ne e japim zekatin farz." – duke parë ata që bëjnë më shumë israf dhe jetojnë më me komfor.

"NJERIU DUHET TË SHIKOJË GJITHMONË ATA QË JANË MË LART NGA ASPEKTI FETAR DHE GJITHMONË ATA QË JANË NË GJENDJE MË TË VËSHTIRË NGA ASPEKTI MATERIAL."

Justifikimet si: "Çfarë është shpenzimi që kam bërë unë në krahasim me israfin që bën filan milioner?", janë pavend. Sepse, nëse atë që na tepron nga të ardhurat tona nuk e japim për hir të Allahut, por e bëjmë israf, atëherë nuk na ngelet asnjë ndryshim nga ai milioneri për sa i përket shpenzimit të pasurisë. Thjeshtë ai harxhon më tepër ngaqë ka më shumë dhe ne harxhojmë më pak ngaqë kemi më pak. Kjo është ajo që bëjmë, sepse nga e pakta mund të harxhohet pak dhe nga e shumta mund të harxhohet shumë!

Edhe një çështje tjetër për të cilën duhet t'i kontrollojmë veprimet dhe jetesën tonë është të shndërruarit e shprehisë në gjë normale. Gjërat që bëhen me shprehi shpesh herë bëhen pa vetëdije dhe pothuajse në mënyrë mekanike. Por ja që besimtari e bën çdo gjë për Allahun dhe për të fituar pëlqimin e Tij siç edhe Allahu thotë në Kuranin Fisnik:

"Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." (En'am, 162) Kjo vetëdije e ndan adhurimin nga shprehia. Për këtë arsye, nijeti është kusht në adhurim. Andaj, rruga që na mundëson për ta shpëtuar jetën tonë nga shprehia e pavetëdija dhe që na bën të jetojmë me dashurinë e adhurimit është përpjekja për t'i kontrolluar vazhdimisht shprehitë tona dhe për të ndryshuar në drejtim pozitiv.



Rreth moralit të fjalës
NË SHEKULLIN E DIXHITALIZIMIT

Mustafa Asim Kyçykashçë

Dikur një burrë bleu pambuk në treg. Kur shkoi në shtëpi, bashkëshortja e tij i tha:

"Tregtarët bëjnë hile në peshore dhe i mashtrojnë njerëzit..." Sapo bashkëshortja ia tha këto fjalë, burri e divorci atë. Të gjithë ishin të habitur. E pyetën:

"Përse e divorceve bashkëshorten tënde ndërkohë që është e ndershme? A të ka hije kjo ty?

Përgjigja e burrit ishte e habitshme ashtu si edhe veprimi që kishte bërë:

"Bashkëshortja ime përgojoi atë që i bleva pambukun. Nesër kur të bëhet tubimi i madh, ai burrë do të na hapë padi dhe do të gjykohemi. Unë jam një njeri që përpiqem me djersën e ballit. Kështu që nuk isha i kënaqur që bashkëshortja ime të bisedojë me një të huaj atë ditë."

Kjo histori është marrë nga Ahmed Murshidi, i cili ishte prej poetëve të Dijarbakërit të shekullit të shtatëmbëdhjetë.

Ai nënvizon dy çështje:

Privatësinë dhe përgojimin.

Në ditët e sotshme, qoftë në jetën reale apo qoftë në jetën e ekraneve që e përkufizojnë si virtuale, këto dy çështje po pësojnë goditje të forta.

Së pari le të biem dakord për një çështje:

VETËM PAK

Çfarëdo që të thuhet, shkruhet dhe lexohet rreth edukatës dhe moralit, vlerësimin e tyre duhet ta përdorim jo në kundërshtimin e të tjerëve, por në llogaritjen e botës sonë të brendshme. Në të kundërt, edukatën automatikisht e përdorim në paturpësi, sepse kërkimi i mangësisë te të tjerët është mangësia më e madhe. Sepse të thuash "unë jam njeri me edukatë, ndërsa të tjerët jo", është paturpësia më e madhe.

Sjelljet sociale, ngaqë në pamjen e jashtme nuk u dallohet lidhja që kanë me synimet e tyre, vlerësohen me paragjykime. Për shembull:

Të vendosësh nga jashtë nëse një ecje bëhet për mendjemadhësi, për dinjitet, për shkak të detyrës apo për shkak të traditës që ka dikush, do të ishte paragjykim. Sa mirë do të ishte nëse mirëkuptohet. Por nëse paragjykohet, çështja ndryshon. Pra, ky do të ishte përgojim nëse paragjykimi është i saktë, ose shpifje nëse paragjykimi do të ishte i gabuar. Si rezultat, ky paragjykim do të arrinte në një pikë më të keqe se ecja me mendjemadhësi.

Atëherë, kur ta lexojmë paralajmërimin: "Mos ec me mendjemadhësi!", nëpër librat e etikës, nëpër

hadithet e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe ajetet fisnike, duhet të shohim dhe të vlerësojmë jetën tonë, jo të të tjerëve për të cilët nuk jemi përgjegjës ndaj moralit të tyre.

Nëse e zbatojmë këtë kusht, mund të vëmë në pah disa gjëra:

BOTA VIRTUALE

Po, në një kohë të shkurtër kemi bërë një "zhvillim" të madh me teknologjinë. Tashmë mund të flasim edhe me majat e gishtave tanë. Edhe gishtat tanë mund t'ua çojnë të tjerëve një pështpërimë apo mund të përhapin ndonjë pohim që nuk i dihet e vërteta duke shtypur butonat në tastierë apo duke prekur ekranet. Këto zhvillime teknologjike kanë lehtësuar mirësinë ashtu siç kanë lehtësuar edhe të keqen. Këto janë influencat përshpejtuese dhe shumuese të kohës së fundit...

Virtual mund të përkthehet hamendësim, imagjinatë, etj. Në anglisht "virtue" do të thotë virtyt, mirësi, ndershmëri, vlerë, veti, epërsi, meritë etj. Nga këto kanë dalë edhe kuptime imagjinare. Pra, edhe të vërteta, edhe të pavërteta.

Mendoni një sundimtar. Nuk është mbret, por sundon me forcën që ka arritur ta shtijë në dorë. Në veprime është mbret. Ndërsa, në të vërtetë nuk është. Ama realisht udhëheq...

Ja pra, nga këtu kanë ardhur kuptimet "jo i vërtetë, që ekziston në ekran, në rrjet apo në kompjuter.

Fjala virtual na mashtron dhe na bën të ndjehemi sikur nuk ekziston në të vërtetë. Por le të mendojmë:

A është më e vërtetë letra e faturës së telefonit, apo regjistrimi i saj në sistem? Nëse humbet fatura e lënë te dera, madje edhe nëse e grisim, regjistrimi i saj në botën virtuale nuk fshihet.

Ndoshta pështpëritjet në jetën e vërtetë dhe shikimet me bisht të syrit nuk kanë dëshmitar tjetër përveç Allahut Teala, por në internet çdo gjë është e regjistruar. Fjalën tonë e vërteton edhe zbatimi i ligjit që është nxjerrë muajt e fundit për ata që ofendojnë personat apo personalitetet imagjinare duke pandehur se nuk ka ndonjë problem nëse e bëjnë këtë në internet.

Besimi ynë ndaj Allahut Teala, i Cili i di qëllimet dhe synimet tona, nuk duhet të na tërheqë për të parë një diçka të lejuar në mënyrë virtuale.

Morali ynë nuk duhet të ndryshojë kundrejt këtyre ndryshimeve. Në këtë kohë mund të shkruajmë komente mjaft të rënda nën një mendim që ka shpërndarë një person ndaj të cilit sillemi me respekt kur të takohemi. A e bëjmë këtë ngaqë nuk jemi ballë për ballë me të? Ndërkohë ne i besojmë një dite në të cilën do të takohemi me njerëzit që u kemi hyrë në hak, siç do të takohet shitësi i pambukut me gruan përgojuese.

KRAHASIMI

Gjëja që njerëzit kanë vuajtur më shumë në të kaluarën ka qenë bërja e krahasimeve. Ndërkohë kjo fjalë ka marrë edhe kuptimet si të nxehësh, të bësh xheloz, të mërzisësh dhe të shfaqësh ndonjë sjellje me qëllim për të shtypur dikë. Sot, ata të cilët e shpërndajnë në mediat sociale fotografinë e ushqimit, ëmbëlsirës, rrobave dhe martesës së tyre, me shumë mundësi nuk e bëjnë nijet për diçka të tillë. Vetëm se i hedhin në internet ngaqë kjo është natyrshmëria e tij. Por ata nuk kanë marrë parasysh nxitjen e ndjenjave që mund të shkaktojnë ato që kanë shpërndarë në botën virtuale.

Ja pra, ndjeshmëria për të mos i bërë të tjerët të xhelozojnë apo të lakmojnë, e bën të nevojshëm largimin nga kjo vepër. Sot kemi të rinj që dëshpërohet në kuptimin e vërtetë të fjalës duke thënë: "Nuk arrita të mburresha, kështu që po shtypem nën mburrjen e të tjerëve."

Këtë e urdhëron edhe parimi i të qëndruarit larg pozitave për të akuzuar të tjerët. Gjithashtu, gjithmonë nuk është e vlefshme të thuash: "Unë e kam qëllimin e pastër. Kështu që të tjerët le të mendojnë çfarë të duan.

Pastaj duhet të frikësohemi edhe nga mësyshi dhe haku i syrit.

Bota virtuale është një botë e rreme. Aty mund të ketë të moshuar që pandehet se janë të rinj, fëmijë që pandehen se janë të rritur, burra që pandehen si gra dhe më e rëndësishmja, armiku që pandehet si mik. Poeti thotë:

"Çdo zemër nuk është e pastër nga turbullira e hipokrizisë. Edhe çdo zemër e pastër, nuk është e mirëkuptueshme. Aman mos e hap gojën për t'ua treguar të gjithëve të fshehtat e tua! Sepse çdo degë rrapi dhe shelgu nuk është misvak."

EDUKATË APO PRESION SHOQËROR

Rregullat e jetesës së përbashkët në shoqëri ka prej atyre që i perceptojnë si shtirje dhe presion i shoqërisë. Ky nuk është gjë tjetër përveçse paragjykim i llojit të cilin u përpoqëm ta shpjegonim më sipër.

Çfarë janë rregullat e jetesës së përbashkët në shoqëri?



Ato janë rregullat e kulturës. Burimet e tyre janë feja, tradita, zakoni, morali dhe sjelljet. Këto i kanë shndërruar në rregulla gjyshërit tanë.

Përse vendoset rregulli?

Sepse nefsi ynë mund të shfaqë edhe sjellje të papranueshme. Ajo mund të preferojë mendjemadhësinë në vend të modestisë, egoizmin në vend të sakrificës dhe nxitimin në vend të durimit...

Për atë që dënohet ai që vret një njeri, për të njëjtin shkak qortohet edhe ai që mburret. Siç përpiqemi ta parandalojmë vjedhjen me ligj, ashtu përpiqemi ta heqim egoizmin me moral.

Nëse moralin e mbajmë në planin e një çështjeje të ndërgjegjes duke mos pasur asnjë sanksion dhe presion moral, kjo do t'ua shtonte oreksin të pandërgjegjshmëve. Sanksionet e shoqërisë janë për t'i ndaluar këta të pandërgjegjshëm.

Nga ana tjetër, nëse rregullat e jetesës së përbashkët në shoqëri janë një mburojë, sigurisht se duhet të kërkojmë virtytet fisnike dhe ndjenjat e vërteta. Vullneti hyjnor, siç nuk shikon mishin te kurbani dhe pamjen e jashtme te namazi, sigurisht se edhe te morali nuk do t'i shikojë zakonet që bëhen për shtirje.

Islami gjithmonë kërkon prej nesh unitet të të brendshmes me të jashtmen.

Hipokrizia: Plasaritja ezoterizmit dhe ekzoterizmit në besim.

Shtirja: Plasaritja e të brendshmes me të jashtmen.

Në mesazhet që ua dërgojnë shokëve dhe miqve, a mund të kalojmë nga "arriti, u pëlqye, u shpërnda" te "u përjetua, u praktikua dhe u zbatua"? Nëse nuk mund të kalojmë, virtytet e profilit tonë do të thotë se nuk janë gjë tjetër përveçse thashetheme virtuale.

KILU KAL

Kilu kal do të thotë thashetheme. Në të vërtetë, fjala në arabisht ka këtë kuptim: "U tha dhe tha." Nisur nga kjo, poetët që e njihnin edhe gnozën islame e kanë quajtur "kilu kal" edhe dijen e ekzoterizmit, pra, dijen pa përshpirtshmëri. Në të vërtetë, në veprat shkencore gjithmonë përdoren këto shprehje kur jepen mendimet:

"Kështu u tha. Kështu ka thënë filani."

"Në rregull, u tha o dijetar, por a janë zbatuar prej teje këto të dhëna, këshilla, urdhra dhe ndalesa? A janë shndërruar ato në sjellje dhe vepra?

Për këtë i kërkon mbrojtje Allahut Teala edhe Hazreti Ibrahim Hakkë.

Këtu ka një mesazh për ne. Në mesazhet që ua dërgojnë shokëve dhe miqve, a mund të kalojmë nga "arriti, u pëlqye, u shpërnda" te "u përjetua, u praktikua dhe u zbatua"? Nëse nuk mund të kalojmë, virtytet e profilit tonë do të thotë se nuk janë gjë tjetër përveçse thashetheme virtuale.



NJERIU DHE BOTA TJETËR

Duran Ekizer

Kurani Fisnik është shpallja e fundit, e dërguar për udhëzimin e njerëzimit. Ai na lajmëron se Muhamedi (a.s.), është pejgamberi i fundit dhe se Islami është feja e fundit e plotësuar me dërgimin e tij. Për rrjedhojë, çdo gjë në këtë botë që ka lidhje me njeriun, ai mund ta gjejë në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberit (a.s.), që është edhe reflektimi i tij (Kuranit).

Kurani Fisnik i drejtohet direkt njeriut dhe kërkon që edhe njeriu të krijojë lidhje me të. Argumenti më i fortë i këtij fakti është se në shumë ajete të Kuranit Fisnik theksohet aftësia që ka njeriu për të menduar. Nëse do të na duhej të jepnim një shembull, mund të përmendim ajetin 21, të sures Hashr, në të cilin urdhërohet: ***"Sikur këtë Kuran t'ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë*** *(mal)* ***të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, me qëllim që ata të meditojnë."***

Nëse e shohim Kuranin Fisnik në mënyrë të përgjithshme, do të vëmë re se në shumë ajete të tij theksohet mjaft edhe bota tjetër. Këtë e vëmë re në mënyrë të veçantë në suret e fundit të Kuranit, ku kjo çështje na del përballë në mënyrë të shpeshtë së bashku me ndodhinë e Kiametit. Shkaku i kësaj, është që njeriu, të cilit i drejtohet Kurani, të përgatitet për jetën e përjetshme, e cila vjen pas kësaj jete dhe ku do të japë llogari për çdo gjë që ka bërë. Përfshi edhe pejgamberët, të gjithë do të japin llogari në Ditën e Kiametit për veprat e tyre në këtë botë. Në një ajet fisnik, urdhërohet: ***"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë*** *(e kësaj bote)!"* (Tekathur, 8)

Kurani Fisnik shprehet se njeriu ka dy jetë. Këto janë jeta e kësaj bote dhe e botës tjetër. Jeta e kësaj bote është jeta e tanishme, në të cilën gjendemi dhe ku po jetojmë realitetin e saj. Mirëpo, jetës së kësaj bote, e cila siç shprehet edhe Kurani, është e shkurtër aq ***"sa hap e mbyll sytë"***, një ditë do t'i vijë fundi. Dhe në këtë botë të fundme duhet të fitojmë botën e pafundme. Nga kjo e vërtetë është e pamundur të iket. Prandaj, nuk duhet të mashtrohemi nga bukuria e jetës së kësaj bote të përkohshme dhe të hedhim pas shpine jetën e përjetshme.

Njeriu, për shkak të natyrës së tij, zgjedh më të lehtën dhe më të shpejtën. Ky fakt, në Kuranin Fisnik shprehet me këto fjalë: ***"Jo, por ju doni të shpejtën*** *(jetën kalimtare)* ***dhe e hidhni pas shpine jetën e botës tjetër!"*** (Kijame, 20-21) Po ashtu, Kurani Fisnik shprehet se jeta e botës tjetër është më e mirë se jeta e kësaj bote, por njerëzit preferojnë jetën e kësaj bote. Ndërsa në ajetet 16-17 të sures A'la, urdhërohet: ***"Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amëshuar."***

Si përfundim, nuk duhet të harrojmë se ka vdekje, ringjallje, llogaridhënie, peshore, xhenet dhe xhehenem. Shkurtimisht, ekziston një jetë tjetër që na pret dhe që është e përjetshme. Allahu na bëftë prej besimtarëve të mirë, që e mbajnë gjithmonë gjallë vetëdijen e besimit. Amin!

Propozime interesante

Adem Saraç

Dielli i Islamit po ndriçonte çdo ditë e më tepër. Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, po arrinte të kontaktonte me sa më shumë njerëz që kishte mundësi. Ndërkohë që errësirat po ndriçoheshin, edhe njerëzit me mendime të errëta vazhdimisht nxirrnin pengesa. Lufta e të vërtetës dhe të gabuarën ishte ndezur flakë.


Prijësit mjeranë të politeistëve mekas përsëri kishin vendosur për të kurdisur kurthe të reja. Ata që mund t'i përmendim prej atyre prijësve ishin: Velid bin Mugire, As bin Vail, Umejje bin Halef, Esved bin Muttalib, Esved bin Abdi Jagus dhe Harith bin Hanzale. Ata thoshin:

-A nuk ishte analfatbet ky njeri, more shokë?

-Po, ai është një njeri që nuk di shkrim e këndim!

-Ai ka lindur dhe është rritur ndërmjet nesh!

-Po, deri në moshën dyzet vjeçare, të gjithë i thoshim "Muhammedu'l-Emin".



-Por çfarë është kjo që na ka sjellë pas të dyzetave?

-Çfarë është kjo që këndon?

-Ai ka sjellë dhe po këndon një Libër plot përçarje, i cili ia kalon çdo lloj fjale letrare.

-Ai ia kalon çdo lloj poezie dhe proze.

-Brendësia e tij është e mbushur me shkencat e bazë dhe të çdo gjëje tjetër![1]

Kjo nuk ishte diçka që mund ta kuptonin ata që nuk janë njerëz! Allahu Teala e njoftonte Pejgamberin, alejhi's-selam, për dijet më të mira, për ligjet dhe moralet më të larta, për pikat më të fshehta të historive që u përkisnin umeteve dhe profetëve të kaluar dhe i jepte lajmet e gajbit të cilat nuk i dinte askush përveç Tij. Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), e njoftonte popullin e tij për këto. Krahas këtyre, u mësonte edukatën dhe virtytet e moralit. Për më tepër, ata që merreshin me elokuencë në atë kohë, ngelën të dobët dhe të mahnitur kundrejt elokuencës, thellësisë dhe gjerësisë së Kuranit Fisnik.

Krahas gjitha këtyre, ajetet e këtij Libri të bekuar që e refuzonin adhurimin e idhujve dhe që njofton si adhuruesit e idhujve do te hidhen në xhehenem, i zemëronin politeistët kurejshë.

Për këtë arsye, më të mëdhenjtë prej tyre u mblodhën dhe menduan të flisnin në një mënyrë tjetër me të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam. Ose më saktë, i parashtruan propozime interesante:

-Nëse dëshiron të të besojmë, edhe ti do t'i adhurosh idhujt tanë me në krye Latin, Uzzan dhe Menatin!

-Veçanërisht nuk do t'i përçmosh idhujt tanë dhe do t'i lësh gjërat që nuk na pëlqejnë dhe që na zemërojnë shumë në lidhje me idhujt!

-Nuk do të flasësh rreth gjërave që i konsiderojmë të pamundura si ringjallja, ahireti, shpërblimi dhe ndëshkimi!

-Ose sill një Kuran tjetër që nuk ka gjëra të tilla brenda!

-Nëse Zoti që beson nuk ta zbret dot një Kuran të tillë, atëherë bëje vetë!

-Ose, ajetet kërcënuese të cilat gjenden në këtë

1. Taberi, Tefsir, vëll. 11, fq. 96.

Libër që ke në dorë, ktheji në ajete përgëzuese, ajetet përgëzuese ktheji në ajete kërcënuese, haramin ktheje në hallall dhe hallallin ktheje në haram!

-Në vend të ajeteve të ndëshkimit, vendos ajete mëshire!

-Nxirri nga Kurani ajetet që i refuzojnë zotat dhe adhurimin e tyre!

-Nëse i bën këto, edhe ne do të të besojmë dhe do të të ndjekim![2]

Ata bënë edhe shumë propozime të tjera interesante. Pasi i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i dëgjoi të gjitha këto me një durim të madh, u dha përgjigje duke përdorur vetëm një fjali:

"Unë ju sjellë vetëm atë që më zbrit Allahu Teala!"[3]

-Nëse nuk i pranon të gjitha këto propozime, prano vetëm një pjesë të tyre!

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ua ktheu shpinën këtyre mjeranëve. Ndërkohë që politeistët po mendonin për propozime të reja, Allahu Teala tha kështu në ajetet që zbriti:

"E, kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin para Nesh, thonë: "Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!" Thuaj (o Muhamed)***: "Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe." Thuaj: "Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t'jua kisha lexuar dhe as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë*** (të gjatë) ***në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?"*** (Junus, 15-16)

Përsëri një ditë tjetër kur i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, po bënte tavaf në Qabe, u takua me parinë e politeistëve. Ata ia prenë rrugën dhe i bënë një propozim të ri:

-Ne do të të propozojmë diçka në të cilën ka mirësi edhe për ty, edhe për ne!

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ua dha mundësi për të folur duke u thënë:

"Çfarë është ajo?"

-Nëse ti pason fenë tonë, edhe ne të pasojmë fenë tënde! Nëse ti i adhuron një vit zotat tanë, Latin dhe Uzzan, edhe ne do ta adhurojmë një vit Zotin tënd! Nëse ti i adhuron një muaj zotat tanë, edhe ne do ta adhurojmë një muaj Zotin tënd! Nëse ti i adhuron zotat tanë një ditë, një muaj ose një vit, edhe ne do ta adhurojmë zotin tënd një ditë, një muaj ose një vit! Në këtë mënyrë, le të sundojë paqja dhe të zhduket armiqësia ndërmjet nesh! Nëse Zoti që adhuron ti është më i mirë se zotat që adhurojmë ne dhe nëse feja jote është më e mirë se feja jonë, në këtë mënyrë edhe ne përfitojmë nga Zoti dhe feja jote. Nëse feja jonë është më e mirë, do të përfitosh edhe ti gjithashtu![4]

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i refuzoi të gjitha propozimet interesante të tyre duke u dhënë një përgjigje të denjë dhe duke mbajtur qëndrim të ndershëm si gjithmonë:

"Unë nuk jam dërguar për këtë! Mbi të gjitha, i kërkoj mbrojtje Allahut që të mos i shoqëroj asgjë ndërkohë që e adhuroj Atë!"[5]

Pas këtij propozimi interesant, zbritën këto ajete fisnike:

"Thuaj: "A të marr mbrojtës tjetër, përveç Allahut, Krijuesit të qiejve dhe Tokës? Ai e ushqen (botën)***, ndërsa Vetë nuk ushqehet". Thuaj: "Unë jam urdhëruar që të jem i pari që t'i nënshtrohem Atij" dhe kurrsesi mos u bëj idhujtar!"*** (En'am, 14)

Politeistët e tepruan edhe më shumë në vend se t'i thërrisnin mendjes kur e dëgjuan mesazhin hyjnor që zbriti dhe thanë:

-Të paktën preki me dorë disa prej zotave tanë! Pastaj edhe ne do të të besojmë dhe do ta adhurojmë zotin tënd!

Edhe këtë propozim interesant e refuzuan ajetet e reja që erdhën përsëri:

"Thuaju atyre: "Vallë, ju po më urdhëroni që të adhuroj dikë tjetër, përveç Allahut, o të paditur?!" Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed)***, si dhe atyre që kanë qenë para teje: "Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër*** (në adhurim)***, me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit. Prandaj, adhuro vetëm Allahun dhe bëhu falënderues!"*** (Zumer, 64-66)

Profetët nuk janë personalitete që t'u pritet rruga me propozime interesante që u vijnë nga njerëzit. Ata predikojnë vetëm urdhrat e Allahut Teala. Edhe atë kohë, mushrikët mekas pandehën se do ta bindnin të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), me propozime interesante dhe do ta bënin t'i ndiqte ata. Ndërsa profetët nuk janë dërguar për të ndjekur popullin, por për t'i ndjekur populli ata. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), është një shembull i pashoq që duhet të ndiqet.

Sallallahu alejhi ve sellem...

2. Ebu Nuajm, Delailu'n-Nubuvve, vëll. 1, fq. 170.

3. Ebu'l-Fida, Tefsir, vëll. 2, fq. 410.

4. Fahru'r-Razi, Tefsir, vëll. 17, fq. 57.

5. Vahidi, Esbabu'n-Nuzul, fq. 307; Zemahsheri, Keshshaf, vëll. 4, fq. 292.

Thuaj: "O Zoti im!
Ma shto dijen!"

(Taha 114)

Një Ajet

Allahu i Lartmadhëruar nuk e urdhëroi Pejgamberin (a.s.) që t'i lutej për shtimin e ndonjë gjëje tjetër përveç diturisë. Kjo pasi dija është një thesar i pafund. Dituria është frytdhënëse jo vetëm për zotëruesin e saj, por edhe për njerëzit e tjerë, madje edhe për të gjitha qeniet e gjalla. Dituria është mjeti më i rëndësishëm për të ndarë të vërtetën nga e shtrembra. Shtimi i diturisë s'është një peshë e rëndë për njeriun, përkundrazi është një virtyt lartësues për të. Me shtimin e diturisë, tek njeriu rritet modestia, njeriu shpëton nga disa gjëra të panevojshme, kupton të vërtetën dhe tregon kujdes që të bëhet një njeri i mirë. E kundërta e dijes është injoranca, e cila është e papranueshme.

Thuaj: "A mund të jenë të njëjtë ai që di me atë që nuk di?" (Zumer 9)

Nëpërmjet këtij ajeti Kuranor, Allahu Teala na tregon se dituria është diçka e lavdërueshme, duke na shpjeguar vlerën dhe superioritetin e saj, ashtu sikurse tregon edhe se injoranca është diçka e ulët dhe e mangët. Njeriu i ditur i bindet Allahut, ndërsa injoranti është kryelartë. Këta janë të kundwrtat e njëra-tjetrës, ndërkohë që bindja është virtyt, kryelartësia është rrënim. Çdo lloj injorance është kundërshtuar dhe është nënvlerësuar në fenë tonë. Kjo pasi çdo element i injorancës ka mohim dhe kryelartësi. Arsyeja se pse është quajtur periudha para Islamit si periudhë e injorancës, është se i gjithë populli mohonte njësinë e Zotit dhe tregohej kryelartë ndaj Tij.

Dituria e saktë dhe e vërtetë e pastron njeriun nga shirku dhe e bën atë të dalë para Allahut si një rob i vërtetë. Në të kundërt, individi ka të meta dhe mangësi në dijen e tij. Injorant nuk është vetëm ai që s'di shkrim e lexim, sikurse pandehin sot disa njerëz, por është edhe ai që nuk heq dorë nga mohimi i Zotit të Lartmadhëruar dhe nga shfaqja e kryelartësisë ndaj Tij.

"Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija." (Muxhadele, 11)

Allahu i lartëson gradët shpirtërore të atyre që besojnë tek Ai dhe të atyre që veprojnë në përputhje me urdhrat e Tij. Në këtë jetë ata i bën që të jenë të suksesshëm, ndërsa në ahiret do t'i shpërblejë me katet më të larta të xhenetit. Allahu Teala edhe dijetarin që jeton në përputhje me diturinë e tij, gjithashtu do t'i dhurojë gradët më të larta shpirtërore. Ajeti kuranor i mësipërm është një argument i qartë që tregon vlerën e diturisë dhe dijetarëve tek Allahu. Në Kuranin famëlartë ka shumë ajete që theksojnë epërsinë e diturisë dhe dijetarëve. Në lidhje me këtë temë ka me qindra hadithe të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij (r.a.), se Pejgamberi -salallahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme. Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit. Kurse shoku i keq është si farkëtari, qëndrimi pranë të cilit ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."

Një Hadith

Ky hadith është në përputhje të plotë me ajetet që kështillojnë besimtarët të shoqërohen gjithmonë me njerëz të mirë e të devotshëm. Shoqëria dhe miqësia, përtej një marrëdhënieje shoqërore natyrale, e ka të nevojshme sinqeritetin dhe sinqeriteti arrihet më së miri midis njerëzve që ndajnë besim dhe ideale të njëjta. Hadithi i mësipërm na këshillon të jemi të kujdeshëm në zgjedhjen e shokut, për vetë faktin se, edhe pse me besim të njëjtë, por me sjellje të papajtueshme, njerëzit ndikohen reciprokisht pozitivisht apo negativisht. E këshillueshme është shoqërimi me njerëz të mirë, për të përfituar nga edukata e morali i tyre dhe distancimi nga personat me sjellje të keqe, sepse shoqërimi sjell patjetër ndikim. Siç e shpreh më qartë hadithi tjetër: *"Personi është në fenë e shokut të tij, prandaj të shikojë çdonjëri prej jush se me kë shoqërohet"* (Ahmed. ibn. Hanbel, Musnedi, 2/334)

Ky hadith i mrekullueshëm, i thënë katërmbëdhjetë shekuj më parë, e ruan edhe sot aktualitetin. Tema e ndikimit zë një vend të rëndësishëm, sidomos përsa i përket edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Sepse sjelljet që fitohen në këtë moshë, do të përbëjnë një pjesë të karakterit të tij në të ardhmen. Në shumicën e rasteve duhanpirja fillohet thjesht duke u nxitur nga një shok, për të vazhduar gjithë jetën. Përhapja e veseve të tjera të këqija, si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj, zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale. Familja duhet të tregohet shumë e kujdesshme për grupmoshat nga klasa e parë deri në moshën e pjekurisë, sepse kjo është mosha ku fillon të formësohet personaliteti, por është edhe mosha, e cila është shumë e prirur ndaj ndikimeve pozitive apo negative.

Mburoja më e sigurt për të mbrojtur fëmijët nga ndikimet negative është strehimi tek feja islame.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Nxitja për t'u shoqëruar me njerëz të mirë.

2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.

3. Qëndrimi larg shoqërisë së keqe.

DETYRAT E BURRAVE DHE GRAVE

për të arritur lumturinë në jetën e dy botëve:

KUSHTI I PARË: DEVOTSHMËRIA

Devotshmëria është kushti i parë për të arritur qetësinë në jetën familjare.

Për të arritur paqen dhe harmoninë në jetën familjare gratë para së gjithash duhet t'i kushtojnë kujdes devotshmërisë dhe bindjes ndaj Allahut të Lartësuar. Krahas kryerjes së adhurimeve me përkushtim, ato duhet të ruajnë kufirin midis hallallit dhe haramit (të lejuarës dhe të ndaluarës).



Shkalla e devotshmërisë dhe e përkushtimit të grave në familje duhet të jetë në një nivel të lartë sa të ndikojë pozitivisht në punët e mira të bashkëshortit, fëmijëve, të afërmve madje edhe të fqinjëve.

Gratë e sahabëve i përcillnin bashkëshortët në mëngjes me lutje duke u thënë:

"Ki kujdes! Mos sill në shtëpi diçka të fituar në rrugë të ndaluar. Sepse ne mund ta durojmë urinë në jetën e kësaj bote, por nuk mund ta durojmë dënimin në jetën e botës tjetër." (Abdülhamid Keşk, Fî Rihâbi't-Tefsîr, I, 26)

Detyra më e rëndësishme e grave pas përkushtimit ndaj fesë, është përkushtimi ndaj familjes.

Një grua fisnike i ngjan një luleje me aromë xheneti që shpërndan lumturi kudo përreth saj.

Një grua fisnike që arrin të bëjë të lumtur bashkëshortin dhe familjen e saj, ka fituar njëkohësisht edhe kënaqësinë e Allahut. Kështu, i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Gruaja e mirë është ajo, e cila:

- E gëzon burrin kur ai shikon fytyrën e saj,
- Përmbush kërkesat e ligjshme të bashkëshortit të saj,
- Ruan pasurinë dhë nderin edhe në mungesë të bashkëshortit të saj." (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5/1857)

Një zonjë shtëpie duhet të kujdeset për pamjen e jashtme të saj, për pastërtinë dhe rregullsinë.

Ajo duhet të tregohet shumë e kujdesshme të mos vishet në mënyrë të çrregullt dhe nëse ka një ves të tillë duhet ta heqë sa më parë, në mënyrë që të shmangë çdo pamje jo të këndshme për bashkëshortin e saj.



Zemra e atij që nuk e gjen në shtëpinë e tij atë që kërkon, rrëshqet në vende të gabuara jashtë shtëpisë së tij dhe si rezultat shkatërrohet lumturia familjare.

Për këtë arsye ajo duhet të jetë si një buqetë me lule të bukura dhe me aromë të këndshme që përhap lumturi dhe qetësi në familjen e saj aq sa bashkëshorti të presë me padurim kthimin në shtëpi.

Për ta arritur këtë, gruaja duhet ta presë me fytyrë të qeshur burrin e saj dhe po ashtu ta përcjellë me fjalë dhe lutje të bukura. Edhe sikur të ketë kaluar një ditë të lodhshme, ajo duhet të mundohet të mos e shfaqë lodhjen e saj duke ndenjur me fytyrë të vrenjtur përballë bashkëshorit. Ajo duhet të ndajë shqetësimet e bashkëshortit të saj duke i ofruar qetësi shpirtërore.

Burri dhe gruaja duhet të tregohen të kujdesshëm të mos nëpërkëmbin lumturinë e njëri-tjetrit me mërzitje të tepërta dhe me ankesa vend e pavend.

Lidhur me këtë, duhet të kujtojmë sjelljen shembullore të Ummu Sulejmit ﵂ përballë bashkëshortit të saj Ebu Talhasë:

Tregohet se djali i tyre i sëmurë kishte ndërruar jetë kur Ebu Talha nuk ndodhej në shtëpi. Ummu Sulejme mori trupin e pajetë të të birit, e lau dhe qefinosi atë me një durim të pashembullt.

Më vonë, kur Ebu Talha ﵁, erdhi në shtëpi, pyeti:

Babai është një diell në qiellin e lumturisë familjare, nëna është një hënë që shkëlqen butësisht dëlirësinë e saj, ndërsa fëmijët janë yjet e atij qielli virtytesh të bukur si margaritarë.

"-Si është djali?" Ummu Sulejme ﵂, tha:

"- Djalit iu qetësuan dhimbjet dhe tani besoj se është rehatuar."

Ndërkohë, Ummu Sulejme r.a. i porositi njerëzit e shtëpisë duke u thënë:

"- Kujdes, mos i tregoni Ebu Talhas për vdekjen e djalit, deri sa t'i tregoj vetë!.." Më pas, i solli ushqimin burrit të saj dhe ai hëngri. Ndërkohë, Ummu Sulejme ﵂ u zbukurua dhe doli para tij. Më pas, ata shkuan të çlodheshin në dhomën e tyre. Në mëngjes, në momentin kur Ebu Talha ﵁, po bëhej gati të dilte nga shtëpia, Ummu Sulejme, e cila ishte një grua e zgjuar dhe e devotshme, i tha:

"- O Ebu Talha! Shiko ç'bëri ky fqinji ynë ... Kur i kërkova të ma kthente amanetin që ia kisha dhënë për ta përdorur, s'deshi të ma jepte."

Ebu Talha ﵁, u përgjigj:

"- Po si kështu? Nuk paska vepruar aspak mirë!"

Pas këtyre fjalëve, Ummu Sulejme ﵂, tha:

"- O Ebu Talha! Djali yt ishte një amanet i Allahut tek ti dhe Ai e mori përsëri."

Ebu Talha papritur u shastis, heshti dhe më pas tha:

اِنَّا لِلّٰهِ وَاِنَّا اِلَيْهِ رَاجِعُونَ

"- Ne jemi të Allahut dhe padyshim tek Ai do të kthehemi!"

Kur shkoi në xhami për të falur namazin, i tregoi Pejgamberit ﷺ, ç'kishte ndodhur.

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, bëri dua duke thënë:

"- Allahu i Lartësuar jua begatoftë këtë natë!" Pa kaluar një vit prej kësaj duaje profetike, Allahu i Lartësuar i fali kësaj familjeje një djalë tjetër. Pejgamberi ﷺ, bëri dua për këtë fëmijë duke ia ëmbëlsuar gojën me pak hurmë dhe e quajti Abdullah. Transmetohet se, me begatinë e kësaj duaje, Abdullahut i lindën shtatë apo nëntë fëmijë dhe të gjithë u bënë hafiza të Kuranit Fisnik. (Buhari, Xhenaiz 42, Akika l; Muslim, Edeb 23)

Në këtë histori shohim me admirim shembullin e një gruaje fisnike që me ndjenjën e nënshtrimit të plotë dhe kënaqësisë absolute ndaj caktimit hyjnor, nxit edhe bashkëshortin e saj të jetë i dueshëm dhe i matur.

Pra,

Janë të papranueshme disa sjellje kapriçoze, të cilat nuk mund të justifikohen nga probleme dhe shqetësime të papërfillshme brenda familjes.

Prandaj themi që,

Një grua fisnike nuk duhet ta neglizhojë kurrë burrin e saj dhe nuk duhet ta vendosë atë në radhë të dytë ndër pjesëtarët e familjes.

Për ta kënaqur një njeri, fillimisht duhet ta njohësh shumë mirë. Për këtë arsye, gruaja duhet të përpiqet ta kuptojë burrin e saj, idealet, interesat dhe ndjenjat e tij; të ndajë me të dëshirat dhe të mos ndahet kurrë prej tij.

Nga ana tjetër, edhe burri duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë me gruan e tij.

Nëse nuk i japin rëndësi kësaj çështjeje, "**uniteti dhe gjërat e përbashkëta**" si ligj i natyrshëm i bashkëshortësisë, do të zbehet dita ditës dhe me kalimin e kohës bashkëshortët do të largohen nga njëri-tjetri.

Nëse nuk ndërhyhet në kohën e duhur, ky përjetim merr një përmasë të atillë, saqë dashurinë dhe unitetin midis bashkëshortëve e zë ndarja dhe urrejtja. Dhe, periudha më e vështirë e këtij përjetimi është pleqëria. Ashtu siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik, në jetën martesore qetësia shpirtërore duhet të shndërrohet në mëshirë dhe dhembshuri të ndërsjellë mes bashkëshortëve. Burri dhe gruaja duhet të jenë mbështetje për njëri-tjetrin deri në fund të jetës. Për këtë gruaja duhet ta ndihmojë dhe ta mbështesë bashkëshortin e saj në çdo punë të mirë dhe të dobishme, të lejuar.

LIDHJET FAREFISNORE

Një grua fisnike nuk duhet të tregojë mungesë respekti ndaj të afërmve të bashkëshortit të saj. Nëse vihet në pozitën e zgjedhjes midis dëshirës dhe sakrificës, ajo duhet të tregojë më tepër afërsi ndaj familjes së tij. Kjo sjellje e gruas, e kënaq burrin e saj.

Nga ana tjetër vjehrri dhe vjehrra duhet të respektohen si prindër të vërtetë.

Gjithashtu duhet treguar kujdes ndaj respektimit të kufijve të intimitetit që ka paracaktuar Islami.

Sipas parimeve islame, një person nuk mund të veçohet me një person të gjinisë tjetër me të cilin i lejohet martesa. Për shembull, një grua nuk mund të qëndrojë vetëm me kunatin, burrin e motrës etj. Nga ana tjetër një burrë nuk mund të qëndrojë vetëm me kunatën, motrën e gruas etj.

Në mjediset familjare ku janë të pranishëm meshkuj të huaj gruaja duhet të qëndrojë e mbuluar. Edhe nëse këta njerëz janë të afërm, dispozita nuk ndryshon. Nga ky rregull bëjnë përjashtim vetëm të afërmit e ngushtë (pra personat me të cilët nuk mund të martohet, si: vëllai, xhaxhai, daja, nipi etj.)

Nisur nga kjo askush nuk ka të drejtë të justifikohet me qëllimin e tij të pastër apo zemrën e mirë dhe të rrënojë muret e intimitetit. Në mënyrë të veçantë gratë duhet të ruhen nga çdo situatë e dyshimtë që mund të dëmtojë personalitetin e tyre. Kjo, sepse gruaja është si një rrobë e bardhë, në të cilën bie në sy edhe njolla më e vogël. Jo më kot është thënë: *"Qëndroni larg punëve që mund të ngjallin dyshime."*

Edhe i Dërguari i Allahut ka qëndruar larg çdo situate që mund të ngjallte dyshime:

Një mbrëmje, teksa i Dërguari i Allahut ﷺ, po

ecte në një rrugicë me një prej grave të tij u përball me dy sahabë medinas të cilëve u foli në formë sqarimi:

"Kjo është nëna juaj Safije binti Hujej."

Sahabët thanë:

"O i Dërguar i Allahut! Allahu është larg çdo të mete! E si mundet i Dërguari i Tij të veprojë gjëra të papërshtatshme?"

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut tha:

"Shejtani qarkullon në trupin e njeriut si gjaku. Prandaj, kam frikë se mos ju hedh ndonjë të keqe -apo dyshim- në zemrat tuaja." (Buhârî, I'tikâf, 11; Muslim, Selâm, 23-25. Po ashtu shih: Ebû Dâvûd, Savm, 79, Edeb, 81; Ibn-i Mâxhe, Sijâm, 65)

Një nga kushtet më të rëndësishme për lumturinë familjare në dy botët është:

DURIMI DHE MATURIA

Jeta është plot surpriza. Mund të ketë edhe periudha të vështira dhe fatkeqësi. Prandaj, në periudha të tilla, gruaja duhet të gjendet pranë burrit të saj dhe të përpiqet t'ia lehtësojë barrën. Nisur nga kjo të parët tanë kanë thënë:

"Bëhu qilim, që të të mbajnë si kurorë!"

"Edhe po të të rrjedhë gjak nga goja, thuaj piva sherbet të kuq! (lëng qershie)" (Pra mos u anko, por mundohu t'i lehtësosh vuajtjet përmes durimit dhe sakrificës.)

Problemet familjare duhet të gjejnë zgjidhje brenda anëtarëve të saj, pa qenë e nevojshme të zbulohen nga të tjerët. Përndryshe, cenohet një prag i ndjeshëm që e bën të pamundur kthimin e gjërave si më parë.

"Mbështille me lumturi çerdhen tënde familjare në të cilën hyre me fustan nusërie. Por kur të dalësh prej asaj dere pas një jete të paqtë e të nisesh për në udhëtimin e përjetshëm, dil me një qefin të bardhë e të panjollosur."

(Pra mos e ço nëpër mend ndarjen përmes divorcit. Martesa nuk kërkon besnikëri të përkohshme por qëndrueshmëri të përhershme.)

Natyrisht, kjo nuk do të thotë që duhet të pranojmë padrejtësinë, keqtrajtimet apo të heqim dorë nga të drejtat që na takojnë.

Por këto mesazhe janë këshilla të vyera në drejtim të ruajtjes së paqes familjare nga çështje të parëndësishme.

Në marrëdhëniet ndërnjerëzore është e natyrshme të hasen probleme të ndryshme. Problemet e herëpashershme që hasen në jetën familjare duhet të mënjanohen përmes durimit, tolerancës dhe altruzimit. Kjo është mënyra e vetme për të fituar lumturinë e dy botëve.

Realiteti me të cilin përballemi sot fatkeqësisht është shumë larg këtyre mësimeve. Vajzat e sapomartuara këshillohen nga familja dhe të afërmit e tyre: "Të mos lejojnë askënd t'i nëpërkëmbin; në rastin më të parë të largohen, të divorcohen." Si rezultat numri i martesave gjithnjë e në zbritje po u lë vendin divorceve, ku ata që lëndohen më së shumti janë natyrisht fëmijët.

Burri dhe gruaja duhet të respektojnë detyrimet e jetës së përbashkët dhe të mbështesin gjithmonë njëri-tjetrin përballë sfidave të jetës. Ata duhet të jenë bastun për njëri-tjetrin sa herë të kenë nevojë për mbështetje.

Durimi dhe sakrifica është ilaçi më i mirë në të gjitha marrëdhëniet njerëzore.

Sidoqoftë, kur tehu të ketë prekur kockën, pra kur bëhet fjalë për një zullum vërtet të padurueshëm, natyrisht lind nevoja të kërkohet mendimi i prindërve apo të ndiqen rrugë të tjera për ta zgjidhur këtë situatë. E rëndësishme është të përfitohet nga përvoja e duhur.

Çdo njeri dorëzohet përballë sjelljes dhe fjalës së bukur. Një grua fisnike që fiton respektin e bashkëshortit përmes maturisë dhe sjelljes së saj

të bukur, do të gëzojë nderimin dhe besnikërinë e tij.

Me pak fjalë;

Sa më shumë që të dhurosh dashuri aq më shumë do të marrësh dashuri, sa më shumë që të respektosh të tjerët, aq më shumë do respektohesh. Sakrifica nuk humb, por këmbehet me të mira dhe shpërblime. Madje njerëzit besimtarë, e dinë mirë që shpërblimin e munguar në jetën e kësaj bote do ta marrin shumëfish në jetën e përtejme.

Dashuria, respekti dhe sakrifica në familje fillimisht duhet të tregohen nga gruaja. Në një hadith profetik thuhet:

"Gruaja që vdes ndërkohë që burri i saj është i kënaqur me të, hyn në xhenet." (Tirmidhî, Radâ, 10; shih: Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 4)



Në këtë hadith tregohet shpërblimi që do të ketë një grua e mirë e cila ka arritur të fitojë kënaqësinë e burrit dhe në të njëtën kohë vendin që zë burri në familje dhe rëndësinë e përkushtimit të gruas.

Nga ana tjetër, burri duhet të bëjë kujdes ndaj mënyrës së fitimit në punën e tij. Ai nuk duhet t'i ushqejë gruan dhe fëmijët me gjëra të dyshimta, të cilët nuk mund të kenë dijeni për burimin e shpenzimeve që bëhen në familje.

Kjo është një çështje shumë delikate, sepse mënyra e të ushqyerit (haram apo hallall) ndikon shumë në botën shpirtërore të njeriut.

Gratë duhet t'u gjenden gjithmonë pranë bashkëshortëve të tyre në punë të lejuara, në mënyrë që burrat të gjejnë prehje dhe mbështetje tek ato. Siç dihet, mirësitë dhe bukuritë shtohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët, ndërsa fatkeqësitë dhe hidhërimet pakësohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët.

Burri dhe gruaja nuk duhet të harrojnë asnjëherë që janë bashkudhëtarë në rrugëtimin e jetës së kësaj bote dhe botës tjetër. Ndërkohë që më parë secili prej tyre kishte një jetë të pavaruar, përmes martesës ata bëhen pjesë e një jete dhe fati të përbashkët. Për rrjedhojë, ata duhet të respektojnë detyrimet e jetës së përbashkët dhe duhet të mbështesin gjithmonë njëri-tjetrin përballë sfidave të jetës.

LARGPAMËSIA DHE MORALI I BUKUR

Nëse shqyrtojmë çështjet që prishin qetësinë familjare, konstatojmë se këto mund të parandalohen përmes moralit të bukur, sjelljeve të matura dhe largpamëse.

Një grua e mençur duhet të zotërojë mjeshtërinë e të fituarit të zemrës së bashkëshortit të saj.

Ajo, duhet të bëjë kujdes ndaj sjelljeve të burrit të saj dhe, kur vëren se ai është i nevrikosur për diçka nuk duhet ta zmadhojë çështjen duke e çuar atë deri në përmasat e një mosmarrëveshjeje. Kjo, sepse grindjet serioze dhe afatgjata, e cenojnë dashurinë dhe respektin midis bashkëshortëve, duke e vënë në rrezik harmoninë e familjes. Në raste të tilla, është e domosdoshme që gratë të bëjnë kujdes në sjelljet e tyre ndaj burrave, duke u treguar të matura dhe të durueshme. Në fund, edhe burri do ta kuptojë gabimin e vet dhe do t'i kthehet gruas me një respekt më të thellë. Përndryshe, edhe pse fajtor, burri nuk do ta kuptojë padrejtësinë që bën kundrejt bashkëshortes së tij dhe si rezultat shejtani do të hedhë farat e urrejtjes dhe armiqësisë në zemrat e tyre.

Një çështje tjetër ndaj së cilës bashkëshortët duhet të jenë të kujdesshëm është edhe xhelozia e tepruar dhe ndjenja e mosbesimit. Humbja e besueshmërisë tek të tjerët është një ndjesi që njerëzit nuk e duan. Nisur nga kjo, para se të fajësojnë njëri-tjetrin për çfarëdolloj çështjeje, bashkëshortët duhet të ndjekin rrugën e diskutimit të gjërave me qetësi. Përndryshe nuk ka kuptim që gjërave të vogla e të parëndësishme t'u jepet vend aq sa të kthehen në probleme të mëdha.

Njerëzve, mund t'ju mungojë intuita në lidhje me disa çështje, ata mund të harrojnë ose të gabojnë. Prandaj, nëse gruaja e sheh se burri ka nevojë të këshillohet, ajo duhet t'i gjendet pranë bashkëshortit dhe ta mbështesë me sinqeritet duke i ofruar mendimin e saj më të drejtë. Nuk duhet harruar që burri dhe gruaja janë udhëtarë në një rrugëtim të përbashkët ku duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër gruaja duhet t'i shmanget kritikës dhe këshillimit të burrit pranë të tjerëve. Sado që të ketë gabuar, ajo nuk duhet ta turpërojë burrin dhe të shfaqë mangësitë e tij në mesin e të tjerëve. **Kjo bie ndesh me parimet etike. Por e njëjta gjë natyrisht vlen edhe për burrat.** Kështu në ajetin fisnik thuhet:

"Ato (bashkëshortet) **janë petk për ju e ju jeni petk për ato."** (Bakare, 187)

Nga ana tjetër, nuk është urtësi që gruaja përkundër të metave dhe magësive të burrit të saj, të lavdërojë një burrë tjetër pranë tij. **Ajo nuk duhet të ankohet për burrin e saj tek askush, qoftë edhe tek prindërit e saj dhe duhet të ketë kujdes të mos e vërë në pozitë të vështirë pranë të tjerëve.** Në vend që t'i shfaqin mosmarrëveshjet midis tyre tek të tjerët duhet të përpiqen t'i zgjidhin ato mes vete.

Me pak fjalë, themeli i arritjes së lumturisë në këtë jetë dhe në jetën tjetër është vlerësimi dhe respekti i ndërsjellë midis burrit dhe gruas. Ata duhet ta dinë mirë vlerën e njëri-tjetrit.

Nëse bashkëshortët respektojnë parimet e bukura të moralit, ata do të bëhen xheneti i njëri-tjetrit. Në të kundërt, nëse shkelin mbi këto parime, jeta do bëhet e papërballueshme.

Në lidhje me vlerën e gruas së devotshme i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Pas përkushtimit ndaj Allahut, mirësia më e madhe për besimtarin është një grua e mirë e cila:

- *E gëzon burrin kur ai shikon fytyrën e saj,*
- *Përmbush kërkesat e ligjshme të bashkëshortit të saj,*
- *Ruan pasurinë dhe nderin edhe në mungesë të bashkëshortit të saj."* (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5/1857)

EKONOMIA NË FAMILJE

Disa njerëz pandehin se lumturia është fshehur tek pasuria dhe mundësia ekonomike për të zotëruar gjithçka. Nisur nga kjo ata e quajnë fat të madh martesën në një derë të pasur.

Lumturia e vërtetë është lumturia në jetën e dy botëve. Pasuria e kësaj bote është sprovë dhe mjet për të fituar botën tjetër (ahiretin).

Një grua e mirë, edhe nëse bën pjesë në një familje të pasur, nuk bie pre e tundimit të luksit dhe shpërdorimit, por mëson të jetë e përmbajtur.

Ndërsa një grua e mirë që ka mundësi të kufizuara materiale, arrin ta përjetojë lumturinë dhe paqen përmes ndjenjës së dorëzimit ndaj caktimit hyjnor. Ajo nuk shpreh ambicie të zotërimit të gjithçkaje që sheh në kurriz të rëndimit të buxhetit familjar. Pasuria më e madhe që mund të zotërojë njeriu është kënaqja me atë që ka dhe jo endja në kërkim të diçkaje që nuk mund ta zotërojë dot.

Sepse ambicia e tepruar e rrokullis njeriun drejt një amullie shpirtërore dhe mbingarkese të papërballueshme.

Për shkak të kartave të kreditit gjithnjë e më të përhapura në ditët tona, shumë familje që mendojnë se mund të marrin me lehtësi gjithçka që shohin, bien në vorbullën e borxheve dhe kamatës si rezultat i harxhimeve të panevojshme. Kështu sa e sa familje të lumtura humbasin harmoninë dhe qetësinë familjare duke përfunduar deri në shkatërrim.

Edhe nëse gjendja ekonomike e një familjeje është shumë e mirë, duhet të shmangen shpenzimet e tepruara dhe shpërdorimi. Kjo është një detyrë që i përket si gruas ashtu edhe burrit. Vjen një ditë që njeriu bie në pozitën e padëshiruar të kërkimit të asaj që e ka shpërdoruar. Krijuesi Fuqiplotë në ajetin kuranor shprehet:

"Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij." (Isra, 26-27)

Si mund të jenë dorëshpuarit vëllezër të djallit?

Nuk duhet harruar se shpërdorimi është përpjekja për të shtypur ndjenjën e inferioritetit përmes pasurisë dhe dukjes.

Sepse si rezultat i tendencës së njeriut për të imituar, familjet fillojnë të ndjekin shembullin e njëra-tjetrës në çështjen e shpërdorimit duke e kthyer atë në një epidemi. Kjo natyrisht e bën më të lehtë punën e djallit.

Nëse njeriu zotëron ushqime, pije apo veshje të tepërta, duhet të kërkojë dhe të gjejë nevojtarët dhe t'ua ndajë të drejtat që u takojnë. Sepse gëzimi i nevojtarëve dhe fitimi i duasë së tyre të sinqertë është garanci për bereqetin dhe lumturinë e familjes. Nuk duhet harruar se besimtari është përgjegjës për vëllanë e tij besimtar dhe po ashtu nuk duhet të harrojmë se ne mund të ishim në pozitën e nevojtarëve dhe nevojtarët mund të ishin në pozitën tonë.

Dhurimi i gjërave të vjetruara dhe sendeve të pavlerë, nuk përbën kriterin e dhurimit të një besimtari; ky kriter shprehet më së miri në ajetin vijues:

"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) **nga ajo** (pasuri) **që e doni."** (Al-i Imran, 92)

Shkalla e devotshmërisë dhe e përkushtimit të grave në familje duhet të jetë në një nivel të lartë sa të ndikojë pozitivisht në punët e mira të bashkëshortit, fëmijëve, të afërmve madje edhe të fqinjëve.

Po ashtu vlen të theksohet se menazhimi i duhur i ekonomisë familjare së pari është detyrë e zonjës së shtëpisë. Nëse ajo tregohet e kujdesshme dhe e matur në çështjet e veshmbathjes, ngrënies dhe pirjes, atëherë sado të ulëta të jenë të ardhurat e familjes, në të do të mbizotërojë mirëqenia, begatia dhe paqja.

Si rrjedhojë e mosrespektimit të këtyre parimeve, fatkeqësisht me dhjetra ton bukë hidhen çdo ditë në mbeturina.

Në të vërtetë një grua kursimtare duhet të sigurojë që jo vetëm buka, por çdo gjë që hyn në shtëpi të jetë në masën e duhur dhe të përdoret në vendin e duhur. Sepse hedhja e diçkaje pa e konsumuar fare është një formë shpërdorimi të cilën vetëm gratë e kujdesshme mund ta parandalojnë.

Në të kaluarën gratë ishin shumë të kujdesshme dhe të gatshme të qepnin ose të riparonin rrobat e grisura me qëllim që të mos shpërdoronin. Ndërsa sot shumica e tyre preferon të blejë menjëherë diçka të re pas grisjes më të vogël. Kjo reflekton një edukatë jo të mirë të shpërdorimit.

Veshja e diçkaje të vjetruar reflekton një lloj modestie. Po ashtu kjo përbën edhe një këshillë që mbron këdo që ngulit sytë e smirës në lumturinë dhe paqen e një familjeje.

Me pak fjalë, nësë për zonjat e shtëpisë jeta e ahiretit është parësore, familja e tyre do të përjetojë lumturinë e dy jetëve...

Kështu, asnjë dallgë e jetës nuk do mund të prishë harmoninë e familjes. Për rrjedhojë çerdhet familjare të ngritura me përkushtimin e një gruas fisnike, do të shndërrohen në kopshte xheneti. Në këto kushte, burrit i mbetet ta kuptojë vlerën e një gruaje të tillë, ta mbrojë dhe të tregohet mirënjohës ndaj saj.



Si Dielli

Nuredin Jëlldëz

Kur besimtari ta ketë nijetin e ndritur dhe emocionin e zjarrtë si dielli, në pah del një brez si sahabët, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Dielli si një burim që nuk i pakësohet energjia dhe që nuk e ngatërron kalendarin që nga dita kur është krijuar, është shembull për besimtarin. Shokët e të Dërguarit të Allahut, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre, ashtu u bënë. Identiteti i tyre që nuk tretej nga dita më ditë dhe energjia e tyre që nuk pakësohej pas ndonjë ngjarjeje, i bënë ata të ndryshëm. Ata u plakën, por nuk u dorëzuan. Me cilindo identitet që ecën nëpër rrugës e Medinës, ecën edhe nëpër shkretëtira. Kuranin që e kënduan në xhami, e kënduan edhe në shtëpitë e tyre. Duart, këmbët, sytë dhe veshët e tyre u morën energji nga zemrat. Ndërsa zemrat e tyre ishin të lidhura me Allahun (xh.xh.). Në këtë mënyrë, u lartësuan si dielli në horizontin e umetit. As ata nuk u vjetërsuan në kohën e tyre, as shekujt që kaluan pas tyre nuk mundën t'i vjetërsonin. Atë ditë ata ishin "një brez prej të cilit Allahu ishte i kënaqur". Edhe sot kështu janë. Madje deri në kiamet kështu do të jenë, me lejen e Allahut.

Të qenët si dielli për shekuj me radhë me të njëjtën temperaturë dhe të njëjtin ndriçim ishte një cilësi dalluese e atyre. Ky është rregulli që duhet ta dinë ata që ndjekin rrugën apo që kanë dëshirë të ndjekin gjurmët e sahabëve. Të jesh i mirë do të thotë që vazhdimisht të jesh i tillë. Besimtar i mirë është ai besimtar që vazhdimisht është i mirë. Ndikim të mirëfilltë ka ai agjërim që mbahet në mënyrë të vazhdueshme. Puna më e mirë është puna që bëhet vazhdimisht edhe nëse është e pakët. Kjo kështu ka qenë dje, kështu është sot, kështu do të vazhdojë të jetë edhe nesër.

Çfarëdo që ta bëjmë për hir të Allahut duhet ta hetojmë se me çfarë emocioni provizor apo me çfarë vendosmërie të pathyeshme që e shndërron atë në të vazhdueshme e kemi bërë. Një temë në lidhje me xhihadin për të cilën kemi folur përgjatë një bisede me shokët, a ka ndonjë ndikim pasi të largohemi nga shokët apo ato që kemi folur kanë humbur në zbrazëtirën e universit? Absolutisht që ka ndryshim ndërmjet atij që bën punë si diell dhe atij që bën punë si qiri. Vallë punët tona janë si diell apo si qiri?

Sigurisht se emocionin në një vend të bekuar apo në një kohë të tillë nuk mund ta mbajë gjithmonë të njëjtin nivel. Të falësh namaz në Mekë dhe pranë Qabesë është diçka krejt ndryshe. Mbajtja e emocionit në këtë nivel në ndonjë vend tjetër të kësaj bote është i pamundur. Përshpirtshmërinë që e kemi në praninë e një dijetari të devotshëm nuk mund ta formojmë dot në mjedisin e shtëpisë. Muajin e Ramazanit nuk mund ta mbartim në muajt e tjerë. Mirësitë e ditës së Arafatit nuk mund të gjenden në ditët e tjera. Vazhdimisht nuk mund të lexojmë Kuran. Në xhami nuk mund të shkojmë siç shkojmë te puna. Botëkuptimin tonë në lidhje me respektin dhe shërbimin që ua bëjmë prindërve nuk mund ta kemi të njëjtë me botëkuptimin në lidhje me respektin dhe shërbimin që ua bëjmë njerëzve të tjerë. Në fakt, një gjë e tillë nuk kërkohet prej nesh. Pirja e ujit të zemzemit nuk mund të jetë e njëjtë me pirjen e ndonjë lloj lëngu tjetër. Partneri është tjetër për njeriun, shoku është tjetër. Dija është gjë tjetër, kultura është gjë tjetër. Sigurisht që këto kanë ndryshim me njëra-tjetrën. Prej nesh nuk kërkohet që këto t'i kemi njëlloj.

Emocioni për të bërë adhurim dhe butësia që kemi në muajin e Ramazanit mund të pakësohen në muajin e Shevalit, por nuk mund të humbasin krejt. Muaji i Ramazanit nuk mund të kthehet në një muaj që e ka humbur influencën e tij. Dega të cilën duhet ta kapim është kjo degë. Kauzën e Kudsit nuk mund ta mbartim në rrugët e Stambollit siç mund ta mbartim në rrugët e Kudsit. Kjo është e pamundur. Ajo që është e mundur është mbartja në jetën e përditshme e ndikimit të emocionit që kemi në rrugët e Kudsit. Zekati jepet një herë në vit, por dëshira për të dhënë për hir të Allahut duhet të jetë e përhershme. Kurani Fisnik mund të lexohet në orare të caktuara, por lidhja me të duhet të jetë e pafundme. Dashuria ndaj besimtarëve apo përforcimi i vëllazërisë në besim mund të mos jenë aktive kur të hyjmë në shtëpi, por mendja dhe identiteti ynë duhet të jenë të hapura ndaj asaj vëllazërie.

Ky është ndryshimi ndërmjet diellit dhe qiriut. Njëri është i përhershëm, pra, nuk shuhet dhe nuk mbarohet. Ndërsa tjetri është i përkohshëm. Këtij të fundit drita i vjen nga tretja e tij. Besimtari duhet të posedojë dëshirën për ta bërë të përhershëm besimin dhe emocionin që i fal besimi. Për ta realizuar këtë dëshirë, ai duhet ta bëjë atë që i takon. Kur të kryejmë haxhin si një adhurim, duhet të kemi kujdes edhe ndaj kushteve të këtij ibadeti, edhe ndaj ndikimeve që na jep pasi ta kryejmë. Gjithashtu duhet të përpiqemi që emocionin e marrë nga këto ndikime ta bëjmë të përhershëm. Kjo është e vlefshme edhe për muajin e Ramazanit. Kurani që këndohet dhe bëhet hatme duhet ta mbartë një gradë më lart atë që e këndon. Sa më shumë që të japim lëmoshë, aq më shumë duhet të shtohet edhe altruizmi. Meka, Medina dhe Kudsi duhet të jenë rrugët në të cilat ecim. Ato asnjëherë nuk duhet t'i nxjerrim nga zemrat tona. Këtë emocion duhet ta gjejmë në çdo vend ku mbledhim sevape, në mënyrë që të bëhemi posedues i veprave si dielli.



Përtej horizonteve

Idris Arpat

Puna jonë është e lehtë, vëlla i nderuar. Arritja e kënaqësisë së Allahut Teala është një qëllim. Arritja e të konceptuarit të kësaj mirësie është fatmirësi.

Përpjekja për të jetuar "në rrugën e drejtë" për hir të të Vërtetit është çështja jonë themelore. Meqë mendimet dhe ndjenjat ushqehen nga informacioni, njohja e të vërtetave është çështje që ka përparësi për ne. Këto mendime, ndjenja dhe veprime do të bëhen shkak për një iluminim të brendshëm dhe një prehje shpirtërore.

Përgjatë kohës kushtet mund të na dobësojnë. Punët në këtë botë provizore mund të mos shkojmë siç dëshirojmë ne. Atëherë çfarë të bëjmë? Mos vallë duhet të ulemi dhe të qajmë? Ja që i gjalli nuk mund të vdesë me atë që ka vdekur. Ata që janë gjallë, janë të detyruar të jetojnë dhe ta vazhdojnë jetën. Andaj duhet t'i kalojmë vështirësitë një e nga një para se të na lidhen duart dhe këmbët. Nëse i drejtohemi me shpresë Zotit të Arshit në kohët e vështira, kjo do të na bëjë të fortë. Lutje do të thotë se nuk jemi vetëm. "Allahu është me ne në çdo situatë". Nëse kjo është kështu, atëherë çfarë rëndësie do të kishte sikur e gjithë bota të ishte kundër nesh?

Ne dëshirojmë që në këtë botë të jetojmë në një begati më të madhe dhe në miqësi me njëri-tjetrin. Por ja që për fat të keq, nuk po marrim dot frymë prej stresit, gjakut, shqetësimit dhe lotëve. Çfarë janë këto që po ndodhin? Çfarë ka myslimani që nuk po merret dot vesh me myslimanin tjetër? Cili

është shkaku që të gjithë janë në gjendje lufte me të tjerët? Mos vallë jemi ballë për ballë me projektet e mendjemëdhenjve të kësaj bote në çdo dimension të jetës? Sa shumë projekte afatgjata që kanë këta njerëz të mallkuar! Ah këta njerëz që u rënshin në kokë kurthet e tyre! Në të vërtetë, umetit të Muhamedit i ka hije të punojë me projekte afatgjata. Si kanë thënë? "Ai që nuk mendon për të largëtën, është afër brengosjes." Askund nuk mund të arrijmë me marrjen e masave ditore.

Sidoqoftë ne përsëri le të vazhdojmë ta rregullojmë botën, t'i vendosim gurët mbi gurë dhe të mbjellim pemë buzë rrugës. Le ta konsiderojmë si mirësi mësimin e një ajeti fisnik apo hadithi një fëmije. Le t'u mësojmë të tjerëve sa të kemi mundësi. Le të themi: "Përderisa është Allahu, nuk ka pse të biem në pesimizëm." Andaj le të përpiqemi. Nganjëherë njeriu mund të bëhet edhe mbrojtës i një kauze që ka humbur. Ai mund të ndjehet edhe si kuajt që vrapojnë pasi ka mbaruar gara. Por prapë se prapë nuk ka problem. Kjo të paktën është një ndjenjë fisnikërie.

Kush mund të përfitojë për të qarit, ankimeve dhe rënkimeve? Në vend që të ankohemi prej errësirës, le të ngrihemi dhe të ndezim një qiri."

"Ah dashuria! Ti, unë edhe Allahu... Sa mirë do të ishte sikur të bëheshim bashkë të tre dhe të bënim një botë sipas kërkesave tona!"

Ah trupat e fëmijëve të vdekur nëpër brigjet e deteve, ah rënkimet dhe vajtimet e nënave në krye të arkivoleve, ah zogjtë që përpëliten sa andej-këtej ngaqë kanë humbur foletë bashkë me të vegjlit e tyre, ah fytyrat e zverdhura të bashkëshorteve të reja, ah mijëra dëshmorë që po japim dita-ditës!.. Po, të gjitha këto mendoj se duhet të na bëjnë të fortë kundrejt të gjitha lodhjeve. Këto duhet të na bëjnë të luftojmë kundrejt çdo lloj padrejtësie. Andaj duhet ta gjejmë çdo gjë që duhet ta posedojmë dhe ta dimë çdo gjë për të cilën kemi nevojë. Nëse është e nevojshme, le të vdesim për këtë...

Le ta përmbledhim kështu: Ne jemi punëtorët durimtarë të kësaj bote. Siç thotë hoxha ynë i nderuar: "Kam shpëtuar nga shtypja e problemeve me një tempo të ngjeshur pune.", edhe ne do të shpëtojmë nga shqetësimet dhe do të arrijmë "kënaqësinë për të jetuar" kur të përpiqemi në maksimum. Ne jemi të dehur nga vera e durimit dhe përpjekjes. Andaj nuk shohim prapa dhe nuk dorëzohemi. Allahu na ndihmon. Ne qëndrojmë vazhdimisht te dera e Mikut të Madh. Kështu që, kush mund të na dalë përballë?

Ne jemi si furtuna e maleve me dëborë. Andaj mund ta gjejmë rrugën edhe ndërmjet dëborës që vërtitet nga të gjitha anët për të dashurit tanë.

Nganjëherë një ajet fisnik na merr dhe na shpie përtej horizonteve. Ai na i lidh plagët, na shëron dhe na jep prehje. Falënderimet i përkasin Allahut Teala për këtë.

Ne e njohim mirë gjendjen e kësaj bote, andaj dhe kemi hequr dorë prej çdo gjëje të sajë. Kemi harruar të preokupohemi me jetën tonë ngaqë jemi punëtorët durimtarë që janë të dashuruar me ndjenjën e ndihmës ndaj të tjerëve. Neve nuk na ka mbetur asgjë tjetër përveç sakrificës. Andaj do të vdesim dhe do të ringjallemi me këtë dashuri.

Ne kemi bërë anije në shkretëtirë. Jemi kapur fort pas shpresës dhe besimit nëpër puse. Burgjet i kemi shndërruar në shkolla dhe kemi bërë famë në histori e jemi bërë legjendë për njerëzit. Përgjatë gjithë jetës kemi qëndruar ndërmjet qiellit e tokës.



KONKURRENCA

Ahmet Zijlan

Të gjithë po garojnë... Popujt garojnë, shtetet garojnë, firmat dhe institucionet garojnë... Edhe biznesmeni përpiqet për të fituar. Në këtë mënyrë, garon me shumë konkurrues të tij. Për këtë arsye, i përdor avantazhet, fuqinë, teknologjinë, përvojën dhe mundësitë e tij. I mban të fshehtat e prodhimit dhe marketingut. Respekti ndaj të fshehtave të profesionit është themelor.

Nëse gara dhe rivaliteti për të fituar bëhen brenda disa rregullave të caktuara, janë gjëra të bukura dhe të dobishme për njerëzimin. Për shembull, njerëzit kanë nevojë për këpucë. Edhe prodhuesit e këpucëve kanë nevojë për lëndën e parë, për disa mjete dhe produkte industriale, në mënyrë që ta bëjnë këtë prodhim. Me mijëra punë në mijëra sektorë... Punësim...

Njerëzit përpiqen për të fituar riskun. Për këtë arsye, mundohen të gjejnë më të mirën, më cilësoren dhe më të lirën kur konkurrojnë. Teknika dhe informacioni do të zhvillohen. Edhe dëshirat e njerëzve janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Të gjithë kërkojnë atë që pëlqejnë. Në sajë të kësaj do të dalë në pah një kërkim më i bukur dhe më estetik. Do të dalë kultura dhe arti. Nëse rivaliteti bëhet kështu, është i bukur. Nisur nga kjo, ajo bëhet e dobishme për njeriun dhe shoqërinë. Por ka edhe gjëra që bëhen për të mos lënë rival. Ka prej gjërave që bëhen për ta zhdukur rivalin, për t'ia marrë frymën dhe për t'u monopolizuar duke përdorur forcën materiale. Këto nuk janë gjëra të bukura. Këto i dëmtojnë edhe njerëzit.

Feja jonë nuk i pranon si fitime hallall rivalitetet e padrejta si formimi i monopolit, mbajtja stok e mallit për t'u shitur shtrenjtë në kohë krize dhe ndikimi i tre-



gut. Njerëzit duhet të kenë iniciativë të lirë dhe ta kërkojnë riskun në treg duke e lënë atë të funksionojë në gjendjen e tij normale.

Meqë kemi rastin, po ndajmë me ju një kujtim, të cilin e kemi përjetuar edhe me përvojën tonë, në lidhje me rëndësinë e ekuilibrit të humbjes dhe fitimit në botën e biznesit. Në këtë kujtim bëhet fjalë edhe për çështjen e rivalitetit:

Akoma nuk patëm ardhur në Stamboll. Kolegu im në profesion, Ekrem Sevinçeri i cili në atë kohë kishte blerë një makineri dhe po e sillte në Gaziantep, më tha:

"Firma në të cilën bleva makinerinë, po shet një furrë që than copën për këpucë. A të intereson? Unë i thashë:

-Po, më intereson."

Kur erdhëm në Stamboll, u njohëm me atë personin që e shiste furrën. Ai kishte një furrë tharjeje të copave. Atë kohë, prodhimin e copave e bënte një firmë e madhe që quhej Derby dhe ky person. Kjo furrë thante dhe e forconte copën të cilës i hidheshin ilaçe kimike. Kjo bëhej me qëllim për të forcuar pjesët e përparme dhe të pasme të këpucëve. Ky ishte një produkt industrial në prodhimtarinë e këpucëve.

Ky personi dëshironte të na e shiste furrën pesëdhjetë e pesë mijë lira. Në fakt ajo ishte një objekt i vjetër që mund të gjendej me dhjetë mijë lira... Por kishte teknologji dhe një prodhim që klientët prisnin gati për ta marrë. Ky personi ishte i gatshëm të na e jepte për pesëdhjetë e pesë mijë lira. Unë isha i qetë ngaqë e dija se ku prodhohej ky produkt, si shitej dhe se sa shitej. Desha ta marr, por kishte diçka që nuk më linte nga brenda dhe ma prishte mendjen. Ky personi thoshte: "Në ditë mund të bëni 150-200 copë. Harxhimi për çdo copë është nëntë lira."

Unë po mendoja në vetvete: "Prodhimi kushton nëntë lira dhe mund të shitet me katërmbëdhjetë lira. Pesë lira ngelin fitim për çdo copë. Nëse prodhojmë dyqind copë në ditë, fitimi është 1000 lira. Nëse furra punon gjashtëdhjetë ditë, i nxjerr paratë e saj. A e shet njeriu një makineri të tillë që i nxjerrë paratë e saj për dy muaj dhe që jep një fitim kaq të madh? Apo ka ndonjë problem në këtë punë? A thua do na e shesë ne këtë dhe vetë do të blejë një furrë tjetër që ka teknologji më të re? Atëherë ne nuk mund të garojmë me atë. E pyeta:

"Përse po e shet këtë makineri? Sepse do të marrësh një më të mirë, apo jo? Mu përgjigj:

"Jo, nuk kam për të blerë një makineri të re. Tashmë nuk do merrem me punën e copave. Ju jap fjalën për këtë."

Nga njëra anë, një makinerie dhjetë mijë lirëshe i jep pesëdhjetë e pesë mijë lira për shkak të teknologjisë, por nga ana tjetër, dyshon në këtë, sepse një makineri që punon dhe sjellë para, nuk e japin për pesëdhjetë e pesë mijë lira. Normalisht, një makineri dhjetë mijë lirëshe bie në pesë mijë lira kur është e përdorur. Ndërsa ne do ta marrim rreth gjashtë herë më shumë, pra pesëdhjete e pesë mijë lira. Sepse do të blejmë edhe teknologjinë e saj. Ia dhashë edhe kaparin, por nga brenda nuk i besoja. Dyshoja dhe thosha në vetvete:

"A e shet një burrë i mençur një pulë të tillë që prodhon florinj? Cila është e fshehta e kësaj pune? Dëshira për ta marrë mu shtua edhe më shumë, sepse është një punë e mirë. Prandaj nuk mund të heq dorë. Për shkak të dyshimeve pyeta babain tim:

"Baba, po marrim një makineri. Faktikisht ajo nuk bën as dhjetë mijë lira, por shitësi i saj kërkon pesëdhjetë e pesë mijë lira. Edhe unë mendoj ta marr." Babai më tha:

"Bir, mjafton që më pyete. Ti e di këtë, unë nuk marr vesh nga ato makineri. Ti po më thua se ajo vlen dhjetë mijë lira, por që shitësi i saj kërkon pesëdhjetë e pesë mijë lira. Mua menjëherë më vjen të të them: "Mos bir! Si mund ta marrësh me një çmim të tillë?" Por nga ajo që me the, kuptoj se ti e ke një arsye që dëshiron ta marrësh. Unë të besoj ty sepse ti nuk gabon lehtë. Të qoftë e hajrit. Nëse është në të mirën tënde, Zoti ta mundësoftë ta marrësh, por nëse nuk është në të mirën tënde, Zoti mos ta mundësoftë ta marrësh!" Domethënë, e mora edhe lutjen e babait.

Ky person më parë i kishte shitur një makineri plastiku edhe një shokut tonë, Memik Shekerit... Ata e njihnin njëri-tjetrin, prandaj edhe e pyeta:

"Dua të blej një makineri nga filan person. Por po dyshoj. Sepse ai nuk duhet ta shesë këtë makineri në këtë formë." Ai më tha:

"Jo, ti mos shiko atë! Ai kështu shet. Mos u shqetëso për makinerinë. Sepse ajo punon shumë mirë. Edhe kur na e shiti neve, e njëjta gjendje ishte."

-Ashtu? A mund të më tregosh?"

"Neve na shiti një makineri. Ajo ishte një makineri e vjetër që bënte shapka plastike. Në fillim kur pati dalë bënte nëntëqind palë shapka në ditë. Një palë shapka shiteshin me tre lira. Ndërsa kilogrami i lëndës së parë ishte tre lira. Nga një kilogramë dilnin tri palë shapka. Domethënë, në fund të ditës fitonim të paktën një mijë lira. Pra, ajo prodhonte nëntëqind palë shapka. Nëse fitonim nga një lirë për një palë shapka, u bënin nëntëqind lira.

Ai kërkonte njëqind mijë lira nga ne për makine-

rinë. Atë kohë asnjë nuk kishte makineri plastike. Ne as që e dinin se çfarë makinerie ishte. Shkuam në vendin ku ndodhej makineria, na tregoi një palë shapka të sapo prodhuara. Ato ishin aq të nxehta saqë nuk mbaheshin në dorë. Pak më vonë veproi të njëjtën gjë, na e shtonte dëshirën për ta blerë, por makinerinë nuk na e tregonte para se ta shiste dhe na thoshte:

"Firmoseni marrëveshjen, jepni kaparin dhe pastaj ua tregoj." Hezituam pak dhe menduam: "Kjo makineri i nxjerr paratë e saj për tre muaj. Ai na e jep ne për njëqind mijë lira. A e ka mendjen në vend ai apo është i çmendur? Po ashtu, edhe makinerinë nuk na e tregon. Mos vallë është ndonjë mashtrues? Së fundi vendosëm. Ne ishim tre shokë. Me të vërtetë na doli siç na pati thënë. Ne punuam natë e ditë. Në ditë prodhuam një mijë e pesëqind palë shapka. Për gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë ditë i nxorëm paratë e makinerisë. Nëse do të bënte ndonjë mashtrim, do të na mashtronte ne. Prandaj, i besoni."

Edhe ne, pasi bëmë këto kërkime, e lamë mënjanë dyshimin dhe hezitimin. Kështu që e morëm makinerinë, e çuam te puna jonë dhe e vendosëm në funksion. Pas një kohe, prodhimin e shtuam nga dyqind në katërqind. Ndërkohë, e lamë shtëpinë në Gaziantep dhe erdhëm në Stamboll. Tregtia po ecte shumë mirë. Edhe ne ishim të kënaqur. Siç e patëm planifikuar, paratë e makinerisë i fituam për shtatëdhjetë e shtatë ditë. Asgjë e papritur nuk ndodhi. Edhe shitësi i makinerisë nuk i hyri më kësaj pune siç na pati dhënë edhe fjalën.



Si kanë thënë: "Nëse Zoti e ka bërë kismet, e sjell dora, e sjell era, e sjell rrëkeja... Nëse Zoti nuk e ka bërë kismet, e merr dora, e merr era, e merr rrëkeja..."

Mirë, por cili ishte shkaku që ky person shiste makineri që sillnin kaq fitim?

Kjo gjendje që neve na dukej e habitshme, buronte nga personaliteti i atij personi.

Ky person i cili respektohej nga të gjithë dhe që quhej Nexhati Karaasllan, ishte një njeri që i punonte koka shumë, ishte nga Merzifoni i Samsunit, i sjellshëm dhe i kulturuar. Ai ishte një njeri që i respektonte të gjithë, sakrifikues, jo i shtrenjtë në tregti dhe modest. Por besimin e kishte pak të dobët.

Së pari, nuk ishte i lidhur shumë me punën. Gjithmonë shkonte te puna në orën njëmbëdhjetë. Ai administronte një klub në Jeshilkëj. Rreth orës dy ose tre, kthehej në shtëpi. Ngaqë nuk i jepte shumë rëndësi punishtes, prodhimi kishte ngelur në duart e punëtorëve.

Ai kishte shtëpi, makinë dhe biznes. Nuk bënte ndonjë harxhim të madh. Ishte një njeri që vazhdimisht hante bukë, kos dhe hallvë, por që e gjithë jeta i kishte kaluar me borxhe. Ata që vinin nga Anadolli dhe dëshironin të hapnin ndonjë punë, i udhëzonte, u tregonte rrugën, ua shpjegonte se si duhej të vepronin, i inkurajonte dhe i këshillonte. Për këtë, jo që nuk merrte asnjë pagesë, por edhe shpenzonte vetë.

Ja pra, ky person që i punonte koka, jetonte me borxhe edhe pse fitonte para. E habitshme, apo jo? Shkaku i borxhit dhe harxhimit të tepërt, nuk ishte ai vetë. Ai kishte bashkëshorten dhe një vajzë. Sipas atyre që thuheshin, ato harxhonin tej mase. Paratë që fitonte ky, i harxhonin ato. Ai nuk interesohej me këtë dhe nuk ankohej. Gjithmonë kishte borxh. Për këtë arsye, kur shikonte ndonjë shumë të madhe parash, nuk rezistonte dot ngaqë dëshironte ta paguante borxhin. Po ashtu, në mendje kishte shumë punë të reja për të hapur. Shpresa për t'i hapur ato punë dhe për të arrirë suksesin, nuk i shuhej asnjëherë.

Ai nuk kishte një natyrë që ta ndalonte shpenzimin e tepërt të familjes së tij. Me sa kuptohej, nuk mund të ndërhynte në mënyrë të fuqishme. Një njeri që ka më shumë shpenzime se sa fitime, është e pamundur që të pasurohet. Edhe pse ky person kishte zgjuarsi të madhe dhe aftësi të papara, për shkak të dobësisë në familje, po i shiste të gjitha makineritë, tezgat me të cilat punonte dhe po i jepte

edhe punët që askush nuk i bënte aq lehtë.

Kur ne filluam të prodhonim mallin me makinerinë që patëm blerë, punëtorët e Derbyt ishin në grevë. Kur mbaroi greva, filluan të punonin përsëri. Derby ishte një firmë e madhe. Sikur ta vazhdonte aktivitetin e saj, do të zinte vend ndërmjet firmave më të mëdha të ditëve të sotshme. Por ajo e vazhdonte punën pa bërë investime të reja. Siç thashë, ishte një firmë shumë e madhe. Ne bënim vetëm njërën nga dhjetëra punë që bënte ajo. Edhe këtë e bënim sa çereku i saj. Për këtë arsye, në asnjë lloj mënyre nuk mund të hynim në rivalitet me të. Prandaj ne nuk thoshim: "Malli ynë është më i mirë..." Po ashtu, përpiqeshim dhe kërkonim që prodhimi ynë të ishte më i miri. Më së fundi e gjetëm. Si rezultat nxorëm një prodhim me cilësi më të lartë. Por prapë se prapë nuk thamë në treg se "malli ynë është më i mirë se i Derbyt". Kur shisnim mallrat tona, ata që pandehnin se merrnin vesh mirë nga këpucët, thoshin:

"Ne përdorim Derby. Prandaj nuk përdorim gjëra që na duken të dyshimta!" Ne përsëri nuk bënim reklamë duke thënë: "Jo, malli ynë është më i mirë..." Thjeshtë e prezantonim. Pastaj nuk flisnim për mallin e të tjerëve. Përse? Sepse kishim frikë. Nëse Derby do ta merrte vesh se ne prodhojmë mall më cilësorë, mund të na shtypte. Në këtë mënyrë punuam shtatë vjet. Shitjet tona ditore sa vinin e shtoheshin. Sigurisht se të gjithë po dëgjonin për prodhimin tonë. Edhe nëse nuk bënim aspak reklamë, njerëzit i thoshin njëri-tjetrit. Pasi prodhimi dhe shitjet tona u shtuan, edhe Derby e dëgjoi. E provoi mallin dhe vuri re se prodhimi ynë ishte më cilësorë... Për këtë arsye, vendosi të na shtypte.

Si e shtyp firma e fuqishme një firmë të pafuqishme në treg? Duke ulur çmimin. Derbi i ngriti çmimet e të gjitha prodhimeve të saj, por uli çmimin e mallit që prodhonim edhe ne. Kaluan dy tri muaj. Përsëri kishte rritje çmimi në prodhimet e tjera të Derbyt, ndërsa te malli që prodhonim edhe ne kishte ulje.

Një vit e gjysmë vazhdoi kështu. Përgjatë kësaj kohe edhe ne nuk e ngritëm çmimin. Shpenzimet e prodhimit u ngritën. Tashmë prodhimin tonë e shisnim me çmimin që e prodhonim. Madje e shitëm me çmim edhe më të ulët se shpenzimi i prodhimit. Një ditë morëm takim nga drejtori i firmës Derby dhe shkuam për ta takuar. Atij i thamë:

"Ky rivalitet nuk është as në të mirën tuaj dhe as në të mirën tonë. I keni ulur çmimet. As ne nuk fitojmë, por as ju nuk fitoni. Le të biem dakord për një çmim dhe të fitojmë të dy palët." Ata na thënë: "Ne fitojmë ngaqë e bëjmë vetë prodhimin kimik. Nëse nuk fitoni, mos punoni." Ne u thamë: "Meqë lëndën e parë e prodhoni lirë, na e shisni edhe ne, në mënyrë që edhe ne të hamë bukë." "Në rregull." – na thanë. Pastaj na shitën tre-pesë ton lëndë të parë. Ajo ishte shumë e dobët, për këtë arsye ua kthyem pas.

Kushdo që përpiqet për ta shtypur, shkatërruar dhe për t'i marrë bukën e gojës nga dora rivalit të tij, herët apo vonë do të shkatërrohet edhe vetë. Unë kam parë shumë raste të tilla në përvojën time. Domethënë, "Kushdo që i bën padrejtësi rivalit të tij apo ndonjë tjetri, do ta ketë jetën të shkurtër. Ai e sëmur rivalin e tij, por vetë vdes."

Përfundimisht, pas një viti e gjysmë thamë: "Përse të merremi me këtë punë? Përse të bëjmë inat me ta? Le të bëjmë një punë tjetër. Ka edhe punë të tjera që dimë t'i bëjmë. Prandaj le të merremi me ato punë që dimë." Atë kohë, edhe pse pak, bënim pjesë të poshtme të këpucëve. Pastaj filluam t'i bënim edhe më cilësore dhe të merreshim me atë punë. Punën e mëparshme e lamë. Vetëm pasi e lamë ne atë punë, Derbi i ngriti çmimet e atij malli. Domethënë, e ngriti në çmimin real të tregut dhe vazhdoi të prodhonte.

Me kalimin e kohës, arritëm sukses në punën e prodhimit të pjesës së poshtme të këpucëve. Madje, u bëmë shpikësit e saj. Derby imitoi atë që bëmë ne, por nuk ia arritën qëllimit. Ne vazhdimisht ishim në komunikim me prodhuesit e këpucëve. Ngaqë specialiteti ynë ishte puna e këpucëve, korrëm shumë sukses në prodhimin e pjesës së poshtme të këpucëve. Ndërsa Derby nuk kishte një sektor të tillë. Për këtë arsye, nuk arriti të konkurronte dot me ne. Më vonë u tërhoq komplet nga tregu.

Nëse përpiqesh për ta bërë punën tënde në mënyrën më të mirë, edhe pse rivaliteti i pandershëm do të të vijë rreth e rrotull, përsëri do ta arrish qëllimin tënd. Ndërsa rivaliteti i padrejtë dhe përpjekjet për t'i shtypur të tjerët me politikat e çmimeve, nuk duhet t'i shkatërrojnë iniciatorët e rinj dhe nuk duhet t'i tmerrojnë, përkundrazi, duhet të diskutojnë me ta dhe t'u japin rrugëzgjidhje të ndryshme. Edhe firmat e mëdha nuk duhet të frikësohen nga rivalët e rinj, por duhet të interesohen për të mësuar ndonjë gjë prej tyre. Allahu është Ai që e jep riskun. Rivaliteti është pasuri. Së fundi, qëllimi është respekt ndaj profesionit dhe shërbim ndaj popullit. Ai njeri që e di se rivaliteti i vërtetë është në rrugën për t'u bërë njeri sa më i mirë dhe rob sa më i devotshëm, arrin të ketë sukses edhe në rivalitetin e kësaj bote. Në këtë mënyrë, nuk lëndon askënd dhe i bën të tjerët ta keni lakmi personalitetin e tij.

Lum për atë që ia del mbanë kësaj!...



VËLLAI I QUMËSHTIT I PROFETIT (A.S.), EBU SELEME MAHZUMI (R.A.)

Mustafa Erish

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), ishte prej sahabëve të parë që hynë në Islam, sakrifikues, guximtar dhe trim!.. Ishte një ushtar besimi që zgjodhi Islamin dhe rezistoi në imanin e tij, edhe pse e kishte kundër popullin e vet!.. Ishte djali i hallës dhe vëllai i qumështit i të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ishte prej trimave të parë muhaxhirë, që së pari shkoi në Abisini (Etiopi) dhe më vonë në Medine!.. Ai u lind dhe u rrit në Mekë dhe i përkiste fisit Beni Mahzum. Ishte një djalë trim dhe i fortë. Emri i vërtetë i tij është Abdullah ibn Abdulesed. Ai njihet më shumë me llagapin se sa me emrin e tij.

Nëna e tij është halla e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), Berre binti Abdulmuttalib. Nëna e tij e qumështit është robëresha e Ebu Lehebit, Suvejbja. Ebu Sulejme Mahzumi, (r.a.), ishte vëlla qumështi me të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe me dajën e tij, Hamzanë, (r.a.). (Usdu'l-Gabe, VI, 148.) Ai u martua me bijën e Ebu Umejes, Hindin. Kur u lindi fëmija i parë, emrin ia vendosën Seleme. Pastaj atë e thirrën me llagapin Ebu Seleme. Edhe bashkëshorten e tij e thirrën Umme Seleme. Kur zbriti ajeti fisnik: *"(Së pari)* ***paralajmëro më të afërmit!"*** – Ebu Seleme Mahzumi iu përgjigj thirrjes së Diellit të dy Botëve (a.s.). Në këtë mënyrë, arriti nderin të ishte njëri prej dhjetë myslimanëve të parë. (Isabe, IV, 131-133.)

Populli i Ebu Seleme Mahzumit, (r.a.), ishte armik i Islamit. Velid ibn Mugire dhe Ebu Xhehli, ishin kryetarët e këtij populli. Këta injorantë dhe politeistë të humbur, e torturuan shumë atë, por ai kurrë nuk e la besimin e tij. I përballoi dhe rezistoi kundrejt torturave dhe vështirësive. Nuk hoqi dorë nga Islami. Kur ngeli në pozitë të vështirë, u detyrua të strehohej te daja i tij, Ebu Talibi. Ebu Talibi mori nën mbrojtje nipin e tij, të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe Ebu Seleme Mahzumin. Politeistët u zemëruan dhe i thanë: "Nipin tënd, Muhamedin e more nën mbrojtje dhe nuk të thamë gjë, por marrjen nën mbrojtje të Ebu Selemes nuk do ta lejojmë kurrë." Ebu Talibi shpalli se e kishte marrë nën mbrojtje duke thënë: "Po! Siç është Muhamedi nipi im, edhe ai është nipi im. Askënd nuk lejoj që ta prekë atë."

Pas një kohe, mushrikët e tërbuar nuk dëgjonin më askënd. Ata filluan t'u bënin tortura të papërballueshme myslimanëve të pambrojtur. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u dha leje për të shkuar në Abisini (Etiopi). Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), për t'i inkurajuar myslimanët, së pari vendosi të bënte hixhret me bashkëshorten e tij. Bashkë me familjen doli fshehurazi nga Meka dhe shkoi në Abisini. Atje u lindi një djalë, të cilin e quajtën Umer. Pas një kohe, erdhën lajmet se disa prej të parëve të Mekës ishin bërë myslimanë dhe gjendja ishte qetësuar. Ebu Seleme, (r.a.), bashkë me disa myslimanë, u kthyen në Mekë. Për fat të keq, lajmet që kishin dëgjuar, nuk kishin qenë të vërteta. Ata nuk kishin mundësi të ktheheshin prapa. Ngaqë nuk kishin asnjë zgjidhje tjetër, dikush hyri në qytet fshehurazi dhe dikush duke u marrë nën

mbrojtje. Myslimanët ishin marrë nën bllokadë dhe ishin burgosur në një lagje. Padrejtësitë dhe torturat vazhdonin akoma. I Dërguari i Allahut (a.s.), për shkak të këtyre kushteve të vështira, dha leje për të emigruar në Jethrib (Medine).

Ebu Seleme, (r.a.), përsëri bashkë me familjen e tij, doli një natë fshehurazi nga Meka, por pa kaluar shumë, njerëzit e Beni Mugires i arritën. Ata ishin kundër largimit të tyre nga Meka. Ata morën Selemen, i cili ishte akoma një foshnje dhe Ummu Selemen, ndërsa Ebu Selemes (r.a.), i dhanë leje të largohej. Kur Abdulesedët dëgjuan për këtë, u zemëruan shumë dhe thanë: "O Beni Mugire! Ju ia morët bashkëshorten nga duart birit tonë. Për Zotin, edhe ne nuk ua lëmë Selemen." Pastaj ua morën fëmijën duke e tërhequr. Babai në Medine, nëna në Mekë te Beni Mugire, ndërsa fëmija te fisi i tij Beni Esedët. Kështu qëndruan rreth një vit në vende të ndryshme. Pasi Beni Mugire i dhanë leje Ummu Selemes (r.anha), për të bërë hixhret, edhe Beni Abdulesedët e dorëzuan djalin te nëna e tij. Pa humbur aspak kohë, Ummu Seleme bëri hixhret në Medine dhe shkoi te bashkëshorti i saj. (Ibn Hisham, Sire, 2/468.)

Kur Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), shkoi në Medine, qëndroi si mysafir në shtëpinë e Mubeshir ibn Mundhirit, (r.a.), në Kuba. (Ibn Sa'd, Tabakat, III, 241.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpalli vëlla me Sa'd ibn Hejsemen, (r.a.), i cili ishte prej ensarëve. (Ebu Nuajm, Hiljetu'l-Evlija, II, 3.)

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), ishte një trim hero dhe i aftë për të komanduar. Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit. Në Uhud ishte komandanti i anës së majtë. Përgjatë betejës u plagos rëndë dhe humbi shumë gjak. Pastaj u mjekua dhe plaga iu mbyll. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), pa se ishte shëruar, e bëri komandant të ushtrisë, që u dërgua në një operacion në anën e fisit Beni Esed, në Katan. Në një kohë agimi, Ebu Seleme, (r.a.), i sulmoi Beni Esedët dhe u kthye me shumë plaçkë lufte. Por kur u kthye në Medine, plaga filloi t'i rridhte gjak dhe të përkeqësohej. Më së fundi, nuk u ngrit më nga shtrati.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e vizitonte atë shpesh, e pyeste për gjendjen dhe kërkonte rrugëzgjidhje për shërimin e tij. Por ai ishte drejtuar nga Zoti dhe shpirtin po ia dorëzonte Atij. Ky hadith fisnik, që tregon çastet e fundit të jetës së tij, transmetohet nga bashkëshortja e tij Ummu Seleme, radijallahu anha, në përkthimin dhe shpjegimin e Rijazu's-Salihin. Transmetohet se Ummu Seleme, radijallahu anha, ka thënë: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), hyri te Ebu Seleme (i cili kishte ndërruar jetë). Sytë i kishin ngelur hapur dhe ia mbylli. Pastaj tha: *"Kur shpirti del, sytë e ndjekin atë."* Pikërisht në atë moment, disa pjesëtarë të familjes së Ebu Selemes (r.a.), filluan të qanin me dënesë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: *"Lutuni vetëm për mirësi, sepse engjëjt u thonë amin lutjeve tuaja!"* Pastaj u lut kështu: *"O Zot! Fale Ebu Selemen! Lartësoje atë në shkallën e të udhëzuarve! Mbroji edhe ata që ka lënë pas! O Zot i botëve! Na fal neve dhe atë! Zgjeroja varrin dhe ndriçoja atë!"* (Muslim, Xhenaiz, 7.)

Në shpjegimin e këtij hadithi janë theksuar këto çështje: Bashkëshorti i parë i nënës sonë, Ummu Selemes, radijallahu anha, Ebu Seleme Abdullah bin Abdulesed Mahzumi (r.a.), kishte vdekur. I Dërguari i Allahut (a.s.), kishte shkuar dhe ia kishte mbyllur sytë që i kishin ngelur hapur, duke thënë: *"Kur del shpirti, sytë e ndjekin atë."* Kështu veprohet, ngaqë pas vdekjes, sytë ngelin të fiksuar në një pikë dhe japin një pamje jo të mirë, nëse nuk mbyllen. Meqë Krenaria e Gjithësisë, (a.s.), e ka bërë vetë këtë, kjo është shndërruar në një sunet për umetin. Të afërmit e xhenazes nuk është e drejtë të thonë ndonjë gjë negative për veten e tyre. Pejgamberi (a.s.), duke u lutur pikërisht vetë për Ebu Seleme Mahzumin (r.a.), ka treguar se si duhet të lutemi për myslimanët kur të ndërrojnë jetë. Në këtë dua që ka bërë i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka tri mirësi. Këto janë një ngushëllim jashtëzakonisht i rëndësishëm për atë që ka ndërruar jetë dhe për të afërmit që ka lënë pas. Përballë një rasti vdekjeje, njerëzit, veçanërisht në çastet e para, nuk arrijnë ta kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë apo çfarë duhet të thonë. Ja pra, në ato çaste hutimi, është shumë e rëndësishme të shfaqim nënshtrim ndaj Zotit dhe të lutemi për mirësi pa na kapur paniku. I Dërguari i Allahut, (a.s.), më vonë i kërkoi Allahut Teala falje për atë që kishte ndërruar jetë dhe për njerëzit që gjendeshin aty. Në këtë mënyrë, theksoi se të gjithë kanë nevojë për mëshirën e Allahut (xh.sh.). Lutja për zgjerimin e varrit dhe ndriçimin e tij është kërkim për largimin e shqetësimeve në lidhje me çështjen e varrit, që është stacioni i parë i njeriut. Kjo është një lutje shumë qetësuese për të afërmit e të vdekurit. Zgjerimi dhe ndriçimi, s'ka dyshim se janë zgjerim dhe ndriçim shpirtëror. Për këtë arsye, humbja e vetëdijes në një ngjarje vdekjeje dhe fjalët që thuhen sikur njerëzit mallkojnë veten, nuk është e drejtë.

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), i cili dinte shkrim e këndim edhe para Islamit dhe i cili ishte prej shkruesve të shpalljes, ndërroi jetë në vitin e katërt hixhri. Namazin e xhenazes ia fali i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe u varros në varrezat Bakia. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Amin!

Veshja dhe devotshmëria

Nurten Selma Çevikollu

Epoka jonë përballet me një problem shumë të madh besimi. Fatkeqësisht ne ia përshtatim fenë jetës moderne. Akoma nuk e kemi kuptuar se kjo jetë moderne nuk i ka sjellë lumturi as perëndimit prej ku e kemi marrë, as njerëzve që e kanë imituar atë... Jeta moderne është e mbushur me padrejtësi dhe probleme morale. Vlerat njerëzore shtypen çdo ditë e më shumë. Ndërsa vendi i besimtarëve në këtë botë, shihet qartë nga sjelljet dhe jeta e tyre!.. Jeta moderne dhe kultura bashkëkohore po i shkatërrojnë vlerat njerëzore.

Sot kur materializmi gjendet në qendër të çdo gjëje, bota e jashtme (dukja) ka dal në plan të parë. Myslimanët e morën këtë mënyrë të gabuar jetese dhe e përfshinë në jetët e tyre pa e vendosur aspak në dyshim, kjo bëri që shumë nga vlerat e tyre të humbnin. Dëshira për t'u dukur, na i shkatërroi ndjenjat tona vëllazërore. Jeta që ka për qëllim konsumimin, i kaloi vlerat e besimit tonë.

Jeta moderne u bë shkak për shumë probleme si: veshja si në kohën e injorancës, ndryshimi i roleve brenda familjes, mos-dedikimi i nënës ndaj fëmijëve, qëndrimi i grave në punë me ambiente të papërshtatshme dhe gjëra të tjera të ngjashme. Të gjitha këto bënë që familja të ketë ngatërresa, natyra e gruas u prish dhe morali u shkatërrua. Sigurisht që të gjitha këto çuan në dështimin e plotë të shoqërisë.

Ndërkohë u përfitua nga çdo rast për të ndryshuar mendimet e besimtarëve. Iu bënë lavde bukurisë



së jashtme të njeriut dhe u lanë pas dore virtytet e botës së brendshme. E vërteta është se media bëri reklamën e gjërave që kishte dëshirë duke na i paraqitur si "dëshira estetike", ajo shkoi deri aty sa u mor edhe me lodrat e fëmijëve duke krijuar një "terror estetik". Rolet e gabuara iu paraqitën njerëzimit në një tabaka të artë. Ndërkohë që brezat e rinj kishin nevojë për modelin e bukur Islam. Ne duhet të mbahemi fort në vlerat tona origjinale, jo të kapemi pas gjërave të huaja...

Myslimani duhet ta jetoj jetën në bazë të vlerave të veta dhe duhet të ketë prioritete të cilat nuk i ndërron pavarësisht çdo gjëje. Ai duhet të ketë forcën e rezistencën ndaj gjërave moderne duke u mbajtur fort pas vlerave personale si një besimtar i sinqertë.


Në shkrimin e ditës së sotme dëshirojmë të flasim për gratë që mendojnë se po vishen sipas rregullave të Islamit por që vishen jo shumë ndryshe nga gratë e kohës së injorancës.

Vajzat e mbuluara sikur kanë turp nga mbulesa e tyre dhe po përpiqen që të krijojnë një mënyrë të re, më moderne si e si " të mos i ngjasojmë nënave tona". Por koha ka treguar se ndryshime të tilla kanë bërë që njerëzit të bien në kurthin e modernizmit. Vajzat e reja që dëshirojnë të krijojnë një model pak më origjinal, filluar t'i jepnin rëndësi të madhe pamjes së jashtme, duke humbur vlerat e brendshme fetare. Mbulesa filloi të shikohet si një veshje e thjeshtë.

Më pas tek gratë e mbuluara lindi dëshira për t'i ngjasuar grave të zbuluara. Gjatë këtij procesi zemrat e tyre nuk u ushqyen me vlerat e vërteta dhe u zbrazën edhe nga ato që kishin. Mbulesa është simbol i shumë vlerave shpirtërore por sot ajo është bërë një veshje e thjeshtë pak e ndryshme nga të tjerat. Ndërkohë ajo një veshje e urdhëruar nga Allahu dhe që duhet të mbuloj të gjithë pamjen e jashtme të gruas. (Shiko: el-Ahzab, ٥٩; en-Nur, ٣١). Mbulesa vendoset vetëm për hir të Allahut, vetëm sepse është urdhër i Tij dhe vetëm për ta kënaqur Atë. Ajo nuk vendoset për të qenë më ndryshe prej të tjerëve dhe nuk vendoset në formë të veçantë për të tërhequr vëmendje apo për të mos i ngjasuar mbulesave klasike.

Vajzat e reja që e shikojnë mbulesën si një veshje të thjeshtë, nuk e kanë problem të ngjasojnë me "vajzat moderne" dhe të kenë të dashur, të qëndrojnë jashtë deri në orët e vona të natës, të shpërndajnë fotografi personale në rrjete sociale, të flasin në chat me njerëz të panjohur e shumë gjëra të tjera të ngjashme... Dhe këto të reja i bëjnë këto veprime në fusha të hapura, para syve të të gjithëve.

Shërbëtoret e së keqes kanë shekuj të tërë që mundohen që të boshatisin brendësinë e mbulesës. Jo më kot kanë filluar që të bëhen sfilata të vajzave të mbuluara dhe reklamat e pafundme të shamive. Ideologjia e thjeshtësisë së gruas myslimane është kthyer në dëshirë për dukje dhe rrjedhimisht edhe shpenzime të kota. Një vajzë e veshur me pantallona xhins të ngushta, një bluzë që i tregon të gjitha format e trupit, me makijazh të tepruar dhe me një shami në kokë; mos vallë mendon se është e mbuluar?! Një mendim i tillë nuk tregon tjetër veçse faktin që e kanë marrë Islamin për së mbrapshti. Nuk ka asnjë dyshim se ky nuk është mendimi islam për mbulesën. Këto gra nuk bëjnë



që tjetër vetëm atë që quhet “teberruxh” : shfaqja e bukurive natyrale dhe artificiale.

Në lidhje me këtë temë, dijetarët dhe të parët e Islamit i kanë vendosur kufijtë e mbulesës duke thënë:

“Mbulesa nuk duhet të thotë: më shiko mua!”

Gra të tilla që ecin krah për krah me modernizmin bëjnë gabimin e komentimit të Islamit sipas kokës së tyre. Ato sillen jo duke menduar për botën e ahiretit por për botën moderne. Fatkeqësisht gabimet e tyre po i kushtojnë rëndë imazhit të gruas myslimane duke bërë që ajo të humb elegancën dhe respektin e vet. Në të njëjtën kohë, këto gra moderne dashje pa dashje po i shërbejnë qëllimit të njerëzve dashakeq. Dhe së fundmi, gratë me pamje moderne shkatërruan sigurinë që të jep mbulesa, atë siguri që ishte një ëndërr për shumë vajza myslimane.

Më përpara veshjet ishin më të thjeshta dhe më të përshtatshme me natyrën njerëzore. Atëherë, djemtë nuk u bënin si gra dhe as gratë nuk u vishnin si burra. Sepse edhe mendjet e zemrat ishin më të thjeshta dhe më të qeta. Kurse sot, ekziston një ngatërresë e madhe në mendime, në veprime dhe në zemra. Kjo ngatërresë me emrin “modë” është pasqyruar edhe në veshjen e grave myslimane. Media arrin që çdo veprim të pamoralshëm ta paraqes si diçka të bukur, si diçka të modës!..

Reklamat e vajzave të mbuluara me një makijazh shumë të rëndë nuk kanë asnjë lidhje me Islamin. Duket qartë se çdo gjë bëhet për të rënë në sy dhe për t’u dukur më shumë se të tjerët!.. Gratë myslimane i shikojnë të gjitha këto dhe përjetojnë atë që quhet: “shpëlarje truri”. Fillimisht këto veshje të papërshtatshme gjykohen por me kalimin e kohës ato pranohen me idenë: “përse të mos e provojmë...”Si përfundim, privacia e gruas shkatërrohet krejtësisht. Ne si mysliman kemi vështirësi edhe për ta folur një temë të tillë.

Modeluesit që prej vitesh po luajnë me veshjet e grave myslimane nuk janë mjaftuar me arritjet e tyre të deritanishme por vazhdojnë me ngacmime të tipit:

“- Nëse dëshironi që të jeni me të vërtetë modern duhet të bëni edhe këtë!”

“- Bilës duhet të hiqni edhe atë që keni në kokë!”

Ndërkohë gratë e mbuluara nga frika e epiteteve të papëlqyeshme: “e prapambetur”, “injorante”; bënë ashtu si i thanë duke e humbur qëllimin përfundimtar. Fatkeqësisht, u fye edhe emri i grave myslimane që mbanin mbulesë të rregullt.

Gratë “gjoja të mbuluara” që përpara ligjeve të Allahut dhe devotshmërisë vendosën dëshirën për t’u dukur, kohët e fundit u vendosën në gara se kush vishet më firmato. Shamia të tilla firmato nuk shikohen me syrin e një plotësuesi të mbulesë islame por si aksesor zbukurues. Mos të harrojmë edhe gjyzlykët e bukura që vendosen mbi shami vetëm për të tërhequr shikimet sepse duket qartë që ato nuk shërbejnë për asgjë tjetër. Gratë e veshura me gjëra firmato pas disa kohësh u njësuar me to. Tashmë ato e përdorin si kartëvizitë veshjen e tyre. Ndërkohë ato nuk e dëgjuan urdhrin se “shpërdorimi është haram” por blenë makinat e markave më të fundit. Në fund, personaliteti mysliman ra në këmbët e industrisë së prodhimit.

Sahabët nuk iu afronin as gjërave të dyshimta ndërsa njerëzit e sotëm luftojnë sesi ta shfaqin si hallall atë që është haram.

Duhet ta dimë mirë se përparësia e myslimanit është Islami. Feja duhet të jetë në qendër të jetës. Të themi të drejtën ne jemi shumë të shqetësuar për të rinjtë tanë. Kjo botë e mbushur me gabime sigurisht që ndikon në zemrat dhe në mendjet e tyre. Në një kohë ku shpirti nuk gjen shumë vende ku mund të ushqehet me mirësi është e vështirë që të qëndrosh larg ndikimeve të botës sonë. Në të njëjtën kohë kjo rrymë e rrezikshme e shtyn njeriun shumë larg devotshmërisë.

Teksa myslimanët e vjetër ishin njerëz të takvasë (devotshmërisë) ato të sotmit u bënë njerëz të fetvasë... Virtytet që dikur ruheshin me shumë kujdes sepse kishin rëndësi të madhe, sot ia kanë lënë vendin veseve të ndyra. Njerëzit e vjetër i jepnin më shumë rëndësi devotshmërisë, diturisë, hyzmetit dhe sakrificave kurse njerëzit e sotëm punojnë vetëm për karrierë dhe për t’u dukur me pamjet e veshjet e tyre firmato. Nuk ka dyshim se kjo rrugë nuk të çon në vend të mirë prandaj është e nevojshme që të shkundemi mirë dhe të vijmë në vete.

Myslimanët duhet të zgjohen dhe të ndërgjegjësohen. Nuk duhet ta shkatërrojmë personalitetin tonë si besimtar mysliman vetëm për hir të tekave të modës. Ne duhet të qëndrojmë larg jetës moderne dhe shfaqjeve të saj shumë-ngjyrëshe sepse ajo nuk bën asgjë tjetër veçse na i ndot shpirtrat. Njerëzit modern kanë bërë të pamundurën për ta hequr nga përditshmëria e myslimanëve termin: “devotshmëri”.

Sipas pikëpamjeve bashkëkohore gruaje duhet të jetë në qendër të vëmendjes me anë të pamjes dhe të sjelljeve të saja. Ndërsa devotshmëria dikton të kundërtën e kësaj. Qëllimi i devotshmërisë është që të fitosh kënaqësinë e Allahut në mënyrë që të afrohesh me Të. Shfaqjet e kota bëjnë që të fitosh vetëm miq të rremë. Ndërsa devotshmëria të fiton gjëra të përjetshme.

Urojmë që veshja, veprat dhe devotshmëria të na ndihmojnë që të shikojmë ditë të bukura dhe të frytshme...



PUNËT E NEVOJSHME DHE TË PANEVOJSHME

Xhemal Nar

Islami duhet mësuar në tërësinë e tij. Pra, duhet mësuar me dimensionet e tij të besimit, adhurimit, jurisprudencës dhe moralit. Më pas, duhet të jetohet me sinqeritet dhe më në fund, duhet të përpiqemi ta përçojmë atë edhe tek të tjerët. Si myslimanë që jemi, kur të arrijmë në një numër apo në një peshë të caktuar brenda shoqërisë ku jetojmë, është e detyrueshme që edhe qeveria jonë të jetë Islame, sepse Profeti (a.s.), urdhëron: *"Ashtu si të jeni, ashtu do të qeveriseni."* Kjo është detyra, përgjegjësia, vetëdija, qëllimi dhe shkaku i ekzistencës sonë.

Gjërat e nevojshme për kryerjen e këtyre detyrave tona, të cilat mund t'i përmbledhim si "dija, puna dhe xhihadi", duhet të jenë pak a shumë këto: "Përveç gjuhës mëmë, duhet njohja e mirë e gjuhës arabe, mësimi i mirë i dijeve të Kuranit, Sunetit, Tefsirit, Akaidit dhe Fikhut së bashku me metodat tyre, ndërtimi ose mbrojtja e shoqërisë dhe shtetit islam, duke mësuar qeverisjen dhe politikën, mësimi i historisë islame, mësimi dhe kuptimi i shteteve moderne jobesimtare që përpiqen të shuajnë Islamin me kurthet e tyre, bërja e krahasimeve të sistemit të mendimit dhe filozofisë së mohuesve modernë me sistemin islam dhe kuptimi i tyre në nivelin që mund t'i kundërshtosh, mësimi i gjuhës së nevojshme për shpjegimin e fesë, mësimi i mënyrave të komunikimit, mësimi i një prej gjuhëve të huaja më të përdorura dhe një prej gjuhëve të afërta me civilizimin tonë, si persishtja, indishtja, etj. dhe mësimi i përdorimit në mënyrë të mjaftueshme të kompjuterit dhe mjeteve të komunikimit..."

Nisur nga kjo, mund të themi se kemi shumë punë për të bërë. Për rrjedhojë, nëse ne e kalojmë kohën me lojëra e argëtime, nëse merremi me përgojime, thashetheme dhe punë të tjera të padobishme, nuk do t'i sjellim asnjë dobi Islamit dhe myslimanëve! Përkundrazi, do të bëhemi shkak i humbjes, i vdekjeve, i shkatërrimit dhe konsumimit...

Për këtë arsye, Profeti (a.s.), ka thënë: *"Braktisja e punëve të padobishme, është prej bukurisë së Islamit të njeriut!"*



ALLAHU NUK I DO SHPËRDORUESIT

Ferit Piku

Zoti thotë në Kuranin fisnik: ***"Mos shpërdoro, se shpërdoruesit janë vëllezërit e shejtanëve dhe shejtani e ka mohuar Zotin e tij."***

Zoti ynë ka cilësitë më të larta dhe emrat më të bukur. Ai është i Urti, Përcaktuesi. Ai e krijoi tokën në formën më të bukur dhe në një balancë të mahnitshme. Nëse përqindja e oksigjenit në tokë do të ishte pak më e madhe, toka do të digjej, ndërsa po të kishte më pak oksigjen asnjë gjallesë nuk do të jetonte në tokë. Toka ka largësinë perfekte ndaj diellit. Po të ishte pak më afër, do të digjej, po të ishte pak më larg gjithçka në tokë do të ngrinte. Allahu (xh.sh.), e ka vendosur gjithçka në vendin e duhur.

Po të shohim trupin tonë, këtë krijesë të Zotit, do shohim se çdo gjymtyrë dhe organ është në vendin e duhur, përderisa njeriu nuk e prish trupin e tij. Nëse një organ ka probleme, gjithë trupi ka probleme. Zoti ka vendosur çdo gjë brenda njeriut në një ekuilibër perfekt.

Po ashtu edhe feja jonë është e ekuilibruar. Ajo është fe e mesme, e cila gjithçkaje i ka dhënë hakun e saj. Po ashtu kjo fe kërkon që myslimani t'i japë gjithçkaje hakun e saj, të jetë mesatar dhe i ekuilibruar, as mos ta teprojë e as të mos e lërë mangët.

Një nga kërkesat thelbësore të fesë sonë, të cilën do ta shqyrtojmë në këtë temë, është "**Të ruhesh nga shpërdorimet**". Ajetet kuranore dhe hadithet e profetit (a.s.), tregojnë, se shpërdorimi është punë e rrezikshme, punë që nuk e do as Zoti, as feja islame. Zoti thotë në Kuran: ***"Hani e pini e mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë."*** Unë dhe ti mund të jemi nga ata që shpërdorojnë, por nëse veprojmë kështu, le ta dimë se nuk na do Zoti dhe kur nuk na do Ai, ç'vlerë mund të kemi ne si njerëz.

Ndërsa profeti Muhamed (a.s.), thoshte: *"Ju hani, pini, vishuni dhe jepni lëmoshë, por mos u hiqni mendjemëdhenj."* Zoti ka lejuar ngrënien, pirjen, veshjen dhe dhënien e sadakasë, por nuk duhet t'i bëjmë këto duke shpërdoruar, se Zoti nuk e do shpërdorimin. Kur Profeti (a.s.), merrte abdest, çdo gjymtyrë e lante tri herë dhe pastaj thoshte: *"Kjo është rruga ime. Kush vepron më*

shumë se kaq, e ka tepruar dhe kush e tepron, bën padrejtësi." Dikush mund të thotë: "Profeti (a.s.), i lante gjymtyrët vetëm tri herë, sepse jetonte në një tokë ku nuk kishte ujë." Por profeti (a.s.), ka thënë: *"Nëse je në breg të një lumi, mos shpërdoro, se Zoti nuk i do shpërdoruesit."*

Shpërdorimi fatkeqësisht është një kancer që ka kapur të gjitha nyjet e jetës tonë dhe habia më e madhe është se edhe të varfrit po shpërdorojnë. Shikojmë dhe dëgjojmë përditë se si shpenzojnë yjet e muzikës, kinematografisë dhe sportit. Habitesh nga mallrat që blejnë, nga veshjet që kanë, nga makinat e tyre. Ne habitemi dhe themi: "Si ka mundësi që një palë këpucë të kushtojë 1 milion dollarë, një bluzë të kushtojë 5 milion dollarë". Ky është shpërdorim në rang ndërkombëtar, shpërdorim i atyre njerëzve që sot mbahen si yje të kësaj bote, të cilëve duhet t'u shkosh pas. Shpeshherë shikojmë ankande, ku shiten piktura, që ndoshta nuk kanë ndonjë gjë të madhe, ato nuk janë bërë as prej floriri e as prej argjendi, por megjithatë ato shiten me miliona dollarë dhe njerëzit normalë thonë: "Çfarë bëhet kështu! Si ka mundësi që një pikturë të kushtojë miliona dollarë, në një kohë që ka popuj të tërë që vdesin për bukën e gojës".

Por më e rëndë se kjo është fakti, që disa të tjerë u përgjigjen duke thënë: "Ti nuk merr vesh nga jeta moderne". Mund t`u them këtyre njerëzve: "Ndoshta nuk kuptoj gjë nga jeta moderne, ndoshta nuk kuptoj se si harxhohen kot miliona dollarë, por e kuptoj fare mirë, se sot 1 milion njerëz vdesin çdo vit për bukën e gojës, ndërsa miliona të tjerë vdesin për një ilaç, i cili kushton shumë pak". Ky është shpërdorim, të cilin nuk e do Zoti dhe aty ku ka shpërdorim, dije se ka padrejtësi në një krah tjetër, se Zoti i ka balancuar gjërat dhe po u teprua diku, do të jetë mangët diku tjetër.

Nuk shpërdorojnë vetëm yjet e "botës moderne". Shpërdorojnë edhe njerëzit e thjeshtë, madje ka shpërdorim edhe në shtëpitë e besimtarëve. Fatkeqësisht sot në vendet me popullsi më të madhe myslimane, atje ku ka naftë dhe para, bëhet një jetë vërtet e frikshme. Njerëzit shpërdorojnë nga mëngjesi deri në darkë, duke menduar se të jesh i zhvilluar, do të thotë të shpërdorosh, të kesh makina të shtrenjta e shtëpi luksoze.

Zoti dhe feja islame e urrejnë atë tavolinë, e cila është e shtruar me të gjitha llojet e ushqimeve, që mund t'i mjaftojnë një fisi të tërë, por në atë shtëpi janë vetëm dy – tre vetë, të cilët marrin diçka, ndërsa pjesa tjetër hidhet në koshin e plehrave dhe shikojmë përditë se ata kosha nuk mbushen me miza, por mbushen me njerëz që kontrollojnë për kafshatën e tyre. As atyre nuk u bën përshtypje dhe as ne nuk na bën përshtypje.

Islami e urren atë gardërobë, e cila është e mbimbushur me rroba, por vetëm çereku i tyre vishen, ose vishet maksimumi një herë në jetë dhe pastaj del nga moda. Kështu ato rroba mbeten aty ose hidhen në koshin e plehrave. Ndërsa nga ana tjetër, ka njerëz që nuk kanë se ç'të veshin.

Islami e urren atë pasuri, e cila mblidhet dhe nuk shpenzohet në rrugën e hajrit. Zoti thotë në Kuran: ***"Ata njerëz që grumbullojnë floririn dhe argjendin, ditën e Kiametit ajo pasuri nxehet në zjarrin e Xhehenemit dhe me të lyhen ballët dhe shpinat e tyre."*** Pra, është shpërdorim kur atë pasuri që ta ka lënë Zoti, ta lësh të vdekur në shtëpinë tënde.

Dikush mund të pyesë me plot të drejtë: "Çfarë është shpërdorimi"?

Sipas fesë sonë, shpërdorimi është dy formash:

1- Ta shpenzosh pasurinë atje ku nuk duhet ta shpenzosh, qoftë edhe pak. Ibn Abasi (r.a.). thoshte: "Nëse e shpenzon një qindarkë aty ku nuk duhet, ti je shpërdorues. Por nëse e shpenzon gjithë pasurinë aty ku duhet, atëherë ti nuk je shpërdorues".

2- Ta shpenzosh aty ku duhet, por ta teprosh. Zoti na ka lejuar shumë gjëra, por na ka paralajmëruar që të mos jemi shpërdorues.

Ta teprosh në ushqim: Të hash aq shumë, sa të të dhembë barku, është shpërdorim. Sot shumë njerëzve u dhemb barku nga ushqimi i tepërt, ndërsa pjesa tjetër e botës ka dhimbje barku, sepse nuk ka se ç'të hajë, pasi vuan për kafshatën e ditës. Jo vetëm kaq, por janë hapur sa e sa klinika, të cilat japin receta dhe dieta pa fund, në mënyrë që njeriu të dobësohet, por askujt nuk i shkon në mendje (ose nuk e përmend qëllimisht) të pakësojë ushqimin që ha çdo ditë. Sot po vuajmë me sëmundje nga më të ndryshmet, që vijnë si pasojë e abuzimit me ushqimin. Kurse Profeti (a.s.), thoshte vetëm dy fjalë të shkurtra: *"Vallahi, nuk ka besuar në Zot ai njeri, që fle me barkun*



plot, ndërkohë që komshiu i tij fle i uritur." Ndërsa sa i përket konsumimit të ushqimit, profeti (a.s.), ka thënë: *"I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata sa për të mbajtur shpinën drejt. Por nëse i duhet të hajë, le ta mbushë 1/3 me ushqim, 1/3 me ujë dhe 1/3 me ajër."*

***Ta teprosh në veshje**:* kur të shkosh për të blerë një rrobë, pyete veten: "A e kam të nevojshme ta blej këtë rrobë dhe me këtë çmim". Nëse nuk e ke të nevojshme, mos e bli atë rrobë. Mos e bëj këtë gjë as për mendjemadhësi e as për inat të dikujt tjetër që e ka blerë atë rrobë.

Ka shpërdorim edhe në shumë gjëra të tjera:

- Shpërdorim në argëtim: Zoti e lejon argëtimin, por pa e tepruar, duke kaluar orë të tëra me dëfrime e qejfe.

- Shpërdorim në kohë: pra të rrish me orë të tëra duke pirë kafe me dikë, pa pasur produktivitet as nga muhabeti që bëhet. Në raste të tilla biseda degjeneron duke marrë të tjerët nëpër gojë, për të mbushur kohën. Koha është gjëja më e shtrenjtë që të ka dhënë Zoti dhe Ai do të të kërkojë llogari për të.

- Shpërdorim në kritika: kur ta kritikosh dikë, mos e tepro, se pastaj i humbet vlera edhe kësaj kritike.

- Shpërdorim në zemërim: zemërimi është diçka normale, është njerëzor, por po e teprove, dije se ke shpërdoruar dhe ai që më së shumti shpërdoron në zemërim është mynafiku (dyfytyrëshi). Ndërsa besimtari edhe kur zemërohet, mundohet ta kontrollojë veten e tij.

- Shpërdorim në hakmarrje: Ti ke të drejtë të marrësh hak kur të bëhet padrejtësi, megjithëse po fale është më mirë për ty. Por mos i bëj padrejtësi tjetrit, mos i bjer në qafë më shumë sesa të ka rënë ai ty, se Zoti nuk e pëlqen padrejtësinë, qoftë edhe mbi armikun tënd.

- Shpërdorimi në hallall: shumë njerëz lënë bashkëshortet e tyre dhe rendin pas haramit. Po ta shikosh jetën e këtyre njerëzve, do vëresh se ata i kanë hyrë dikujt në hak, sepse kush lë hallallin dhe shkon në haram, ai bën padrejtësi.

Dikush mund të pyesë: "Ç'na thua për shpërdorimin, kur nuk plotësojmë dot nevojat elementare të jetës". U përgjigjem këtyre njerëzve: "Vallahi edhe fukarenjtë shpeshherë janë shpërdorues. Shpërdorojnë atëherë kur shpenzojnë më shumë sesa kanë nevojë, duke mos e administruar mirë atë pasuri të pakët që u ka dhënë Allahu (xh.sh.). Madje, pjesa më e madhe e shpërdoruesve janë ata persona, që deri dje kanë qenë fukarenj. Ata që Zoti deri dje i sprovoi me varfëri, sot shpenzojnë pa kriter, duke mos menduar se sprova e pasurisë është më e rëndë se ajo e varfërisë.

Le të ruajmë një ekuilibër, se jeta nuk shkon njësoj si sot nesër e pas një viti. Sot je pasanik dhe nesër të sprovon Zoti me varfëri, por njeriu që është gjithmonë i ekuilibruar, ai gjithmonë di të jetojë. Ndërsa ai që shpërdoron, jeton mirë kur është i pasur, por vuan shumë kur bëhet i varfër dhe Zoti nuk i merr leje askujt kur ia jep apo kur ia merr pasurinë.

Kujdes tek fëmijët tanë, sepse për ata punojmë e rropatemi. Harrojmë se duke shpërdoruar për ta, ne i edukojmë keq dhe kjo gjë do të ketë pasoja për ne dhe për ta. T'ia mbushësh fëmijës xhepin me para, është shpërdorim, se ai nuk e merr vesh ç'do të thotë të kesh pasuri. T'ia plotësosh të gjithë tekat fëmijës, është shpërdorim. Plotësoji nevojën, por jo të gjitha tekat, pasi historia ka treguar se shumë njerëz janë munduar t'i bëjnë qejfin fëmijës, por më vonë e kanë paguar shtrenjtë këtë veprim.

Profeti Jusuf (a.s.), u bë ministër ekonomie në Egjipt, por kur hante, nuk ngopej asnjëherë. Shokët që kishte përreth e pyesnin: "Pse nuk ngopesh"? Ai ua kthente: "Kam frikë se po u ngopa, do t`i harroj nevojtarët, se i ngopuri nuk



e ndjen mirësinë që i ka dhënë Zoti".

Populli ynë vuajti nga një regjim i egër si nga ana ideologjike, ashtu edhe nga ana ekonomike dhe mund të themi se jemi një nga popujt e varfër të botës. Por mendoj se përsëri po shpërdorojmë shumë, madje më shumë sesa pasanikët. Ne duhet ta kapim në kohë këtë fenomen, që ta ruajmë veten tonë dhe të ndikojmë për mirë edhe tek të tjerët. Ja disa fakte të dhimbshme:

- Në Shqipëri, në një nga vendet më të varfra evropiane, gjen makinat më të shtrenjta të Evropës. Si ndodh kjo? Dije se në një formë apo në një tjetër këtu ka shpërdorim.

- Në Shqipëri, ku rroga mesatare është 250 mijë lekë të vjetra në muaj, gjen celularët më të shtrenjtë që mund të ekzistojnë, në një kohë që njeriu mund të mos e ketë të nevojshëm këtë lloj celulari.

- Në Shqipëri shpërdorohet me dritat. Ka shumë njerëz që nuk paguajnë faturën e dritave. Por shtëpitë e këtyre njerëzve duken si kështjella mbretërore me drita nga të katër anët, nga çatia deri në oborr. Nga ana tjetër, këtë shpërdorim e paguan pjesa tjetër, që i paguan ato drita. Atyre u vjen fatura e pesëfishuar dhe kjo krijon stres, zemërim dhe prishje të ekuilibrit.

- Në Shqipëri shpërdorohet uji. Jemi një vend që noton mbi ujë, por uji na vjen në shtëpi me orar. Shikon shtëpi që kanë javë të tëra që nuk u vjen uji, por nga ana tjetër, sapo del në rrugë, shikon lavazhe pa fund, që me tuba të gjatë uji lagin rrugën kot së koti. Askush nuk e merr mundimin të njoftojë autoritetet përkatëse. Madje edhe kur vjen uji në shtëpi, çezma rri gjithë kohën e hapur, sepse shumë njerëz nuk e paguajnë ujin. Ky është problemi. Kur paguan ujin, e kursen atë, përndryshe shpërdoron pa kriter. Kjo do të thotë të jesh rob i ligjit, por ne nuk jemi robër të ligjit, por të Allahut (xh.sh.).

- Është mirë që shtëpia të jetë e kompletuar, por habitesh kur shikon se çfarë luksi ka brenda shtëpisë së dikujt dhe çfarë papastërtie ka përreth shtëpisë së tij. Pak më larg shtëpisë së tij vazhdon me qetësinë më të madhe kanali i ujërave të zeza, i cili i mbyt fëmijët, i prish jetën atij personi, por ai nuk mbledh 20-30 lekë të vjetra bashkë me njerëzit e tjerë për të rregulluar kanalin apo rrugën e prishur.

Ky është shpërdorim, të shpenzosh për atë që nuk e ke të nevojshme dhe të mos shpenzosh në atë që është jetike për ty. Prandaj shkollat tona janë shkollat më të prishura. Të gjithë presin ndihma dhe shumë njerëz që vijnë nga jashtë për të ndërtuar shkollën, habiten dhe ikin duke thënë: "Shikoni shtëpitë e këtyre njerëzve. Ata kanë blerë çdo mobilie që mund të të shkojë mendja dhe nuk paskan para për të rregulluar shkollën e fëmijëve të tyre?"

Njerëzit sot shikojnë vetëm oborrin e shtëpisë së tyre, duke mbjellë pemë e lule, kur pak metra jashtë shtëpisë së tyre shkulen pemët e rrugëve dhe askush nuk e prish terezinë e tij. Pak më larg fatkeqësisht digjen me qindra dhe mijëra hektarë pyje e askush nuk pyet me muaj të tërë. A nuk është tokë e vendit tonë kjo, a nuk ka pasur njerëz në këtë vend?! Pasi ndodh hataja të gjithë e paguajmë faturën pastaj.

Profeti (a.s.), tha: *"Dijeni o besimtarë, se Zoti i urren për ju tri gjëra: 1- Zoti urren thashethemet. 2- Zoti urren shpërdorimin e pasurisë që ua ka dhënë amanet dhe për të cilën do të pyeteni. 3- Zoti urren që të pyesni shumë e të mos veproni."*

Zoti na ruajtë nga shpërdorimi. Zoti na bëftë prej atyre që as nuk e teprojnë, as nuk e lënë mangët. Zoti na bëftë myslimanë të mirë për veten tonë, për familjet tona dhe të mirë për gjithë botën mbarë. Zoti i faltë gjynahet, mangësitë tona dhe na mëshiroftë të gjithëve.

Amin!..

Panxhari i Kuq



PËR SHËNDETIN E MIRË TË ZEMRËS DHE ORGANIZMIT

Panxhari i kuq është një nga perimet më të mira shqiptare dhe kultivohet gjerësisht në tokat më pjellore të vendit.

Vërtet është i vogël, por bën një punë shumë të madhe në trajtimin e problemeve të shëndetit.

Ai ndihmon me tensionin e lartë të gjakut, aneminë, tretjen, konstipacionit, problemeve me veshkat, lëkurën dhe sëmundjet e zemrës.

Panxhari gjithashtu ju ndihmon në përmirësimin e qarkullimit të gjakut, parandalon formimin e perdeve të syrit dhe problemet e frymëmarrjes.

Të gjitha këto i adresohen përbërjes së pasur të panxharit me vitamina dhe minerale.

VLERAT E PANXHARIT

Panxhari i kuq ka shumë vlera shëndetësore, duke qenë se është i pasur me vitamina, minerale dhe përbërës organikë si karotenoidi, vitamina C, magnezi, hekuri, bakri dhe fosfori, duke qenë në të njëjtën kohë dhe një burim i shkëlqyer me antioksidues.

Ata kanë shumë pak kalori, nuk përmbajnë kolesterol. Por kanë dhe përmbajtjen më të lartë të sheqerit natyral nga të gjitha perimet.

Bën shumë mirë për zemrën. Fibrat që ndodhen tek panxhari i kuq ndihmojnë për të ulur nivelin e trigliceridеve dhe kolesterolit, duke ngritur nivelin e kolesterolit të mirë.

Triglicеridet në nivel të lartë rrisin shumë mundësinë për të pasur një atak kardiak, ndërkohë që konsumi i panxharit e ul këtë nivel, falë përbërësve të tij.

Redukton defektet në lindje. Panxhari është një produkt i shkëlqyer për gratë shtatzëna.

Duke qenë se është një burim i mirë për vitaminë B, ai ndihmon në zhvillimin e shtyllës kurrizore tek bebet. Mungesa e folatit sjell një sërë defektesh tek të porsalindurit.

Parandalon zhvillimin e qelizave tumorale. Studimet kanë treguar se panxhari është i mirë në parandalimin e qelizave të dëmshme të lëkurës, mushkërive dhe sistemit tretës, duke qenë se përmban pigmentin betacianinë, i cili pengon zhvillimin e tyre.

Parandalon problemet dhe perdet e syve. Plot me beta-karoten, panxhari ndihmon në parandalimin e kataraktit, ose perdes së syrit.

Por dhe problemeve të tjera të dobësimit të shikimit, që vijnë si pasojë e moshës.

Kujdes! Panxhari përmban një element të njohur si oksalat. Konsumimi me tepricë i panxharit kristalizon lëngjet e trupit.

Njerëzit që kanë probleme me veshkat ose me fshikëzën e urinës, nuk duhet të konsumojnë panxhar, sepse mund të përkeqësojnë gjendjen e gurëve në veshka.





PSE DUHET KONTROLLUAR SKADENCA

E UJIT NË SHISHE

Data e skadimit e ujit të ambalazhuar në shishe plastike është data kur plastika fillon të prishet dhe lëshon kimikatet e saj në ujë.

Është njohuri e zakonshme që ju nuk duhet të pini nga shishet e ujit që keni lënë në një makinë të nxehtë, sidomos kur temperaturat e motit janë të larta.

Por kur është hera e fundit që e keni kontrolluar datën e skadimit të një shisheje uji që ju keni porositur në lokal apo blerë në dyqan?

Shumica dërrmuese e konsumatorëve nuk e kontrollojnë datën e skadecës, ata marrin të mirëqënë faktin që uji në shishe plastike është i sigurtë.

Arsyeja pse lëngjet ose produktet e qumështit kanë një datë të skadencës është shumë e vetëkuptueshme, ndaj mund të habiteni që edhe uji në shishe vjen me një afat kohor përdorimi.

Por nuk është cilësia e ujit që duhet të shqetësoheni. Bëhet fjalë për plastikën në të cilën uji vjen i paketuar. Zakonisht vihet re përdorimi i PET për shishe me pakicë dhe polietileni me densitet të lartë, HDPE për paketimet masive të ujit.

Pas një pike të caktuar në jetën e saj, plastika fillon të lëshojë kimikate në ujë. Kjo dukuri ndikon në shijen e ujit i cili përbën një rrezik serioz për shëndetin.

A ju ka ndodhur të lini një gotë uji gjatë natës dhe të pini një gllënjkë të nesërmen? A e keni vënë re se ajo ka shije shumë ndryshe nga uji i freskët?

Ju mund të dyshoni se uji është prishur, por shija e çuditshme është në të vërtetë për shkak se uji është ekspozuar ndaj ajrit. Ky ekspozim e bën ujin më acid duke grumbulluar elementë si pluhuri dhe mikrobet.

Asnjëherë mos lini ujë në shishe në rrezet e diellit të drejtpërdrejtë ose brenda makinës gjatë gjithë ditës në një ditë të nxehtë me diell.

Kimikatet nga ena plastike do të nxehen dhe do të depërtojnë në ujë.

Pirja e këtyre shisheve që kanë mbetur në diell kanë rezultuar të lidhur drejtpërdrejt me tumoret e gjirit tek femrat. Studimet e fundit tregojnë lidhje me lloje të tjera të sëmundjeve tumorale si në meshkuj ashtu edhe në femra.





PAJISJE ME LAZËR PËR TË ZBULUAR USHQIMET E FALSIFIKUARA

Mashtrimi me ushqimet, falsifikimi i tyre, i kushton industrisë së ushqimit dhe pijeve rreth 30 miliard dollarë çdo vit. Mashtrimi me ushqimet është zëvendësimi i qëllimshëm ose keqinterpretimi i produkteve ushqimore për përfitime ekonomike. Në disa raste, si hollimi i vajit të ullirit është me pak rrezik dhe në raste të tjera, përdorimi i niseshtesë ose lëndëve plastike për të zëvendësuar orizin, rreziku është shumë i madh. Siç na njeh edhe materiali në vazhdim, një test me lazër i zhvilluar në Itali mund të zbulojë me saktësi të pabesueshme ushqimet e falsifikuara.

Mashtrimi me ushqimet ndodh për herë dhe në të gjitha llojet e produkteve, që nga lëngjet e frutave, vaji i ullirit e deri tek peshku ton. Hulumtuesit italianë kanë krijuar një pajisje që zbulon menjëherë ushqimet e falsifikuara. Adriana Puiu është me Qendrën Kërkimore Frascati Enea.

"Synimi është të zbulojmë rastet e falsifikimit të ushqimit. Për shembull, prania e vajrave me cilësi të ulët të përziera me vajin e ullirit ekstra të virgjër, ose metanoli në pijet alkoolike, apo fshehja e përmbajtjes së sheqerit në etiketat e lëngjeve të frutave, dhe kryesisht histamina në produktet e peshkut."

Prova bëhet përmes analizës të quajtur spektroskopi fotoakustike me rreze lazër. Një rreze lazër kalon përmes vajit të ullirit apo peshkut dhe zbulon të gjitha kimikatet e ndryshme në të.

"Rrezja lazër përshkron artikullin dhe ndërvepron me përbërësit e tij. Rrezja lazër është ndërtuar posaçërisht për këtë qëllim dhe na lejon të zbulojmë me përpikmëri të lartë molekulat e falsifikuara", thotë hulumtuesja italiane Adriana Puiu.

Sikurse të gjitha teknologjitë e reja, pajisja nuk është shumë praktike. Por ekipi po punon për të prodhuar një pajisje të vogël që të mbahet në dorë.

Luca Fiorani është me laboratorin e Qendrës Kërkimore Frascati Enea.

"Duam të prodhojmë një sistem portativ si një çantë dore që autoritet mund ta marrin me vete për të analizuar produktet. Kur pajisja sinjalizon për probleme në produkte, mostrat dërgohen në laborator për analizë të hollësishme, çfarë kërkon kohë, kushton dhe është komplekse."


Hulumtuesit thonë se një variant portativ do të jetë i mundshëm gjatë tre viteve të ardhshme.

ZBULOHET NJË FORMË E RE E MATERIES

Pothuajse 50 vjet pas krijimit të teorisë së parë për ekscitoniumin, fizikantët përfundimisht arritën të gjejnë fakte për ekzistimin e kësaj forme të materies, transmeton Daily Mail. Ekscitonium përbëhet nga grimca të quajtura ekscitone, të cilat përbëhen nga elektronet e ikura dhe zbrazëtirat që ata lënë pas vetes.

Në eksperimentet e fundit, hulumtuesit patën rastin të vëzhgojnë këtë materie dhe fazën e saj të prekursorit, gjë që konsiderohet si një fakt jo i rëndësishëm për ekzistencën e saj. Për të gjetur formën e re të materies, shkencëtarët kanë zhvilluar një teknikë të re, të quajtur spekstoskopia EEL.

Termi "ekscitonium" është përmendur në vitin 1960 nga fizikanti teorik Bert Halperin nga Harvardi, ndërsa fizikantët që nga atëherë tentojnë që të dëshmojnë ekzistimin e saj. Zbulimi i ri do të duhej të ofrojë përgjigje në shumë çështje nga fusha e fizikës kuantike.



10 FAKTE INTERESANTE QË DUHET TË DINI PËR DRITËN

Më 21 nëntor 1676, astronomi danez Ole Romer njoftoi në Akademinë e Shkencave në Paris përfundimin e tij se drita udhëton me një shpejtësi të kufizuar.

1. Sipas obserbimeve të Romer për Jupiterin dhe hënën, drita udhëton 220,000 km në sekondë. Shifra e saktë është 299,000 km për sec.

2. Romer ishte I pari që provoi se drita nuk udhëtonte asnjëherë.

3. Rastësisht data 21 nëntor ishte gjithashtu data kur Ajnshtajni publikoi së pari ekuacionin $e = mc^2$ duke lidhur energjinë, masën dhe shpejtësinë e dritës

4. Kjo datë është mjaft e rëndësishme në historinë e zërit dhe dritës. Edison shpalli shpikjen e fonografit po në këtë ditë në 1877.

5. Mesatarisht dritës i duhen 8 minuta dhe 20 sekonda për të arritur në tokë.

6. Dritës së hënës i duhen 1.25 sekonda për të arritur te ne.

7. Rrezet e diellit arrijnë deri në 80 metra thellë në oqean

8. Një vit dritë është distanca që drita udhëton për një vit

9. Ylli më i afërt i Tokës përveç Diellit është Proxima Centauri që është 4.24 vite dritë larg

10. Sipas teorisë aktuale, drita nuk ekzistonte deri në mes të 240,000 dhe 300,000 vitesh pas Big bang.

EKSPERTËT RREGJISTROJNË ZHURMË, QË VJEN "NGA BRENDA" PLANETIT TONË

Studiuesit kanë regjistruar një zhurmë që vjen nga brenda planetit tonë duke përdorur instrumente të vendosura në shtratin e oqeanit. Shkencëtarët janë të bindur se zbulimet e reja mund të përdoren për të zbuluar më shumë hollësi dhe saktësi mbi brendësinë e Tokës.

Duke përdorur instrumente sizmike të vendosura në shtratin e oqeanit, studiuesit kanë përcaktuar me sukses sasinë e vibracioneve të Tokës.

Jo, nuk janë alienë, nuk është një bazë alienësh, as nuk ka një anije kozmike aliene në fund të oqeaneve tona.

Shkencëtarët kanë pranuar prej disa kohësh që tërmetet mund të bëjnë që Toka të dridhet për periudha të gjata kohore.

Megjithatë, në vitin 1998 një ekip shkencëtarësh zbuluan se Toka vazhdimisht gjeneron një sinjal vibracional me frekuencë të ulët, edhe kur nuk ka tërmete.

Që atëherë, sizmologët kanë propozuar teori të ndryshme për të shpjeguar ekzistencën e kësaj dridhjeje të vazhdueshme, nga trazirat atmosferike, deri tek valët e oqeaneve.

Ata gjithashtu matën dridhjet duke përdorur sizmometër në terren, por ende nuk kishin matur me sukses në fund të detit, gjë që mund të ndihmonte shkencëtarët të vlerësonin më mirë burimet e dridhjeve.

Tani, duke përdorur instrumente sizmike të vendosura strategjikisht në shtratin e oqeanit, studiuesit kanë arritur të vërtetojnë me sukses sasinë e vibracioneve të Tokës.

Një studim i ri i botuar në një revistë të Unionit të Gjeofizikantëve Amerikanë, shpjegon se si ekspertët arritën të zbulonin frekuencat në të cilat Toka vibron natyrshëm dhe konfirmuan mundësinë e përdorimit të instrumenteve oqeanike për të studiuar lëvizjen e Tokës.

Kapja e lëvizjes në shtratin e oqeanit mund të japë njohuri të reja në madhësinë e burimit, sipas Martha Deen, një gjeofizikane në Institutin e Fizikës së Tokës në Paris, Francë, dhe autore kryesore e studimit të ri.

Përveç kësaj, gjetjet e reja mund të përdoren për të hartëzuar brendësinë e Tokës në më shumë detaje dhe saktësi.

Studimi mund të japë një tablo më të mirë se sa përdorimi i vetëm sizmometëreve të vendosur në tokë, duke rritur mbulimin e të dhënave në zona të mëdha, tha Din.

"Toka është duke lëvizur vazhdimisht dhe ne kemi dashur të vëzhgojmë këto lëvizje, sepse mund të përfitojmë nga fakti se kemi më shumë të dhëna," shpjegoi Deen.





Kopsht Arome Trendafili



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!





Kopsht Arome Trendafili

Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1. Staf arsimor cilësor
2. Kushte arsimore sipas standarteve të larta
3. Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
4. Klasa dhe laboratorë të kompletuar
5. Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim

HAXHI SHEH SHAMIA

MEDRESEJA

SHKODER 1991





CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË

Adresa: Dega vajza, Lagjja: Perash, Rr. Mehmet Pashë Bushatlliu, Nr. 62 | Dega Djem, Lagjja: Lukuçesme

“Prandaj qëndro
i patundur
në udhën e drejtë,
ashtu siç je i urdhëruar.
Ashtu le të veprojnë
edhe besimtarët
që janë me ty,
e mos i kaloni kufijtë,
se Ai, me të vërtetë,
i sheh mirë ato
që punoni ju.”.

(Hud, 112)

ISSN 2227-3611
9 772227 361004 01